



STUDIME PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

TEZA:

“Shqiptimi i masave të sigurisë në Gjykatën themelore penale Shkup për periudhën kohore 2015-2020”

Kandidati:

Nurten Fera

Mentori:

Doc. Dr. Veditje Ratkoceri

Tetovë, mars, 2021

Për Ty

Engjulli im - Dua

FALËNDERIME

Falenderimi i takon Zotit që më mundësoi të arrij në përfundimin e këtij studimi gjithashtu me ndihmën dhe mbështetjen e gjithë atyre që më inkurajuan gjatë gjithë kohës.

Mirenjohje dhe Falendërim i veçantë për profesorët e fakuletit juridik dhe të degës penale, për mua është një knaqësi e veçantë që nga ky Universitet në të cilin dhe si studente e juridikut përjetova ndjenat më të mira gjatë studimit, që atëherë po ky Universitet më dha krenari dhe të njëjtën po e ndiej dhe tani ku po më jep titullin magjistër. Faleminderit nga gjithë Ju Profesor të nderuar.

Mirënjohje dhe falënderim të veçantë për udhëheqësen time shkencore në këtë punim të temës së magistraturës, Prof. dr. Veditje Ratkoceri, e cila ka kontribuar si shpirtërisht ashtu dhe profesionalisht në mënyrë që punimi të përmbaj standardet e kërkuara.

Asnjëherë nuk do të arrij të shpreh falënderimin tim ashtu siç e ndiej ndaj familjes sime e cila më përkrahi si moralisht ashtu edhe financiarisht, faleminderit për durimin, mirkuptimin dhe përkrahjen në të gjitha fazat e ngritjes time akademike. Ky rrugëtim nuk do të ishte i mundur pa inkurajimin dhe mbështetjen e tyre. Falenderim të veçantë për ty Nënë (që gjatë gjithë kohës ishte mbështetja ime) dhe ty babë (me pikëllim që nuk e përjeton këtë ditë së bashku me mua) për udhëzimin drejt rrugës së diturisë.

Dhe pjesa më e shtrenjtë e falenderimit i dedikohet **Vajzës sime**. Faleminderit për dashurinë, forcën dhe vullnetin që më dhe për të vazhduar më tutje pa fund falënderime për vajzën time të cilës i kam munguar në kohën që duhej të kaloja me të.

Dashuri dhe respekt për të gjithë Ju!

P ë r m b a j t j a

Abstrakt.....	8
Абстракт.....	10
Hyrje	12
Qëllimet e hulumtimit.....	13
Hipotezat.....	13
Metodologjia e hulumtimit.....	14
Rëndësia e punimit.....	15

KAPITULLI I

1. Masat sigurorese në legjislacionin penal të RMV-së

1.1 Sistemi i sanksioneve penale në KPMV.....	16
1.2 Dënimet.....	18
1.2.1 Qëllimet e dënimit.....	19
1.2.2 Llojet e dënimeve.....	19
1.2.3 Karakteristikat e dënimit modernë.....	20
1.3 Masat alternative.....	22
1.3.1 Masat alternative të Kodit në RMV-së.....	22
1.3.2 Llojet e masave alternative	23
1.4 Vështrim historik i evoluimit të masave të sigurisë në KPMV.....	23
1.4.1 Qëllimi i masave sigurorese në RMV.....	25

1.4.2 Masat e sigurië.....	26
----------------------------	----

KAPITULLI II

2. Karakteristikat kryesore të masave të sigurisë në KPMV

2.1 Mjekimi i detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtje në institucion shëndetësor.....	28
2.2 Mjekimi i detyrueshëm psikiatrik në liri.....	30
2.3 Mjekimi i detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve.....	32
2.4 Tremtani mjekësor–farmakologjik për abuzuesit seksual të fëmijëve nën moshën 14 vjeçare.....	34

KAPITULLI III

3. Procedura për shqiptimin e Masave të sigurisë

3.1 Dispozitat e përgjithëshme për shqiptimin e masave të sigurisë.....	38
3.2 Shqiptimi i masave të sigurisë dhe ndalimi i procedurës	39
3.3 Shqiptimi i masave të sigurisë për shkak të ndryshimit të aktakuzës.....	40
3.4 Shqiptim i masave të sigurisë në gjendje të përgjegjësis esencialisht të zvogluar.....	41
3.5 Dorëzimi i aktgjykimit të plotëfuqishëm në gjykatën kompetente që vendos për privim nga aftësia vepruese.....	42
3.6 Mbikqyrja mbi ekzekutimin e masave të sigurisë mjekim i detyrueshëm psikiatrik në institucion shëndetësor dhe lirimi i kryerësit të veprës penale.....	43
3.7 Zbatimi i masave të sigurisë mjekimi i detyrueshëm për alkoolistët dhe narkomanët.....	45
3.8 Zbatimi i masave të sigurisë mjekim i detyrueshëm medicinalo-farmakologjik.....	45

KAPITULLI IV

4.Shqiptimi i masave siguruese në Gjykatën Themelore penale në Shkup për periudhën 2015-2020 – studim empirik

4.1 Të dhënat e Entit shtetëror të statistikave për shqiptimin e masave të sigurisë ndaj personave madhor në RMV për periudhën 2015-2020

4.1.1 Të dhënat për shqiptimin e masës Shërim i obligueshëm psikiatrik dhe ruajtje në ent shëndetësor.....	50
4.1.2 Të dhënat për shqiptimin e masës Shërim i obligueshëm psikiatrik në liri.....	51
4.1.3 Të dhënat për shqiptimin e masës shërim i obligueshëm i alkolistëve dhe narkomanëve.....	52
4.1.4 Të dhënat për shqiptimin e masës tremtani mjekësor – farmakologjik për abuzuesit seksual të fëmijëve nën moshën 14 vjeç.....	53

4.2 Të dhënat e Gjykatës Themelore penale në Shkup për shqiptimin e masave të sigurisë për periudhën 2015-2020

4.2.1 Të dhënat për shqiptimin e masës Shërim i obligueshëm psikiatrik dhe ruajtje në ent shëndetësor.....	58
4.2.2 Të dhënat për shqiptimin e masës Shërim i obligueshëm psikiatrik në liri.....	59
4.2.3 Të dhënat për shqiptimin e masës shërim i obligueshëm i alkolistëve dhe narkomanëve.....	60
4.2.4 Të dhënat për shqiptimin e masës tremtani mjekësor – farmakologjik për abuzuesit seksual të fëmijëve nën moshën 14 vjeçare.....	61

4.3 Shqyrtim i aktgjyqimeve penale të rasteve ku janë shqiptuar masa siguruese në Gjykatës themelore penale në Shkup

4.3.1 Rasti parë.....	63
4.3.1.1 Analiza e rastit të parë nga praktika gjyqësore.....	69

4.3.2 Rasti i dytë.....	70
4.3.2.1 Analiza e rastit të dytë nga praktika gjyqësore.....	77
4.3.3 Rasti i tretë.....	78
4.3.3.1 Analiza nga rasti i tretë nga praktika gjyqësore.....	87
4.3.4 Rasti i katërt.....	88
4.3.4.1 Analiza nga rasti i katërt nga praktika gjyqësore.....	94
PËRFUNDIMI.....	96
BIBLIOGRAFIA.....	99

Abstrakt

Në këtë tezë të magjistraturës të titulluar: "Shqiptimi i Masave të sigurisë në Gjykatën themelore penale Shkup për periudhën kohore 2015-2020" do të flitet për sanksionet e më konkretisht do të flasim për kryerësit e veprave penale me çrregullime mendore për të cilët janë të nevojshme dispozita të veçanta pasi që kjo kategori e kryerësve të veprave penale llogariten si të veçanta dhe specifike të cilëve do tu shqiptohen masat e sigurisë si trajtim i detyrueshëm psikiatrik të cilat janë sanksione të lidhura për rrezikun e kryerësit dhe qëllimi i tyre është preventiva apo largimi nga gjendja e rrezikshme.

Do të analizohen të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me këtë llojë të sanksioneve – Masat e sigurisë, duke u nisur nga historiku i tyre dhe çështjet të cilat do të shqyrtohen në Kodin Penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut, i cili gjatë periudhës kohore do të has në ndryshime.

Në këtë rast bëhet fjalë për procedurat gjyqësore në Maqedoninë e Veriut, në raste ku kryerësit e veprave penale, si persona me çrregullime mendore; roli i gjykatës, konfliktet që ndodhin në mes praktikës gjyqësore dhe abuzimet psikiatrike të psikiatrisë, roli i ekspertizës psikiatrike, ekzekutimi i masave dhe roli dhe kapaciteti i psikiatrisë për trajtimin dhe mbrojtjen e kryerësit të veprave penale në përputhje me të drejtat e njeriut.

Legjislacioni penal i Maqedonisë së Veriut përmban dispozita në lidhje me procedurën; pasi gjykata mund të përcaktojë përgjegjësinë penale të kryerësve të veprave si delikuent të papërgjegjshëm. Eksperiza ka një rol të veçantë për konfirmimin e gjendjes mendore të kryerësit të veprës penale e cila e ka për detyrë të konstatojë propozimin e prokurorit të shtetit, gjykata e imponon kryerësin e veprës penale me një masë të trajtimit të detyrueshëm, për të vazhduar më tej me masat e shqiptuara të ekzekutimit.

Gjithashtu kemi sqaruar edhe rastet në procedura gjyqësore në Gjykatën themelore penale Shkup, në raste ku kryerësit e veprave penale, si delikuent të papërgjegjshëm; roli i gjykatës, konfliktet që ndodhin në mes praktikës gjyqësore, roli i ekspertizës psikiatrike, ekzekutimi i masave dhe roli dhe kapaciteti i psikiatris për trajtimin dhe mbrojtjen e kryerësit të veprave penale në përputhje me të drejtat e njeriut dhe se si gjykata e imponon kryerësin e veprës penale me një masë të trajtimit të detyrueshëm, për të vazhduar më tej me masat e shqiptuara të ekzekutimit.

Fjaë kuçe: *masat e sigurisë, sanksionet penale, Gjykata themelore penale, papërgjegjshmëria, trajtimi.*

Абстракт

Во оваа магистерска теза со наслов: „ Изрекувањето на мерките на безбедност на Основниот кривичен суд за период од 2015 – 2020 година “, ќе се зборува за кривичните санкции, а поконкретно ќе збориме за извршителите на кривичните дела со ментално нарушување, за кои се потребни посебни одредби, од причина што оваа категорија на извршители на кривични дела се сметаат како посебни и специфични, а на кои им се изрекува мерка на безбедност како задолжително психијатриско лекување, санкции кои се во блиска поврзаност со ризикот кој поттекнува од извршителот, и нивна цел е превенција односно отстранување од потенцијалниот ризик.

Ќе се анализираат сите прашања во врска со овој вид на кривични санкции – мерки на безбедност, почнувајќи од нивната историја и прашањата кои ќе се анализираат согласно Кривичниот законик на РСМ, кој закон со текот на времето ќе најде на многу промени.

Во конкретниот случај се работи за судските постапки на РСМ, во случаи кога извршителите на кривичните дела, како лица со ментално нарушување, улогата на судот, конфликтите помеѓу судската пракса, улогата на невропсихијатриското вештачење, изрекувањето на мерките како и улогата и капацитетот на психијатриското лекување во здравствена установа за заштита и нивен третман, а се во согласност со човековите слободи и права.

Кривичното законодавство на Република Северна Македонија, содржи членови во врска со постапката, затоа што судот може да одреди кривична одговорност за извршителите на кривични дела, како непресметливи деликвенти. Вештачењето има значајна улога за одредувањето на менталната состојба односно пресметливоста на извршителите на кривични дела, која има за задача да го констатира предлогот на Јавниот обвинител, судот му изрекува на извршителот на кривичното дело задолжително психијатриско лекување, за да понатаму се продолжува со изрекувањето на други мерки.

Исто така, се објаснети и случаи од судската постапка од Основниот кривичен суд, кога извршители на кривични дела, како непресметливи извршители, улогата на судот, конфликтите помеѓу судската пракса, улогата на невропсихијатриското вештачење, изрекувањето на мерките како и улогата и капацитетот на психијатриското лекување во здравствена установа за заштита и нивен третман, а се во согласност со човековите слободи и права.

Клучни зборови: мерки на безбедност, кривичните санкции, Основен кривичен суд, пресметливоста, третман.

Hyrje

Zgjedhja për të trajtuar këtë temë që përbën një problematikë mjaft shqetësuese në ditëtë tona në mbarë arenën juridiko-penale botërore, nuk ka qenë e rastësishme. Autori i këtij punimi në vijimësi ka qenë i interesuar për të kuptuar mekanizmat nëpërmjet të cilëve vepron krimi dhe bota e krimit. Në këtë tezë të do të flitet për sanksionet e më konkretisht do të flasim për masat e sigurisë të cilat janë sanksione të lidhura për rrezikun e kryerësit dhe qëllimi i tyre është preventiva apo largimi nga gjendja e rrezikshme. Për zbatimin e masave të sigurisë patjetër është e nevojshme që të kryhet vepra penale edhe pse vetëm me kryerjen e veprës penale nuk mund të percaktohet lloji i masës siguruese përkundrazi ajo shqiptohet pa pëlqim duke u thirrur në proporcionalitet mes rëndësisë së veprës ose fajit të kryerësit dhe llojit të sanksionit.

Do të analizohen të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me këtë llojë të sanksioneve – masat e sigurisë, duke u nisur nga historia ku pas Luftës së Dytë Botërore fillon trend i kufizimit të masave të sigurisë dhe përshkrimi i tyre kryesisht si sanksion për delikuentët të papërgjegjshëm, alkoolistë dhe narkomanë. Mirëpo disa legjislacione edhe më tej njohin masa të sigurisë pasdelikte (të cilat kanë për qëllim modelin e dënimit të sigurtë që përbëhet me heqjen e lirisë pas vuajtjes së dënimit ndonjëher edhe në afat të pacaktuar për kategori të rrezikshme autorësh të përgjegjshëm dhe fajtorësh – p.sh recidivistë disa herësh, delikuent profesional etj).

Do të analizojmë edhe çështjet që shqyrton Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut, i cili në periudhë has në ndryshime ku sipas sistemit të sanksioneve të ish - Jugosllavis njihen dy grupe masash të sigurisë: masa që i referohen gjendjes patologjike të kryerësit në kohën e kryerjes së veprës (masë sigurie mjeksore) dhe masa që kanë të bëjnë me ndalesë dhe konfiskim sendesh. Do të analizojmë edhe ndryshimet e KP në periudhë kohore ku Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut parasheh këto lloje të **masave të sigurisë**: mjekim i detyruar psikiatrik dhe ruajtje në institucion shëndetësor, mjekim i detyruar psikiatrik në liri, mjekim i detyruar i alkoolistëve dhe narkomanëve dhe mjekimi medicinal farmakologjik.

Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është që të vihet në pah se sa shpesh shqiptohen masat e sigurisë në Gjykatën themelore penale në Shkup dhe cilat kushte zakonisht plotësohen në mënyrë që Gjykata të shqiptoj këto masa. Qëllim tjetër është edhe ajo që të vemë në pah se a shqiptohen këto masa në rastet e duhura dhe për shkaqet e duhura apo jo.

Gjithashtu si qëllim kryesor i këtij punimi hulumtues është njohja dhe studimi i masave të sigurisë konform dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe atë: Mjekimi i detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtja (kujdesi) në institucion shëndetësor, mjekimi i detyrueshëm psikiatrik në liri , mjekimi i detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve dhe mjekimi medicinalo farmakologjik.

Qëllimi i këtij punimi është sa më efikas të bëhet trajtimi i duhur mjeksor i personave të varur nga droga e alkooli me qëllim që përmes këtij trajtimi të arrijm në ndikim të përmisimit të tyre dhe të jenë të dobishëm për shoqërim.

Hipotezat

Gjatë këtij hulumtimi shkencor janë paraqitur disa hipoteza, të cilat gjatë përpunimit të tezës do të vërtetohen.

- Inkorporimi i masave të sigurisë në sistemin e sanksioneve penale të RMV-së hapi i duhur për parandalimin e recidivizmit të veprave penale
- Masat e sigurisë një domosdoshmëri për menjanimin e gjendjes së rrezikshme të kryerësit
- Gjykata Themelore penale Shkup në periudhën 2015-2020 ka shqiptuar numër të konsiderueshëm të masave të sigurisë
- Roli i gjykatës në shqiptimin dhe realizimin e masave të sigurisë është shumë i rëndësishëm

Metodologjia e hulumtimit

Në këtë punim, kam përdorur një metodologji disi komplekse e ndërthurur kjo me disa elemente. Gjerësisht në këtë punim kam përdorur rastet studimore, nga praktika e Gjykatës themelore penale Shkup apo juridiksioni i saj. Nëpërmjet metodës analizuese dhe asaj induktive, kam bërë një analizë të këtyre vendimeve, me qëllimin e nxjerrjes në pah të problematikave që mbartin ligjet në lidhje me masat siguroese dhe absolutisht nevojën për të bërë reforma drejt përsosjes së tyre. Metoda të tjera që kam përdorur janë: metoda normative, metodika historike, metoda statistikore, shfrytëzimi i dokumentacioneve zyrtare, metoda krahasuese.

Përmes metodës normative është analizuar legjislacioni nacional përkatësisht dispozitat e Kodit penal dhe të Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale për sa i përket masave të sigurisë.

Metoda historike është përdorur për të hulumtuar historikun dhe prejardhjen e masave të sigurisë.

Metoda statistikore është përdorur për grupim dhe manipulim me të dhënat statistikore të cilat janë siguruar nga Gjykata themelore penale Shkup rreth shqiptimit të masave të sigurisë për periudhën 2015-2020.

Janë shfrytëzuar dokumente zyrtare nga Gjykata themelore penale Shkup, janë shfrytëzuar edhe ligjet e periudhave të ndryshme kohore, udhëzimet administrative, etj.

Kjo metodologji e përdorur më ka ndihmuar për të nxjerrë në pah karakteristikat, veçoritë dhe problematikat që mbartin masat e sigurisë në një procedim penal.

Rëndësia e punimit

Shqiptimi i Masave të sigurisë është i rëndësishëm të zbatohet në praktikën gjyqësore në gjykatën e RMV-së e veçanërisht në Gjykatën themelore penale në Shkup.

Masat e sigurisë janë sanksione penale dhe është e domosdoshme që ata persona të cilët kryejn vepër penale me paaftësi mendore dhe në varësi nga droga ose alkooli dhe si qëllim i tyre është që të shqiptohen masat e sigurisë dhe të menjahet gjendja dhe kushtet të cilat mund të ndikojnë që kryerësit në të ardhmen të kryejn vepra penale.

Masat e sigurisë janë sanksione të llojit të veçantë të lidhura me rrezikshmërinë shoqërore të kryerësit, të cilat mund tu shqiptohen vetëm kryerësve të veprave penale me paaftësi mendore dhe në varësi nga droga ose alkooli dhe qëllimi i këtyre masave nuk është ndëshkimi por mjekimi, ruajtja dhe mbrojtja e kësaj kategoris të kryerësve të veprave penale si dhe mbrojtjes së shoqërisë nga rreziku i mundësisë së kryerjes së veprës penale.

Gjithashtu rëndësi të veçantë në këtë punim ka shqiptimi i masave të sigurisë në Gjykatën themelore penale, analiza e disa rasteve në të cilët hasim zbatimin e tyre ndaj kryerësve të veprës penale nga personat e papërgjegjshëm nga varësia e drogës ose alkoolit. Dhe analiza e bërë se sa janë efikas dhe a zbatohen në menyrën e duhur masat e tilla në vendin tonë.

KAPITULLI I

1. MASAT E SIGURISË NË LEGJISLACIONIN PENAL TË RMV-SË

1.2 Sistemi i sanksioneve penale në KPMV

Për dallim nga nocioni i përgjithshëm juridik, sanksioni si pjesë e normës juridike që e përcakton sjelljen e atij që shkel dispozitivin e saj si dhe të organit shtetëror që është i obliguar ta detyrojë në sjellje të caktuara atë që shkel normën, sanksionimi në kuptimin penalo-juridik nënkupton zbatimin e masave të detyrueshme ndaj shkelësit të normave për shkak të veprës së kryer me shkeljen e normës penalo-juridike. Sanksioni është masë e detyrueshme që kryerësit ia shqipton gjykata, nëpërmjet vendimit gjyqësor të detyrueshëm, i përcaktuar me ligj si reaksion për veprën e kryer. Përmbajtja rezulton në marrjen apo kufizimin e disa të drejtave të kryerësit të veprës, shërimi i tij i detyrueshëm ose trajtimi i detyrueshëm e që paraqiten në formë të dënimit, masat alternative, masat e sigurisë dhe masat edukuese (të rezervuara për të mitur të rinj). Për termin e sanksionit penalo-juridik janë të rëndësishëm elementet në vijim: e para, se ajo është pasojë juridike që e godet kryerësin për shkakë të kryerjes së veprës penale dhe e dyta sanksioni penal-juridik përbëhet në marrjen ose në kufizimin e disa të drejtave dhe lirive të kryerësit ose shërimin e detyruar ose trajtimin në liri, apo masa të ndihmës dhe mbrojtjes.¹

Sanksionet penale janë mjete juridike penale me të cilat realizohet funksioni mbrojtës i të drejtës penale, e që paraqesin bazën dhe qëllimin themelor të vetë ekzistimit të së drejtës penale.²

Sanksionet penale janë një instrument për ushtrimin e funksionit mbrojtës të së drejtës penale, si qëllim themelor për ekzistencën e së drejtës penale. Mbrojtja arrihet duke parashikuar sjelljen e rrezikshme njerzore për shoqërinë si veprër penale dhe sanksionet ndëshkimore për kryerësin e tyre.

Natyra materiale dhe thelbësore e sanksioneve ndëshkimore konsiston në kontributin e tyre në shtypjen e krimit si dukuri e rrezikshme për shoqërinë. Për shkak të heterogjenitetit të

¹ Kambovski,V.,Zejneli,I .,2018 , E drejta penale - pjesa e përgjithsme , faqe243

² Stojanović, Zoran. Krivično pravo, Opšti deo, Beograd, 2003, fq. 285.

sanksioneve ndëshkuese, një nocion i përbashkët dhe i përgjithshëm nuk mund të jepet për shkak të ekzistencës së shumë elementeve të diskutueshme. Prandaj, ne do të fillojmë nga elementet që nuk janë të diskutueshme për mohimin e nocionit të përgjithshëm material-formal të sanksioneve ndëshkimore, sipas të cilave ato masa shtetërore shtypëse të marra për të shtypur krimin, dhe zbatohen ndaj autorit të krimit duke kufizuar ose shkurtuar disa të drejta dhe liri të bazuar në një vendim gjyqësor të dhëna nga një urdhër penal.

Sistemi i sanksioneve penale është një tërësi sanksionesh të përcaktuara në ligj, të cilat në bazë të kushteve të caktuara dhe pas një procedure të kryer, mund t'i shqiptohen kryesit të një vepre penale. Me miratimin e Kodit Penal, u bë një ndryshim në sistemin e sanksioneve, kështu që nga masat e sigurisë u largua ndalesa për paraqitjen publike, dhe u vendosë dënimi me burgim të përjetshëm.³

Kodi Penal, i ndryshuar në 2004, parashikon katër lloje të sanksioneve penale:

- dënimi (me burgim; me gjobë; ndalim ushtrimin e profesionit veprimtari ose detyrë; ndalesa për të drejtuar automjetin dhe largimi i të huaji nga vendi);
- masat alternative (dënimi me kusht; dënimi me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse; ndërprerje me kusht i procedurës penale; punë në dobi të përgjithshme; vërejtje gjyqësore dhe burgim shtëpiak);
- masat e sigurisë (mjekim i detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtja në institucion shëndetësor, mjekim i detyrueshëm psikiatrik në liri dhe mjekim i detyrueshëm i alkoolistëve)
- masat edukuese (qortim ose dërgim në qendër disiplinore për të mitur, masat e mbikëqyrjes së shtuar: nga prindërit, prindi birësues ose kujdestari, nga një familje tjetër ose masë mbikqyrëse nga organi shtetëror social: dërgim në institucion për arsimim ose dërgim në institucion edukues).⁴

Karakteristikat e sistemit të sanksioneve penale në RMV-së janë:

- parashikon pesë lloje të gjobave;

³ Буцакоски С., Казнено право општ дел, Охрид 2008, ст.261-262

⁴ Буцакоски С., Казнено право општ дел, Охрид 2008, ст.262

- vërejmë dy lloje të dënimeve që mund të shqiptohen si kryesore (për shembull nuk njih punën në dobi të përgjithëshme, burgim të rreptë, etj.) por me ndryshimet parashihen dënime të reja të cilat konsiderohen si dënime ndihmëse;
- ka shenja edhe të sistemit të vjetër edhe pse thuhet se është konceptuar në mënyrë bashkëkohore;
- ka shumë mospërputhje dhe një regjim të ndryshëm për mundësinë e zbatimit retroaktiv të pasojave ligjore të dënimit, etj., të cilat kërkojnë një reformë të madhe që është duke u zhvilluar.⁵

Me ndryshimet, mund të thuhet se sistemi penal në vendin tonë është i larmishëm, i adaptueshëm dhe plotësisht i pajtueshëm. Diversiteti konsiston në aspektin e parimit të individualizimit. Fleksibiliteti mund të vërehet në fazën e ekzekutimit të sanksioneve penale (në institucione të krijuara ose të hapura, thirrje prove, etj.). Duhet të theksohet se Kodi Penal i përmbahet në mënyrë rigorozë ligjshmërisë së sanksioneve penale, duke mos lejuar efektin e tyre prapaveprues.⁶

1.3 Dënimet

Denimi është e keqe e paramenduar dhe e qëllimshme që shkaktohet për shkak të veprës së kryer: ky është funksioni primar dhe efekti i dënimit. Te masat e sigurisë, e keqja paraqitet si komponent i pashmangëshëm i detyrimit dhe karakterit të detyrueshëm të vetë masës së përcaktuar për qëllime të tjera primare në interes të kryerësit: pengimin e rrezikut, gjegjësisht preventiv, kurse baza e zbatimit të saj është nevoja për ndihmë dhe shërim të kryerësit.⁷

⁵ Po, aty

⁶ Po, aty

⁷ Kambovski, V., Zejneli, I., 2018, E drejta penale - pjesa e përgjithëshme, faqe 250

1.3.1 Qëllimimi i dënimeve

Përpos realizimit të drejtësisë, qëllimi i ndëshkimit është: pengimi i kryerësit të kryej vepra penale dhe riedukimi i tij, dhe në mënyrë edukative të ndikojë ndaj të tjerëve të mos kryejnë vepra penale.⁸

Kodi penal është një shembull i rrallë i kohës bashkëkohore e kodekseve dënuese që shprehimisht e deklaron qartë qëllimin e dënimit si një parandalim i përgjithshëm dhe i veçantë. Kështu që deklarimi i qëllimeve të ndëshkimit zbulon angazhimin e ligjvënësit për teorit e përziera mbi ndëshkimet.

1.3.2 Llojet e dënimeve

Në sistemin tonë dënimet ndahen në dy grupe: kryesore dhe sekondare. Dënime kryesore janë burgimi dhe dënimi me të holla (gjobë). Me këto ndryshime, repertori i dënimeve është zgjeruar edhe me tre lloj dënimesh që më parë ishin të parapara si masë të sigurisë.⁹

Sipas Kodi penal për veprat penale të kryerësve që kanë përgjegjësi penale mund tu shqiptohen këto dënime:

- Dënimi me burgim,
- Dënimi me gjobë,
- Ndalesë për të ushtruar profesionin, veprimtari apo detyrë,
- Ndalesë për të drejtuar automjetin,
- Dëbim i të huajit nga vendi,
- Ndalesë për vizitimin e ndeshjeve sportive.¹⁰

⁸ Osmani A.,2017, Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë

⁹ Kambovski,V.,Zejneli,I.,2018, E drejta penale - pjesa e përgjithsme, fq. 255

¹⁰ Osmani A 2017, Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë

Sipas gjithë kësaj kuptojmë që dënimet ndalen në dënimi kryesore dhe sekondare ku si dënime kryesore kemi dënimin me burgim dhe dënimin me të holla ndërsa dënimi me burgim mund të shqiptohet vetëm si dënim kryesor a dënimi me të holla mund të shqiptohet edhe si dënim kryesor edhe si sekondar bashkërisht me dënimin me burgim ose me dënimin me kusht ku është paraparë dënim me burgim.

1.3.3 Karakteristikat e dënimit bashkëkohorë

Ende mbete dilema për dënimin se çfarë do të bëhet me të dhe këtu hyjmë në të drejtat dhe liritë themelore të qytetarëve e cila është mbrojtja e shoqëris nga veprimet kriminele. Sipas asaj që është thënë deri tani për dënimin ajo megjithatë edhe në kushtet bashkëkohore në shoqërit në zhvillim hasin në mundësit më të mëdha që dënimi të zëvendësohet me lloj më të lehtë të sanksionit penal siç janë edhe masat alternative.¹¹

Në mënyrë që të monitorohet niveli i kulturës dhe civilizimit të sotëm Evropian, dënimi duhet të përmbushë disa kushte të përgjithëshme të caktuara përmes të cilave paraqiten edhe karakteristikat e dënimit:

- sanksioni duhet të ketë karakter publik-juridik - që do të thotë se shteti mund ta

shqiptojë atë sanksion përmes institucioneve të tij;

- të jetë i barabartë për të gjithë - pavarësisht nga përkatësia klasore, shoqërore, racore, fetare, kombëtar e kryerësit të veprës penale;
- të jetë i ligjshëm dhe proporcional – shqirohet sanksioni ashtu siç është parapar me ligj, e cila shqiptohet në një procedurë ligjore të paanshme të dënimit proporcional e cila buron nga vlersimi i ligjvënësit konkretisht për secilën vepër;
- të jetë i ndashëm - nënkupton sigurimin e individualizimit në dënim, në varësi të shkallës së fajit dhe rëndësis së pasojave;

¹¹ Буцакоски С., Казнено право општ дел, Охрид 2008, ст.269-270

- të jetë personal - që do të thotë t'i referohesh kryerësit të veprës, dhe jo familjes së tijë dhe personave të tjerë të afërt;
- të jetë njerëzor dhe moral - të privuar nga elementet e torturës dhe poshtërimit të autorit të veprës, procedura që urdhëron dinjitetin njerëzor të personit të dënuar për të mos vepruar në kundërshtim me qëllimin e korrigjimit dhe risocializimit;
- të jetë i revokueshëm, i korrigjueshëm dhe i zëvendësueshëm - në rast të një vendimi të paligjshëm, për shkakë të keqpërdorimit ose lajthimit gjyqësor pasojat mund të hiqen, përkatësisht e drejta e privuar nga liria mund të plotësohet ose zëvendësohet me një denim tjetër më të butë.¹²

Ekzekutimi i sanksioneve penale nuk i përket fushës së të drejtës penale, ajo bie në zbatimin e ligjit penal, me të cilën merret penologjia. Në teori, ekziston një mosmarrëveshje nëse e drejta penale duhet të merret me çështje në fushën e zbatimit të sanksioneve penale. Disa çështje në këtë fushë janë të një natyre juridike materiale, kështu që sanksionet e caktuara rregullohen vetëm në të drejtën penale. Çështjet në lidhje me ekzekutimin e sanksioneve penale nuk duhet të studiohen nga e drejta penale, por legjislacioni ynë në këtë fushë ofron rregulla në pjesën e përgjithshme të ligjit penal dhe ato janë vetëm rregulla dhe parime të përgjithshme për ekzekutimin e dënimeve.¹³

1.4 Masat alternative

Masat alternative në rrethin juridik evropian si nocion është shumë i gjerë dhe përfshin sanksione të ndryshme dhe procedura që mund të zbatohen në cilëndo fazë të procedurës: alternativat e procedurës penale, alternativat e gjykimit, alternativat e burgut. Disa autorë flasin për alternativat joburgosëse në vend të sanksioneve alternative, sepse nocioni i fundit e implikon qëndrimin se dënimi me burg është rregull, ndërsa të gjithë masat tjera janë

¹² Po,aty

¹³ Po,aty

sekondare. Sipas disa autorëve, të tillë janë ato dënime që i mundësojnë kryerësit që një pjesë ose gjithë dënimin ta vuajë në bashkësi, jashtë institucioneve të burgut.¹⁴

Për dallim nga ky nocion i ngushtë i alternativave gjyqësore i koncentruar në sanksionet alternative që i përfshinë të gjitha fazat dhe procedurat. Të tilla janë: masat për shmangie të paraburgimit, në të drejtën e procedurës sonë penale p.sh. garancitë, premtimet e të akuzuarit se nuk do ta lëshojë vendqëndrimin, si dhe masat që mund të shfrytëzohen për shmangien e zbatimit të dënimit në procedurë para shqiptimit të sanksionit. Nocioni ekstensiv i alternativave e karakterizon tendencën e lëvizjes në të majtë të kompetencave të organeve që marrin pjesë në procedurë prej gjykatës deri te prokuroria publike dhe policia, zbatimi i masave në të cilat zgjidhet rasti kriminal pa dënim dhe gjykim.¹⁵

1.4.1 Masat alternative në Kodin Penal në Republikën e Maqedonisë së Veriut (KPMV)

Si qëllim kryesor i masave alternative është që ndaj kryesrësit me përgjegjësi penale të mos zbatohet dënim për vepëra më të vogël kur ajo nuk është e domosdoshme për shkak të mbrojtjes penalo-juridike dhe kur mund të pritët se qëllimi i ndëshkimit mund të realizohet me paralajmërim, me kërcënim për dënim (lirim me kusht), vetëm me paralajmërim (vërejtje gjyqësore) ose me masa të ndihmës dhe mbikqyrjes e sjelljes së kryerësit në liri.¹⁶

1.4.2 Llojet e masave alternative

Në sistemin tonë penal me ndryshimin e KPMV-së të vitit 2004 është vendos sistemi rrumbullakosur i masave alternative i cili mund të ju shqiptohet kryerësve të veprave penal:

- Dënimi me kusht - është një kërcënim real me një dënim specifik që mund të realizohet në kushte të caktuara;
- Dënimi me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse - është varianti i dënimit me kusht i vendosur nën mbikqyrjen e një shërbimi të veçantë;

¹⁴ Kambovski, V., Zejneli, I., 2018, E drejta penale - pjesa e përgjithshme, 2018

¹⁵ Сахити X., 2016. Нормативни и практични претпоставки за примена на алтернативните мерки. Македонската ревија за кривично право и криминологија, 1.

¹⁶ Osmani A., 2017, Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë

- Ndërprerje me kusht e procedurës penale - merret për vepra më të lehta penale pas marrjes në pyetje të të pandehurit, me kusht që kryerësi në afatin deri sa zgjat ndërprerja, të mos kryej vepër të re penale;
- Puna në dobi të përgjithshme - përcaktohet mbi kryerësin i cili ka kryer një vepër penale nën rrethana lehtësuese dhe nuk është dënuar më parë;
- Vërejtja gjyqësore - bëhet fjalë për një vërejtje e cila mund të mbetet vetëm një vërejtje duke u mvarur nga kryerësi dhe nëse kryhet një krim i ri merret si një dënim i mëparshëm;
- Burgu shtëpiak - përcaktohet për një kryerës të moshuar dhe të dobët, i sëmurë rëndë ose grua shtatzënë dhe që ka kryer një krim të vogël;¹⁷

1.2 Vështrim historik i evoluimit të masave të sigurisë në KPMV

Masat e sigurisë hasën në zhvillim historik gjatë etapave kohore. Në kuptimin bashkëkohor masat e sigurisë, paraqiten në shkollën atropologjike – pozitiviste. Ku nga shekulli i XX në të drejtën penale pozitive kjo ide merrë shprehjen legislative, pasi si përgjegjësi morale dhe dënimit si sanksion retributiv dhe rrezikut të kryerësit dhe masave të sigurisë nga ana tjetër. Masat e sigurisë janë sanksione të lidhura për rrezikun e kryerësit dhe qëllimi i tyre është preventiva dhe largimi nga gjendja e rrezikshme. Ndërsa kufizimi i masave të sigurisë fillon pas Luftës së Dytë Botërore dhe përshkrimi i tyre kryesisht si sanksione për delikuent të papërgjegjshëm, alkoolistë dhe narkomanë. Që nga legjislacioni i ish Jugosllavisë KPMV hasë në ndryshime dhe njeh dy grupe masash të sigurisë: masa që i referohen gjendjes patologjike të kryerësit në kohën e kryerjes së veprës (masë sigurie mjeksore) dhe masë që ka të bëjë me ndalesë dhe konfiskim sendesh.¹⁸

¹⁷ Po,aty

¹⁸ Kambovski,V.,Zejneli,I.,2018, E drejta penale - pjesa e përgjithsme,2018 , faqe 314

Mirëpo ndryshimet që ndodhën në Kodin Penal në vitin 2004 masat e sigurisë u ulën në masa medicinale, dhe masat e tjera të cilat ishin si masa ndaluse janë vendosur në sistemin e dënimeve si: (ndalimi i ushtrimit të profesionit, detyrës ose veprimtarisë, ndalimi i drejtimit të automjetit dhe dëbimi i të huajit nga vendi), marrja sendesh është paraparë si masë e posaçme penalo-juridike e ndërlidhur për veprën penale. Dhe me këtë ndryshim ka arritur në ndarjen e sanksioneve të cilat janë të ndryshme për nga përmbajtja e tyre dhe natyra juridike. Si masë e parë merret masa e shërimit me të cilën synohet që të përmissohet gjendja patologjike dhe si masa të dytë kemi masat të cilat kanë të bëjnë me disa kufizime juridike, si pasojë e veprës së kryer.¹⁹

Mirëpo gjatë zhvillimit historik dhe me ndryshimin e Kodit Penal në 2004 parashihen keto masa: Mjekim i detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtja në institucionin shëndetësor, Mjekim i detyrueshëm psikiatrik në liri, Mjekim i detyrueshëmialkoolistëve dhe narkomanëve dhe Mjekim medicinal-farmakologjik i kryersve të sulmeve ndaj fëmijës deri në 14 vjet (nenit 61 i KPMV).

Duke u bazuar në natyrën juridike të këtyre ekzistojn dy qëndrime kundërthënëse: e para bën fjalë për masa të shërimit, që kanë karakter medicinal, dhe që sipas sajë dueht të jenë të përjashtuar prej të drejtës penale dhe të paraqesin pjesë të së drejtës mjeksore. Thuhet se zbatimi i tyre, si sanksion penalo-juridik, thuhet se e shtrembëron konceptin themelor të së drejtës penale të drejtuar kah kryerësi i përgjegjshëm dhe fajtori. Ndërsa sipas qëndrimit të dytë nuk mohon se këto masa kanë karakter medicinal/mjekësor, e mbron trajtimin e tij si një masë në kodin penal, për shkak të garancive të posaçme që parashikon procedurën penale për të drejtat e kryerësit.²⁰

1.2.1 Qëllimi i masave të sigurisë në RMV

Qëllimi i masave të sigurisë sipas KPMV është që të menjanohet gjendja dhe kushtet që kryerësi në të ardhmen të kryen sërish vepër penale. Qëllimi i këtillë i përcaktuar kështu i

¹⁹ Po, aty

²⁰ Po, aty

përgjigjet natyrës së tyre si sanksion jashtëzakonisht specialo-preventiv. Në fakt, me përjashtim të zbatimit të tyre kundrejt personave të papërgjegjshëm, ato janë me afat të kufizuar dhe prezumojnë dënim të kryerësit për veprën e kryer (dënim ose masë alternative), kështu që qëllimi i tyre është komplementar me qëllimin special-preventiv të dënimit.²¹

Masat e sigurisë tregojnë specifika të caktuara në zbatimin e mjeteve dhe metodave në ekzekutimin e tyre. Derisa dënimi i burgimit ka për qëllim risocializimin e personit të dënuar. Gjithashtu dhe masat e sigurisë lidhen më të njejtin qëlli por në një mënyrë tjetër. Masat e sigurisë kanë për qëllim ndryshimin e disa kushteve për personat e nevojshëm që ata të mund të risocializohen dhe adaptohen me shoqërinë. Kështu, masat e sigurisë janë me karakter institucional dhe shëndetësor, realizimi i trajtimit special-psikologjik dhe mjekësor me mjete dhe metoda të lejuara të trajtimit; tek ata që kanë kryer veprën si pasojë e varësisë nga alkooli ose droga dhe substanca të tjera psikotrope, zbatohen metoda të trajtimit psikiatrik - psikologjik dhe mjekësor, por edhe metoda të terapisë sociale dhe të ngjajshme. Kohëzgjatja e masave të sigurisë përshtatet me natyrën e secilës masë dhe nevojën për të arritur qëllimin e caktuar. Për këto arsye, ato janë me një kohëzgjatje relativisht të pacaktuar, dhe masa e trajtimit dhe ruajtjes së detyrueshme në një institucion shëndetësor me kohëzgjatje absolute të pacaktuar. Sidoqoftë, respektimi i parimit të ligjshmërisë siguron që ato të mos zbatohen, dmth që ekzekutimi i tyre të ndalet kur pushon nevoja dhe të arrihet qëllimi i zbatimit të tyre. Masat e sigurisë bazohen në parimet e ligjshmërisë, njerëzimit dhe individualizimit.²²

KPMV sistemon masat e sigurisë në një kapitull të veçantë, i cili dëshiron të theksojë specifikën e tyre si sanksione penale, duke theksuar se ato zbatohen ndaj një kriminelit që rrezikon të kryejë krime në të ardhmen për të kryer krime për shkak të kushteve të caktuara të personalitetit, të cilat kushte duhet të heqin masat e sigurisë.²³

²¹ Kambovski, V., Zejneli, I., 2018, E drejta penale - pjesa e përgjithsme, 2018, faqe 315

²² Арнаудоски Л., и Груевска-Драгулевски А., Пенологија - втор дел, Скопје 2013, ст.315-316.

²³ По, аty

1.2.2 Masat e sigurisë

Paraqitja e masave të sigurisë si sanksione të pastra preventive, të rezervuara për rastet patologjike të kriminalitetit dhe të krijuara në bazë të idesë së rrezikut të kryerësit dhe masat për mbrojtjen e shoqërisë nga gjendja e tillë e rrezikshme, fitoi shprehje legislative në të drjtën penale nga fillimi i shekullit XX përmes variantit të moderuar të dualizmit të sanksioneve penale dhe “korsisë së dyfishtë” të së drejtës penale.²⁴

Masat e trajtimit të detyrueshëm janë sanksione penale që u shqiptohen kryerësve të veprave penale të cilët në kohën e kryerjes së veprës penale kanë qenë penalisht të përgjegjshëm për shkak të: paaftësis mendore, aftësisë së zvogluar mendore ose për shkakë të varësisë nga droga ose alkooli.²⁵

Kryerësi i veprës penale me aftës të zvogluar mendore ose personi i cili është duke u trajtuar si i tillë, duhet të trajtuar me humanizëm dhe duke respektuar dinjitetin e tij njerëzorë.²⁶

Për shkak të larmisë së madhe të masave të sigurisë, në kodin tonë penal, parashikimi i masave të sigurisë përgjithësisht përcakton qëllimin e përbashkët të masave të sigurisë, i cili është: heqja e kushteve ose kapjeve që mund të ndikojnë që kryerësi në të ardhmen të kryej vepra të njejta (neni 60 i Kodit Penal).

Në kapitullin e pestë të Kodit Penal të Maqedonisë së Veriut, janë paraparë Masat e sigurisë, e sipas këtij Kodi Masat e sigurisë të cilat mund ti shqiptohen kryerësit i cili nuk është penalisht i përgjegjshëm, i shqiptohen këto masa:

- Mjekim i detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtja në institucionin shëndetësor,
- Mjekim i detyrueshëm psikiatrik në liri,
- Mjekim i detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve dhe

²⁴ Kambovski V., E drejta penale-pjesa e përgjithëshme , 2015, fq.547

²⁵ Halili R. Penologjia, Prishtin 2014

²⁶ Po, aty

- Mjekim medicinal-farmakologjik i kryersve të sulmeve ndaj fëmijës deri në 14 vjet.²⁷

Shiqptimin e këtyre masave do të shohim më tutje në vazhdim të punimit për zbatimin e tyre në bazë të Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë Veriut, Zbatimit të ligjit mbi ekzekutimin e tyre dhe praktika gjyqësore në vendin tonë.

²⁷ Osmani A .,2017, Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë

KAPITULLI II

2. KARAKTERISTIKAT KRYESORE TË MASAVE TË SIGURISË NË KPMV

2.1 Mjekimi i detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtje në institucion shëndetësor

Mjekimi i detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtje në institucion shëndetësor është një lloj i masës së sigurisë mjekësore që zbatohet kur përcaktohet se kryerësi në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore ka kryer një krim, për të cilin ekziston një supozim i arsyeshëm se ai është i rrezikshëm për mjedisin e tij dhe në një gjendje të tillë përsëri kryen vepra penale. Kjo masë merret për të eliminuar këto rreziqe kur nevojitet trajtim në institucionet e duhura shëndetësore. Në mënyrë që gjykata të vendosë këtë masë, sipas ligjit, duhet të ekzistojnë tre kushte themelore: personi në fjalë të ketë kryer një krim në një gjendje me aftësi të zvogëluar mendore, të jetë i rrezikshëm për mjedisin dhe trajtimi dhe ruajtja në një institucion shëndetësor është e nevojshme për të eliminuar rreziqet nga përsëritja e veprës penale.²⁸

Qëllimi i zbatimit të kësaj mase sigurie është trajtimi i dyfishtë i sëmundjes së kryesit (sëmundje mendore, çrregullime të përkohshme mendore ose zhvillim i vonuar mendor) dhe izolim për mbrojtje nga veprat e mëtejshme penale.²⁹

Masa i shqiptohet kryerësit i cili ka kryer vepër penale në gjendje të papërgjegjshme ose në përgjegjshmëri të zvogëluar esenciale, nëse gjykata konstaton se për shkak të kësaj gjendje kryerësi përsëri mund të kryej vepër penale dhe se për mënjanimin e këtij rreziku duhet shërim i tij dhe rruajtje në institucion. (Neni 63 i Kodit Penal).³⁰

Kryerësi i cili ka kryer vepër penale në gjendje të papërgjegjshme apo esencialisht të zvogëluar, gjykata do ti shqiptoj mjekim të detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtje në entin shëndetësor nëse vërteton se për shkak të gjendjes së tillë përsëri mund të kryejë vepër penale

²⁸ Буцакоски С., Казнено право општ дел, Охрид 2008, ст.335

²⁹ По, аты

³⁰ Kambovski, V., Zejneli, I., 2018, E drejta penale - pjesa e përgjithshme, 2018, faqe 315

dhe se me menjanimin e këtij rreziku është i nevojshëm mjekimi i tij dhe ruajtja në institucion të tillë(neni 63 paragrafi 1 i Kodit Penal).³¹

Duhet të dallohen dy situata kur: kjo masë i shqiptohet kryrësit të papërgjegjshëm dhe kur i shqiptohet kryerësit me përgjegjëshmëri esencialishtë të zvogluar. Kusht i përbashkët është ekzistimi i rrezikut për të kryer veprë të re penale. Nocioni rrezik mund të jetë i përcaktuar në kuptimin më të gjerë ose më të ngushtë. Formulimi i këtill implikon qasje restriktive që nënkupton vlerësim për mundësinë e kryerjes së veprës penale, nëpërmjet të cilës manifestohet gjendja e posaçme mentale e kryerësit. Konstatimi i këtij kushti për zbatimin e masës kalon nëpërmjet dy fazave në të cilat gjykata duhet të mbështetet në rezultatin dhe mendimin e psikiatrit-ekspertit.

- Në fazën e parë duhet të konstatohet, nëse vepra është kryer në lidhje të arsyeshme dhe me pasojë me gjendjen e posaçme të kryerësit, gjegjësisht se ajo është e nxitur nga gjendja e tillë (nuk ka bazë për zbatimin e masës së sigurisë, psh kur ndonjë person me skizofreni do të rëshqas dhe do të lëndojë dikë).
- Në fazën e dytë gjyqi duhet të konstatojë se gjendja e rrezikshme e kryerësit nuk është ndërprerë dhe se e njëjta mund të ndikojë që edhe në të ardhmen të kryej vepra të tilla.³²

Kemi të bëjmë me vlerësim pra edhe në të ardhmen mund të kryhet veprë e llojit të caktuar.³³ Ligji posaçërisht e potencon obligimin e gjykatës që periodikisht çdo vitë ta rikonfirmojë nevojën e shërimit dhe ruajtjes në institucion shëndetësorë dhe të marrë vendim për ndërprerjen e saj kur të konstatojë se ajo është përmirësuar.³⁴ Në rast të ndërprerjes së hospitalizimit dhe zëvendësimit të tij, gjykata vendos për një trajtim ambulantor në liri, në bazë të mendimit të një eksperti psikiatrik.

³¹ Neni 63, paragrafi 1 i Kodit Penal të Maqedonisë

³² Kambovski, V., Zejneli I., 2018, E drejta penale - pjesa e përgjithsme, 2018, fq. 315

³³ Po, aty

³⁴ Neni 63, paragrafi 2 dhe 4 i Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë

Kur kjo masë i shqiptohet kryrësit me përgjegjshmëri esenciale, i cili është i dënuar me burg, koha e kaluar në ente shëndetësore i llogaritet në kohën sa zgjat dënimi i shqiptuar. Nëse kjo kohë është më e shkurtë se afati i dënimit, gjykata mund të përcaktojë që i dënuari të dërgohet në mbajtjen e pjesës tjetër të dënimit ose të lirohet me kusht pa marrë parasyshtë kushtet e parapara për lirim me kusht. Gjatë vendosjes për lirim me kusht gjykata do ta konsiderojë veçanërisht suksesin e trajtimit (shërimit) të personit të dënuar, gjendjen e tij shëndetësore, kohën e kaluar në ente shëndetësore dhe kohën e mbetur të dënimit të përvuajtur.³⁵

Masat e sigurisë Mjekimi i detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtje në ent shëndetësor kryhet në institucionet shëndetësore në vijim:

- **Në spitalin psikiatrik – „ Shkup ” – Shkup** dërgohen personat e dënuar zona e Gjykatave themelore: Veles, Gostivar, Dibër, Kërçov, Kratov, Kriva Pallanka, Kumanov, Shkup dhe Tetovë;
- **Në spitalin psikiatrik – Demir Hisar** dërgohen personat e dënuar nga zona e gjykatave themelore: Manastir, Krushev, Ohër, Prilep, Presp dhe Strug;
- **Në spitalin psikiatrik – Negorci** dërgohen personat e dënuar nga zona e gjykatave themelore: Berov, Vinic, Gjevgjeli, Delçev, Kavadarci, Koçani, Negotin, Radovish, Strumicë dhe Shtip.³⁶

2.2 Mjekimi i detyrueshëm psikiatrik në liri

Mjekimi i detyrueshëm psikiatrik në liri është masë e detyrueshme të cilën e shqipton gjykata kryerësit i cili në kohën e kryerjesë ka qenë në gjendje të paaftësisë mendore ose aftësisë esencialisht të zvogëluar mendore.³⁷

Përveç formës themelore të zbatimit ky sanksion mund të shqiptohet edhe në dy raste të tjera:

³⁵ Neni 63, paragrafi 3 i KPM

³⁶ Арнаудоски Л., и Груевска-Драгулевски А., Пенологија-втор дел, Скопје 2013, стр.319

³⁷ Halili R. Penologjia, Prishtin 2014, fq. 80.

1) Si ndërrim për mjekim të detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtje në ent shëndetësor, kur gjyqi në bazë të rezultateve do të konstatoj se më nuk është e nevojshme ruajtja e tij dhe mjekimi në ent të tillë, por në liri dhe

2) kryerësit me përgjegjshmëri esenciale të liruar në lirim me kusht pas ndërprerjes së masës për mjekim të detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtje në ent shëndetësor.³⁸

Kushtet ligjore për zbatimin e këtij sanksioni janë:

- kryerja e veprës penale në gjendje të papërgjegjshme ose me përgjegjësi të zvogëluar esenciale,
- rrezik nga kryerja e sërishme e veprës penale dhe
- nevojën për mjekim për të mënjanuar rrezikun.

Megjithatë, ka disa dallime cilësore në përmbajtjen e kërkesave ligjore. Së pari, ligji në mënyrë joprecize e definon shkallën e rrezikut nga kryerja e sërishme e veprës.³⁹

Do të ishte logjike që të supozohet se kjo shkallë duhet të jetë dukshëm më e vogël në krahasim me shkallën që të imponon hospitalizimi i detyrueshëm. Në praktikën gjyqësore ekzistojnë tendenca për shqiptim të kësaj mase edhe në rastet kur kryerësi akoma nuk paraqet rrezik, por reziiku mund të paraqitet nëse nuk i nënshtrohet mjekimit. Qëndrimi i tillë siç duket nuk është në përputhje me dispozitën ligjore, e cila imponon përcaktimin e rrezikut aktual në kohën e shqiptimit të masës. Për këtë i rëndësishëm ngel kushti i dytë: nevoja e shërimit dhe parashikimi (prognoza) për efektet e shërimit në entet shëndetësore ose në liri, nga aspekti i mënjanimit të rrezikut nga kryerja e sërishme e veprës penale. Kur masa i shqiptohet personit me përgjegjshmëri të zvogëluar esenciale, kohëzgjatja e saj është e kufizuar në dy vite, me atë që nëse i është shqiptuar dënim me burg, koha e kaluar në shërim psikiatrik të detyruar në liri nuk llogaritet në dënimin me burg (neni 64 paragrafi 4-5).⁴⁰

³⁸ Shih nenin 63 p.3 të kodit penal të RM-së.

³⁹ V.Kambovski, I.Zejneli, E drejta penale-pjesa e përgjithëshme, Tetovë, 2018, fq.318

⁴⁰ Shih nenin 64 paragrafi 4-5 të Kodit Penal të RM-së.

2.3 Mjekimi i detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve

Masën parandaluese mjekim i detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve gjykata mund të ja shqiptoj kryerësit që ka kryer veprë penale për shkak të varësisë nga përdorimi i vazhdueshëm i alkoolit ose narkotikët dhe nga i cili ekziston rreziku që nga kjo varësi ai edhe më tutje do të kryej veprë penale.

Vendosja e kësaj mase duhet që në mënyrë kumulative të plotësohen kushtet e mëposhtme:

1) Të bëhet fjalë për kryersin e veprës penale që ka kryer krimin për shkak të gjendjes nga varësia dhe përdorimi i vazhdueshëm i alkoolit ose lëndëve narkotike. Nuk është e nevojshme që gjatë kryerjes së veprës penale kryesi të ishte në gjendje të dehur ose varësisë nga droga. Është mjaftueshëm varësia e tij ndaj alkoolit ose përdorimit të drogës dhe lidhja shkakësore ndërmjet gjendjes të tillë dhe veprës së kryer, përkatësisht varësisë të paraqitet si arsye e veprës.

2) Duhet të ekzistojë rreziku për kryerësin e vepës penale se për shkak të kësaj varësie në të ardhmen ai të vazhdon të kryejë veprë penale. Kjo masë e sigurisë nuk është e një natyre të pavarur, që do të thotë se mund të shqiptohet vetëm së bashku me dënimin (çdo dënim), prova (e cila mund të zgjasë deri në dy vjet), dhe kur bëhet fjalë për një të mitur dhe me masa edukuese. Kur shqipton një dënim me kusht, gjykata mund të gjykojë kryesin të urdhërojë mjekimin e tij në liri, duke marrë parasysh dispozitën e veçantë gatishmëria e kryerësit të veprimit të tillë.⁴¹

Sipas natyrës së gjërave ky sanksion është inkompatibil me masat e sigurisë së mëparshme, sepse mjekimi i detyrueshëm psikiatrik dhe kujdesi në ent shëndetësor ose në liri i përfshinë rastet e rënda të varshmërisë prej të cilave ka ardhur deri te kryerja e veprës në gjendje të papërgjegjshme ose me përgjegjshmëri esenciale të zvogluar. Kur kryerësit i është shqiptuar masa e tillë ajo përfshinë edhe shërim të varshmërisë nga alkooli, droga ose substancat psikotrope. Mjekimi i detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve shqiptohet së bashku me dënimin me burg dhe realizohet në institucion për kryerjen e dënimeve ose në

⁴¹ Сулејманов З., Пенологија, Скопје 2005, стр.338

institucion shëndetësor ose institucion tjetër të specializuar dhe koha e kaluar në institucion të tillë llogaritet në dënim. Në këtë rast zgjatja e kësaj mase është e përcaktuar me zgjatjen e dënimit me burg. Kur është e shqiptuar me dënim tjetër përveç dënimit me burg ose dënimit me kusht, dënimi me kusht është në mbikëqyrje të intensifikuar, vërejtje gjyqësore ose lirim nga dënimi, zgjatja e saj është e kufizuar në më shumë se dy vjet.⁴²

Gjatë shqiptimit, dënimit me kusht gjykata të dënuarit mundet t'i imponoj mjekim në liri nëse ai pajtohet t'i nënshtrohet mjekimit të tillë, nëse pa arsye nuk i nënshtrohet mjekimit në liri ose mjekimin e lëshon me vetëdëshirë, gjykata mund të caktoj të revokohet dënimi me kusht ose masa të kryhet në mënyrë të detyrueshme në institucione shëndetësore ose institucione të specializuara.⁴³

Organ kompetent i cili e dërgon personin të cilit i është shqiptuar kjo masë sigurie në institucionin përkatësisht në institucionin shëndetësor është gjykatësi për ekzekutimin e sanksioneve penale. Institucioni në të cilin realizohet mjekim i detyrueshëm psikiatrik obligohet që së paku në çdo 6 muaj ta njoftoj gjyqin i cili ka shqiptuar vendimin gjyqësor në shkallë të parë për gjendjen shëndetësore të kryerësit të veprës penale. Dhe më së shumti vjen në shprehje për shkak të përmisimit të gjendjes shëndetësore të personit të dënuar, për arsye se nëse ka përmirësim, atëherë gjyqi e kthen personin në vuajtje të mëtejme të dënimit të mbetur. Kjo masë e sigurisë ka afat të caktuar deri kur duhet të zbatohet. Për përfundimin e kësaj mase, institucioni shëndetësor në të cilën është vendosur personi i dënuar personit të cilit i është shqiptuar kjo masë, është i obliguar që ta njoftoj gjykatën që ka marr vendimin gjyqësor në shkallë të parë. Po të ekzistojnë raste kur personit të cilit i është shqiptuar kjo masë të refuzojë aplikim e saj ndaj tij, atëherë në raste të tilla nëse personi i dënuar pa shkak të arsyeshëm nuk i shtrohet mjekimit ose e ndëpret mjekimin, institucioni shëndetësor e njofton për këtë gjykatën që e ka miratuar vendimin në shkallën e parë.⁴⁴

Gjithashtu për realizimin e mjekimit të detyrueshëm të alkoolistëve dhe narkomanëve ekzistojnë edhe shpenzime të cilat janë të ndara në dy grupe, edhe atë: shpenzimet e realizimit

⁴² Pelivanova, N. Merki na bezbetnost od medicinski karakter, Shkup 1996

⁴³ V. Kambovski, I. Zejneli, E drejta penale-pjesa e përgjithëshme, Tetovë, 2018.

⁴⁴ Osmani A., Komentari i ligjit për ekzekutimin e sanksioneve, Shkup 2013, fq. 293-296

të mjekimit të detyrueshëm të alkoolistëve dhe narkomanëve në institucionin shëndetësor, që bie në llogari të buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa sigurohen në pikë të vaçantë në buxhetin e Ministrisë së Shëndetësisë; dhe shpenzimet e realizimit të mjekimit të detyrueshëm të alkoolistëve dhe narkomaëve, pasiqë personi i gjykuar do të dërgohet që pjesën e mbetur të dënimit me burg ta vuaj në institucion, bie në llogari të institucionit.⁴⁵

2.4 Tremtani mjekësor – farmakologjik për abuzuesit seksual të fëmijëve nën moshën 14 vjeçare

Abuzimi seksual i fëmijëve është i pranishëm në të gjitha vendet e botës dhe është produkt kompleks i shumë faktorëve shoqëror, kulturor, ekonomik dhe biologjikë. Si krim i rëndë përbën një ndër shkeljet më brutale dhe serioze të jetës dhe shëndetit të fëmijëve. Ky krim i pështir len pasoja afatgjate dhe të rënda si për viktimin ashtu edhe për familjen e saj, duke marrë parasysh që bëhet fjalë për individ (fëmij) të papjekur dhe në fazë të zhvillimit. Një ndër të drejtat themelor e fëmijëve është mbrojtja e tyre nga abuzimet, veçanërisht nga abuzimi seksual. Prandaj, të gjithë ne, përfshir institucionet shëndetësore, familjen e shoqërinë në përgjithësi kemi detyrë që të mbrojm fëmijët dhe për ata të ofrojm një mjedis jetësor që mbron, kujdeset dhe edukon. Duke marrë parasysh karakteristikat në njërin anë dhe karakteristikat e abuzuesve seksual të fëmijëve në anën tjetër, institucionet shëndetësore duhet të ndërrmarin të gjitha masat e nevojshme për luftimin dhe veçanërisht parandalimin e këtyre veprave penale.⁴⁶

Termi abuzim seksual i fëmijëve është term legal (juridik) apo penal që zakonisht përdoret në legjislacionet juridike dhe statistikat penale, për dallim nga termi pedofil i cili përfaqëson një diagnoz klinike të dhëna nga psikiatri apo psikologu.⁴⁷

⁴⁵ Po, aty

⁴⁶ Ratkoceri V., 2018-Kastrimi kimik si sanksion penal faqe 10 - tezë doktorature UEJL-Fakulteti juridik https://library.seeu.edu.mk/index.php?lvl=search_result

⁴⁷ Po, aty

Në KPMV abuzimi seksual në përgjithësi përcaktohet vetëm si “marrëdhënie seksuale apo aktivitet tjetër seksual me fëmijë nën moshën e caktuar”, pra, nuk kemi ndonjë elaborim më të gjerë të asaj se çfarë përfshinë ky aktivitet tjetër seksual. Në fjalorin e përgjithëshëm abuzimit seksual të fëmijëve i referohemi me termin pedofili kurse personi i cili kryen abuzime seksuale ndaj fëmijëve i quajmë pedofilë. Mirëpo, këto dy nocione nuk janë të njëjta. Siç do të shohim, termi abuzim seksual i fëmijëve është term legal, juridik i përdorur gjerësisht në legjislacionet penale të shteteve të ndryshme, ndërkaj me termin pedofili më shumë shërbehen shkencat psikologjike dhe psikiatrike. Si një çrregullim i veçantë parafilik, pedofilia është dëshirë apo preference për marrëdhënie seksuale me fëmijë para pubertetit. Pedofilët e kryejnë aktin për shkak të epshit të tyre seksual, ndërkaj abuzuesit seksual të fëmijëve mund ta kryejnë aktin edhe për arsye të tjera. Pra, pedofilët janë një kategori e abuzuesve seksual të fëmijëve.⁴⁸

Të flasim pak mbi tretmanin e abuzuesve seksual të fëmijëve nën moshën 14 vjeçare. Rëndësia e dallimit midis nocioneve të abuzimit seksual të fëmijëve dhe pedofilisë që u elaboruan më lartë ka të bëjë pikërisht edhe me trajtimin e këtyre personave. Hasim në një tretman të posaçëm e që është mjekimi farmakologjik (kastrimi kimik). Mirëpo, ajo çfarë duam të theksojmë në këtë pjesë ka të bëjë me kategorinë e abuzuesve seksual të fëmijëve që janë adekuat për t’iu nënshtruar mjekimit farmakologjik sepse siç do të shohim jo të gjithë abuzuesit mund të trajtohen njëjtë në aspektin mjekësor. Abuzuesit seksual përfaqësojnë një popullatë heterogjene. Një nëngrup (kategori) e tyre vuan nga çrregullime seksuale të njohura në literaturën seksilogjike dhe psikiatrike si parafilia. Tretmani i abuzuesve seksual parafilik (abuzuesit seksual që vuajnë nga një apo më shumë parafilie) është shumë dimensional dhe sipas standardeve të tanishme, përfshinë terapitë psikologjike dhe aty ku është e përshtatshme, terapitë në baza biologjike.⁴⁹

Dr. Fred Berlin, Profesor i asociuar në Shkollën e Mjekësisë të Johns Hopkins dhe drejtor i Institutit Kombëtar për Studimin, Parandalimin dhe Trajtimin e Traumës Seksuale (SHBA) shkon më tej në një qasje të katërfishtë për trajtimin e abuzuesve seksualë.

⁴⁸ Ratkoceri, V (2017). Chemical castration of child molesters – Right or Wrong?!.European Journal of Social Sciences Education and Research – EJSER, Vol. 11(1),

⁴⁹ Po, aty

- 1) psikoterapi,
- 2) modifikim të sjelljes,
- 3) kirurgji dhe
- 4) medikamente (kasttrim kimik).

Por jo të gjithë abuzuesit seksual përfitojnë nga medikamentet që ulin nivelin e testosteronit (kasttrimi kimik). Për shembull, siç e kemi potencuar edhe më parë, abuzuesit seksual mund të klasifikohen në katër kategori:

- 1) Parafilikë, ata të cilët përdorin stimul të papranueshëm siç janë fëmijët;
- 2) Abuzues të cilët pranojnë se kanë kryer abuzim seksual, por fajin ia hedhin forcave joseksuale apo jo personale si alkoolit, drogës apo stresit;
- 3) Abuzuesit e dhunshëm dhe
- 4) Ata të cilët e mohojnë natyrën kriminale të veprimeve të tyre apo të cilët mohojnë se ata e kanë kryer krimin.

Nga katër llojet e ndryshme të dhunuesve seksual, vetëm lloji i parë i dhunuesve (parafilikët) “ndjejnë keqardhje apo faj” dhe “nuk janë në gjendje të kontrollojnë sjelljet e tyre. Kështu, vetëm lloji i parë i dhunuesve do të reagojë në tretmanin farmakologjik apo kasttrimin kimik sepse tre llojet e tjera ose e mohojnë sjelljen e tyre (lloji IV), hedhin fajin për sjelljen e tyre (lloji II) apo kënaqen derisa kryejnë veprime të dhunshme (lloji III), kështu duke mos pranuar se sjellja e tyre është jashtë kontrollit të tyre apo se është e papërshtatshme.”⁵⁰

Andaj, në mënyrë të veçantë, në ligjet për kasttrimin kimik, ligjvënësit duhet të kenë parasysh se jo të gjithë abuzuesit seksual janë të përshtatshëm për tretman me kasttrim kimik dhe se ky tretman jo domosdoshmërisht do të ulë shkallën e recidivizmit për të gjithë abuzuesit. Rrjedhimisht, në përputhje me rrethanat, ligji për kasttrim kimik duhet të zbatohet vetëm për

⁵⁰ Ratkoceri, V (2017). Chemical castration of child molesters – Right or Wrong?!.European Journal of Social Sciences Education and Research – EJSER, Vol. 11(1),

parafiliakët (lloji I) dhe nuk duhet të zbatohet për tre llojet tjera të dhunuesve seksual, meqenëse tretmani mund të mos ulë shkallën e tyre të recidivizmit. Përdorimi i medikamenteve për të ulur dëshirën seksuale mund të funksionojë për ata autorë, sjellja e të cilëve bazohet thjesht në një prirje seksuale të devijuar. Nga ana tjetër, për ata abuzues tek të cilët tendencat janë të pavarura nga testostosterone medikamentet e kastrimit kimik si MPA dhe CPA, nuk do të funksionojnë. Nëse një kryerës përdor sjelljen seksuale për të përmbushur kryesisht nevojat jo seksuale si afeksioni, dashuria, fuqia ose zemërimi, kastrimi kimik nuk do ta ndalë atë abuzues nga abuzimi i fëmijëve. Trajtimi i të gjithë abuzuesve seksual të fëmijëve me kastrim kimik është analoge me, për shembull, dhënien e kemo terapisë së njëjtë pacientëve me kancer në gji, pacientëve me kancer në fyt, pacientëve me kancer në mushkëri, dhe pacientëve me kancer në pankreas vetëm sepse të gjithë ata janë pacientë me kancer. Është sugjeruar se jo vetëm që tretmani do të jetë jo efikas për dhunuesit në këto kategoritë e tjera, por që në të vërtetë mund të jetë edhe më i dëmshëm. Siç do të shohim edhe shumë legjislacione penale botërore përfshirë edhe Republikën e Maqedonisë së Veriut administrimin e kastrimit kimik ndaj abuzuesit seksual të fëmijës e kanë paraparë në bazë vullnetare. Mirëpo, me këtë rast duhet të kemi parasysh se në baza ditore, vetëm një numër i vogël i pedofilëve kërkojnë tretman në baza vullnetare dhe ata arrijnë deri te ky vendim vetëm sepse ndjejnë ankth dhe depresion lidhur me këtë perversion, në të kundërtën ata nuk heqin dorë në mënyrë spontane nga orientimet e tyre seksuale.⁵¹

⁵¹ По,aty

KAPITULLI III

3. PROCEDURA PËR ZBATIMIN E MASVE TË SIGURISË

E drejta penale materiale përcakton llojin e masave të sigurisë (neni 61 i Kodit Penal) si dhe kushtet nën të cilat ato mund ti shqiptohen kryerësit të veprës penale (nenet 62 i Kodit Penal). Masat e sigurisë, sipas rregullit, shqiptohen me aktgjykim dënues. Mirëpo për disa prej tyre zhvillohet procedurë e veçantë me ç'rast vendoset me aktvendim. Me këtë rast bëhet fjalë për masat e sigurimit: mjekim i detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtja në institucionin shëndetësor; mjekim i detyrueshëm psikiatrik në liri; mjekim i detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve dhe tretmani mjeksor-farmakologjikë.⁵²

3.1 Dispozitat e përgjithshme për shqiptimin e masave të sigurisë

Nëse vërtetohet që i akuzuari ka kryer vepër penale në gjendje të papërgjegjshmërisë, Prokurori publik vendos që në gjykat të dërgoj një propozim për shqiptimin e masave të sigurisë - mjekim i detyrueshëm psikiatrik në institucion shëndetësor gjegjesisht mjekim i detyrueshëm psikiatrik në liri nëse për shqiptimin e kësaj mase ekzistojn kushtet e parapara sipas Ligjit penal. Nëse në këtë rast i akuzuari nëse është në paraburgim me një vendim do të lirgohet nga paraburgimi mirëpo nuk do të lirohet me mbarimin e procedurës për shqiptimin e masës së sigurisë por do të vendoset në institucion shëndetësor për të vazhduar mbajten e dënimit.⁵³

Kryerësi i cili gjatë kryerjes së veprës penale shumë herë ndodhet në momente kur nuk është në gjendje të kuptoj rëndësin e veprës që ka kryer ose nuk ka mundur ti kontrolloj veprimet e tij për shkakë të gjendjes shëndetësore që është gjendur (sëmundje e përhershme

⁵² Sahiti e., & Zejneli I., E drejta e procedurës Penale e Republikës së Maqedonisë, Shkup 2017, fq. 340

⁵³ Г. Калајџијев Г. Лажетиќ Л. Неделкова М. Денковска М. Тромбева Т. Витларов П. Јанкуловска Д. Кадиев, КОМЕНТАР НА ЗАКОНОТ ЗА КРИВИЧНАТА ПОСТАПКА, ноемри 2018, ст.1020

ose e përkohëshme mendor, çrregullim i përkohëshëm mendor, ngecje e zhvillimit mendor ose ndonje penges tjetër psiqike).⁵⁴

Në propozim akuzën, Prokurori publik mund të kërkojë nga gjykata zbatimin e masave të sigurisë trajtimi i detyrueshëm psikiatrik ose mbajtja e kryerësit të veprës penale në institucion shëndetsor (sipas kushteve të parapara në nenin 63 të Kodit Penal) ose trajtimi i detyrueshëm psikiatrik i kryerësit në liri (sipas kushteve të parapara në nenin 63 të Kodit Penal). Nëse i akuzuari është në paraburgim Prokurori publik me propozimin për shqiptimin e masës së sigurisë ai duhet të dorëzojë edhe një propozim për heqjen e paraburgimit. Personi ndaj të cilit zhvillohet procedura për shqiptimin e masës së sigurisë përkohësisht do të dërgohet në institucion shëndetësor ose në ndonjë vend të përshtatshëm.⁵⁵

Gjykata që vepron me propozimin e Prokurorit publik për përcaktimin e masës së sigurisë, mundet edhe pa propozim nga Prokurori publik për të përcaktuar ndalimin e kryerjes së profesionit, ndalim për të drejtuar automjetin në paprgjegjshmëri deri sa të zgjasë ekzekutimi i shqiptimit të masës së sigurisë. Duke pasur parasysh gjendjen shëndetësore të kryerësit të veprës penale, dhe nëse ai më parë nuk ka advokat të tij personal, menjëher pas marrjes së propozimit nga Prokurori publik në mënyrë zyrtare gjykata do të caktoj një avokat mbrojtës.⁵⁶

3.2 Shqiptimi i masave të sigurisë dhe ndalimi i procedurës

Për shqiptimin e masës së sigurisë mjekim i detyrueshëm psikiatrik në institucion shëndetsor, mjekim i detyrueshëm psikiatrik në liri, mjekim i detyrueshëm i aloolistëve dhe narkomanëve vendos gjykata e cila është kompetente sipas vendit të kryerjes së veprës penale e cila është e përfshirë në propozimin e Prokurorit publik. Mbahet seancë kryesore para gjykatës në të cilën seancë nuk zbatohen dispozitat e Ligjit për procedurë penale që kanë të bëjnë me përgaditjen e seancës kryesore nga LPP. Në seancën kryesore përveç personave të cilët duhen të

⁵⁴ Shih Kodin Penal të RM-së, neni 12 paragrafi 1

⁵⁵ Po, aty

⁵⁶ Shih Ligjin për procedurë penale, neni 74.

jenë në bazë të nenit 348 të Ligjit për procedur penale, detyrimisht thirren ekspertë dhe psikiatër nga institucioni shëndetësor ku është zbatuar ekspertiza për vërtetimin e gjendjes së përgjegjshmërisë së të akuzuarit. I akuzuari do të thirret vetëm nëse gjendja e tij e lejon atë të jetë i pranishëm në seancën kryesore. E obligueshme është prania e avokatit mbrojtës i të akuzuarit.⁵⁷

Gjykata në mënyrën e duhur për seancën kryesore do ti informoj bashkëshortët gjegjësisht bashkëshortin jashtëmartesor dhe prindërit e të akuzuarit, dhe sipas rrethanave edhe të afërmit e tjerë të ngushtë. Këtyre personave nuk ju dërgohet ftes, ato informohen (me shkrim, me gojë, me telefon etj). Në bazë të provave të paraqitura, gjykata konstaton se i akuzuari në momentin e kryerjes së veprës penale ishte i përgjegjshëm, me vendim shqipton ndonjërin nga masat e sigurisë. Gjykata nuk është e lidhur me propozimin e Prokurorit publik. Masa e sigurimit shqiptohet me vendim i cili duhet të përmbajë: të dhëna për personin e akuzuar; përshkrimi i ngjarjes; kualifikimi juridik i krimit; llojin e sanksionit penal që shqiptohet; dhe institucionin shëndetësor ku do të ekzekutohet masa e sigurisë. Mirëpo nëse gjykata bazohet në provat e dhëna se i akuzuari nuk ishte i përgjegjshëm, sjell vendim për ndërprerje të procedurës për zbatimin e masave të sigurisë dhe me plotfuqishmërin e saj atëher Prokurori publik është i obliguar të ngrej propozim aktakuzë të përshtatshme kundër personit të akuzuar. Afati i ankimit kundër vendimit për ndërprerjen e procedurës së masës së sigurisë është 8 (tetë) ditë. Mbi këtë zgjidhje pala e dëmtuar nuk ka të drejtë ankese.⁵⁸

3.3 Shqiptimi i masave të sigurisë për shkak të ndryshimit të aktakuzës

Prokurori publik propozimin për përcaktimin e masës së sigurisë mund të paraqesë gjatë seancës kryesore, kur në bazë të ekspertizës psikiatrike do të thuhet gjendja shëndetësore e të akuzuarit për shkak të së cilës ai nuk do të mund të vijojë gjykimin. Kjo gjendje është një kusht i papërshtatshmërisë për procedentin.⁵⁹

⁵⁷ Shih Ligjin për procedur penale, neni 348

⁵⁸ Г. Калајџиев Г. Лажетиќ Л. Неделкова М. Денковска М. Тромбева Т. Витларов П. Јанкуловска Д. Кадиев, КОМЕНТАР НА ЗАКОНОТ ЗА КРИВИЧНАТА ПОСТАПКА, ноемри 2018, ст.1020-1021

⁵⁹ По,aty

3.4 Shqiptimi i masave të sigurisë në gjendje të përgjegjësisë esencialisht të zvogëluar

Kur gjykata do të shqiptoj masë të sigurisë personit i cili ka kryer vepër penale në gjendje të paaftësisë mendore, (vërejtur në bazë të ekspertizës sipa nenit 12 paragrafi 2 i Kodit Penal), me të njëjtin aktgjykim me të cilin e konstaton fajësin gjykata do të sjell një vendim në të cilin do të caktohen edhe masat e sigurisë mjekim i detyrueshëm psikiatrik në institucion shëndetësor (neni 63 i KP), mjekim i detyrueshëm psikiatrik në liri (neni 64 nga KP) apo mjekim i detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve (neni 65 i KP) nëse vërtetohet se për këto masa ekzistojnë kushte ligjore. Dispozicioni i aktgjykimit në këtë çështje ka dy pjesë: pjesa e parë, gjykimi në lidhje me fajin dhe ndëshkimin dhe pjesën e dytë një vendim për shqiptimin e masës së sigurisë. Në këtë rast, gjykata vendosi një masë sigurie pa ndonjë propozim nga Prokurori publik.⁶⁰

Për ndërhyrjen e kohës së kaluar në institucionin shëndetësor nga dënimi i shqiptuar, kryesrësi i cili ka kryer vepër penale në gjendje të papërgjegjshmërisë esencialisht të zvogëluar dhe që është dënuar me burgim, koha e kaluar në institucion shëndetësor llogaritet në kohën e mbajtjes së ndëshkimit të dhën. Nëse ajo kohë është më e shkurtër se zgjatja e dënimit të dhën gjykata mund të caktoj që i dënuari të udhëzohet në vuajtje të pjesës së mbetur të dënimit ose të lëshohet në lirim me kusht pavarësisht nga kushtet e caktuara (ku i dënuari mund të lirohet me kusht nga vuajtja e dënimit me burg që të mos kryej vepër të re penale deri sa të kalojë koha për të cilën është shqiptuar dënimi, nëse është përmisuar ashtu që thellësisht mund të pritët se në liri do të sillet më mire, e veçanërisht se nuk do të kryej vepër penale). Gjatë vendosjes për lirim me kusht gjykata gjithashtu do të marrë parasysh suksesin e mjekimit të dënuarit, gjendjen e tij shëndetësore, kohën e kaluar në institucion shëndetësor dhe pjesën e mbetur të

⁶⁰ Г. Калаџиџев Г. Лажетиџ Л. Неделкова М. Денковска М. Тромбева Т. Витларов П. Јанкуловска Д. Кадиев, КОМЕНТАР НА ЗАКОНОТ ЗА КРИВИЧНАТА ПОСТАПКА, ноемри 2018, ст.1022

dënimit që i dënuari nuk e ka vuajtur. Gjykata çdo vitë e rishqyrton nevojën e mjekimit dhe të ruajtjes së kryerësit në institucionin shëndetësor.⁶¹

3.5 Dorëzimi i aktgjykimit të plotfuqishëm në gjykatën kompetente që vendosë për privim nga aftësia vepruese

Me plotfuqishmërin e aktgjykimit në të cilën me vendim të gjykatës caktohet masa e sigurisë për kryerësin e veprës penale i cili ka ndërmar veprimin në gjendje të papërgjegjshmërisë ose përgjegjshmëris esencialisht të zvogluar, gjykata e cila e ka caktuar masën është i obliguar të dërgoj njoftim me shkrim deri tek gjykata civile e cila në procedurë jashtë-kontestimore është kompetente të vendos për privimin e aftësisë vepruese. Sipas dispozitave ligjore për procedurë jashtë kontestimore, kompetente për të hequr aftësin për veprim është gjykata në atë vend ku jeton ose qëndron i akuzuari, dhe nëse nuk ka vendbanim, domethënë vendqëndrim, atëher kompetent është gjykata ku për herë të fundit ka pasur vendbanimin apo vendqëndrimin i akuzuari. Me njoftimin e gjykatës e cila e sjell vendimin përfundimtar në procedurën penale, gjykata civile (ose gjyqtari që vepron në bazë të tyre në përputhshmëri me orarin vjetor) është i detyruar të fillojë procedurat për privimin e aftësisë për veprim sipas detyrës zyrtare.⁶²

Gjykata që ka vendosur masën e sigurisë është e detyruar ta informojë edhe qendrën për punë sociale si organ i kujdestarisë. Nëse kjo nuk është bërë, sipas dispozitave ligjore në procedurën jashtë kontestimore, ky obligim ekziston për gjykatën (ose gjyqtari që vepron në bazë të tyre në përputhshmëri me orarin vjetor) i cili zbaton procedurën për marrjen e aftësisë për veprim.⁶³

⁶¹ Shih Kodin Penal të RM-së, neni 63 paragrafi 3 dhe neni 36 paragrafi 1

⁶² Г. Калајџијев Г. Лажетиќ Л. Неделкова М. Денковска М. Тромбева Т. Витларов П. Јанкуловска Д. Кадиев, КОМЕНТАР НА ЗАКОНОТ ЗА КРИВИЧНАТА ПОСТАПКА, ноемри 2018,ст.1022

⁶³ Г. Калајџијев Г. Лажетиќ Л. Неделкова М. Денковска М. Тромбева Т. Витларов П. Јанкуловска Д. Кадиев, КОМЕНТАР НА ЗАКОНОТ ЗА КРИВИЧНАТА ПОСТАПКА, ноемри 2018,ст.1022-1023

3.6 Mbikqyrja mbi ekzekutimin e masave të sigurisë mjekim i detyrueshëm psikiatrik në institucion shëndetësor dhe lirimi i kryerësit të veprës penale

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për zbatimin e sanksioneve, institucioni shëndetësor në të cilin kryehet masa e sigurisë mjekim i detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtja është i obliguar së paku dy herë në vit ta njoftoj gjykatën e cila e ka kumtuar masën për gjendjen shëndetësore të personit. Kur institucioni shëndetësor vlerëson se ka mbaruar nevoja për mjekim dhe ruajtje, do ti propozojë gjykatës kompetent që ta ndërpres zbatimin e mëtejshëm të kësaj mase. Institucioni shëndetësor për personat e dënuar me përgjegjshmëri të zvogëluar esenciale në mënyrë të konsiderueshme, të cilëve nuk ju ka mbaruar dënimi, mund të propozojë lirim me kusht. Kur gjykata vendimin mbi shqiptimin e masës mjekim i detyrueshëm psikiatrik në liri dhe ruajtja në institucionin shëndetësor e merr ndaj personit me përgjegjësi esenciale të zvogëluar mund të ndërpres dhe i dënuari të lirohet nga institucion shëndetësor në mënyrë zyrtare ose me propozim të institucionit shëndetësor ose me propozim të qendrës për punë sociale. Kështu gjykata vendos me një vendim. Për një vendim të tillë gjykatës i është e nevojshme mendimi i mjekut kompetent të institucionit në të cilin është i vendosur personi, i cili vërteton se mbaron nevoja për mjekim të mëtutjeshëm dhe ruajtja e kryerësit të veprës penale në institucion. Në varësi të mendimit të mjekut dhe nga vlerësimi i gjykatës, personi mund të lirohet me masa tjera të sigurisë ose mjekimi dhe ruajtja në institucionin shëndetësor mund të zëvendësohet me ndonjë masa siguroese mjekim i personit në liri.⁶⁴

Atëherë kur gjykata e sjell vendimin ndaj personit me përgjegjshmëri esenciale të zvogëluar me rendësi është fakti se nga ruajtja e dënimit me burg edhe sa ka mbetur deri në mbarim të dënimit. Në bazë të dispozitave ligjore të Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale, institucioni shëndetësor për personat me përgjegjshmëri esenciale të zvogëluar të cilëve nuk ju ka kaluar koha e mbarimit të dënimit mund të propozojë gjykatës i dënuari të lirohet në lirim me kusht. Gjkata e shkallës së parë e cila e ka sjell vendimin përfundimtar gjegjësisht jep dhe vendim për të liruar të dënuarin nga institucioni vetëm në tri mënyra:

⁶⁴ Г. Калајџиџев Г. Лажетиќ Л. Неделкова М. Денковска М. Тромбева Т. Витларов П. Јанкуловска Д. Кадиев, КОМЕНТАР НА ЗАКОНОТ ЗА КРИВИЧНАТА ПОСТАПКА, ноемри 2018,ст.1027

a) i dënuari ta mbaj dënimin e mbetur ku personi i dënuar dergohet në burg,

b) i dënuari të lirohet me kusht, pa marr parasysh se a kishte vendim nga institucioni shëndetësor, ose

c) i dënuar të lirohet me kusht (pa marr parasysh se a kishte vendim nga institucioni shëndetësor) dhe ti shqiptohet masa e sigurisë mjekim i detyrueshëm psikiatrik në liri.⁶⁵

Mjekim i detyrueshëm psikiatrik në liri mund të zëvendësohet me mjekim dhe ruajtje të detyrueshme psikiatrike në institucion shëndetësor. Kjo, në rastet kur gjykata do të marrë informacion nga institucioni shëndetësor në të cilin i akuzuari e shqipton masën e sigurisë mjekim i detyrueshëm psikiatrik në liri se i akuzuari është shëruar apo është dashur të shërohet. Në bazë të dispozitave të Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale, institucioni shëndetësor në të cilin realizohet mjekimi i obligueshëm psikiatrik në liri, obligohet që së paku çdo gjashtë muaj të njoftoj gjykatën që e ka miratuar vendimin në shkallën e parë, për gjendjen shëndetësore të personit ndaj të cilit zbatohet kjo masë dhe për rezultatin e mjekimit.⁶⁶

Gjykata do të vendosë të zëvendësojë mjekimin e detyrueshëm në liri me mjekimin e detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtja në institucion shëndetësor në rastë se:

a) i akuzuari nuk i është nënshtrua fare mjekimit;

b) i akuzuari me vetdëshirë është larguar nga mjekimi ose

c) gjendja shëndetësore e të akuzuarit është përkeqësuar ndjeshëm dhe është bërë më e rrezikshme për rrethinën e saj që kur gjykata përcaktoi masën e sigurisë.

Gjykata para se të marrë vendimin për ndryshimin e masës së sigurisë është e obliguar të marr mendimin e Prokurorit publik dhe të mjekut të institucionit shëndetësor ku ishte i akuzuari dhe gjithashtu do ta merrte në pyetje të akuzuarin nëse ajo do të ishte e mundur.⁶⁷

⁶⁵ Г. Калајџијев Г. Лажетиќ Л. Неделкова М. Денковска М. Тромбева Т. Витларов П. Јанкуловска Д. Кадиев, КОМЕНТАР НА ЗАКОНОТ ЗА КРИВИЧНАТА ПОСТАПКА, ноемри 2018,ст.1024,1025

⁶⁶ Shih Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve 2/2006 neni 249

⁶⁷ Г. Калајџијев Г. Лажетиќ Л. Неделкова М. Денковска М. Тромбева Т. Витларов П. Јанкуловска Д. Кадиев, КОМЕНТАР НА ЗАКОНОТ ЗА КРИВИЧНАТА ПОСТАПКА, ноемри 2018,ст.1024,1025

3.7 Zbatimi i masave të sigurisë mjekim i detyrueshëm për alkoolistët dhe narkomanët

Kur sëmundja e varësisë nga alkooli ose droga do të konstatohet nga ekspetriza psikiatrike nga eksperti – psikiatër në seancë kryesore nga ana e Prokurorit publik do të shqyrtohen rrethanat të cilat do të ishin më të përshtatshme për mjekimin e të akuzuarit, ku gjykata mund të përcaktojë masën e sigurisë mjekim i detyrueshme i alkoolistëve dhe narkomanëve. Institucioni shëndetësor në të cilin kryhet mjekimi i alkoolistëve dhe narkomanëve, në përputhje me dispozitat e Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale është i detyruar që të paktën çdo gjashtë muaj ta informoj gjykatën që ka miratuar vendim në shkallën e parë për gjendjen shëndetësore të personit ndaj të cilit zbatohet kjo masë dhe për rezultatin e mjekimit. Institucioni e njofton gjykatën që e ka miratuar vendimin e shkallës së parë për përfundimin e mjekimit të personit ndaj të cilit është kumtuar mjekim i oligueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve. Nëse personi i dënuar pa shkak të arsyeshëm nuk i nënshtrohet mjekimit ose e ndërprente mjekimin institucioni shëndetësor e njofton për këtë gjykatën që e ka miratuar vendimin në shkallën e parë.⁶⁸

3.8 Zbatim i masave të sigurisë mjekimi medicinalo-farmakologjik

Procedura e trajtimit të masës së sigurisë tretman mjeksor farmakologjik është e rregulluar me Ligjin mbi ekzekutimin e sanksioneve penale të Republikës së Maqedonisë së Veriut edhe atë me ndryshimet e bëra në këtë ligj në nëntor të vitin 2014 si rrjedhojë e ndryshimit paraprak të Kodit Penal dhe inkorporimit të masës së re të sigurisë “Tretman mjeksor- farmakologjik” ku si risi u inkorporua një kapitull i tërë, kapitulli XXI tretmani mjekësor

⁶⁸ Shih, Ligjin mbi zbatimin e sanksioneve 2/2006, nenet 254,255

farmakologjik i kryerësve të veprave penale sulm seksual ndaj fëmijës i cili nuk ka mbushur 14 vjet”.

Këshut sipas nenit 257-a të këtij Ligji tretmani mjekësor farmakologjik i kryerësve të veprave penale sulm seksual ndaj fëmijës i cili nuk ka mbushur 14 vjet ekzekutohet në institucione të specializuara mjekësore. Se cilat janë këta institucione të specializuara dhe mënyra e ekzekutimit të kësaj mase Ligji në këtë nen përcakton se do të rregullohet me Udhëzim nga Ministri i shëndetësisë.⁶⁹

Institucionet përgjegjëse për mbarvajtjen e ekzekutimit të kësaj mase është Drejtoria për ekzekutimin e sanksioneve në bashkëpunim me Entet kushtetuese-burgjet dhe entet e specializuara mjekësore. Kështu, Entet korrektuese e kanë që menjëher pas fillimit të mbajtjes së dënimit me burg të të dënuarit ta dërgojn deri te Drejtoria për ekzekutimin e sanksioneve penale vendimin gjyqësor me të cilin personit në fjalë është shqiptuar kjo masë (paragrafi 1 – neni 257 –b). Mënyra se si do të dorëzohen këto të dhëna më për së afërmi do të rregullohet me Akt të cilin do ta sjell Ministri i drejtësisë (paragrafi 4–neni 257-b). Më tej kjo drejtori vendimin e tij gjyqësor e dërgon te institucioni i specializuar mjekësor para se të fillojë fazën përgaditore për leshimin e personit të dënuar me qëllim të kryerjes së analizave dhe përgaditjen e tij për tretmanin mjekësor farmakologjik (paragrafi 2–neni 257-b). Zbatimi i masës do të fillojë pas vuajtjes së dënimit me burg (paragrafi 3 – neni 257-b).⁷⁰

Për fillimin dhe për rrjedhën e zbatimit të masës mjekim mjekësor-farmakologjik, institucioni i specializuar mjekësor është i obliguar që çdo gjashtë muaj ta njoftojë Drejtorinë për Zbatimin e Sanksioneve. Drejtoria për zbatimin e sanksioneve mundet edhe jashtë afateve të kërkojë njoftim nga institucioni i specializuar mjekësor për gjendjen shëndetësore të personit ndaj të cilit kryhet kjo masë dhe rezultatin nga zbatimi i masës. Prandaj, drejtoria për zbatimin e sanksioneve të paktën një herë në gjashtë muaj e njofton gjykatën për zbatimin e masës ose për nevojën e vazhdimit ose ndërprerjen e saj. (neni 275-v).

⁶⁹ Ratkoceri, V (2017). Chemical castration as a security measure in the criminal legislation of the Republic of Macedonia. International Journal of Social Sciences and Education Research, Vol (3) 2,

⁷⁰ Po, aty

Nëse personit të cilit i është shqiptuar masa mjekim mjekësor-farmakologjik detyrohet që për çdo ndryshim të adresës ta njoftojë institucionin e specializuar mjekësor. (neni 275-g).

Personi i cili për shkaqe të arsyeshme nuk paraqitet në zbatimin e masës, është i obliguar që në afat prej tri ditësh nga dita kur është dashur të paraqitet në institucionin e specializuar mjekësor, ta arsyetojë mungesën e vet dhe për këtë ta njoftojë institucionin.

Institucioni i specializuar mjekësor mundet personit t'ia prolongojë zbatimin e masës mjekim mjekësor farmakologjik nëse dorëzon dëshmi se: - gjendet në mjekim spitalor ose - ndodh vdekje e anëtarit të familjes më të ngushtë të personit. Prolongimi i zbatimit të masës mund të zgjasë më së voni deri në kryerjen e mjekimit spitalor, respektivisht tri ditë pas vdekjes së anëtarit të familjes së ngushtë. Institucioni i specializuar mjekësor pas marrjes së njoftimit nga personi i cakton termin të ri dhe për këtë e njofton drejtorinë për zbatimin e sanksioneve.(neni -275 –d)

Nëse personi i gjykuar pa shkak të arsyeshëm nuk i nënshtrohet zbatimit të masës mjekim mjekësor farmakologjik ose pas skadimit të tri ditëve nga dita kur është dashur të paraqitet për zbatimin e masës në institucionin e specializuar mjekësor këtë nuk e bën, institucioni është i obliguar që në afat prej 48 orësh për këtë ta njoftojë drejtorinë për zbatimin e sanksioneve. Për refuzimin ose lëshimin e mjekimit drejtoria për zbatimin e sanksioneve pa prolongim do ta njoftojë gjykatën kompetente për zbatimin e sanksioneve. Për zbatimin e masës mjekim mjekësorfarmakologjik, gjykata pa prolongim do të miratojë urdhëresë për arrestim të detyrueshëm të personit, të cilën e dorëzon në polici. Nëse personi nuk mund të arrestohet gjykata do të shpallë fletarrest për gjetjen dhe arrestimin e personit. Shpenzimet për arrestimin e detyrueshëm janë në ngarkim të personit (neni 275-gj)

Shpenzimet e zbatimit të masës mjekim mjekësor farmakologjik janë në ngarkim të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Ndërsa drejtoria për zbatimin e sanksioneve vendos dhe mban evidencë të veçantë për personat e gjykuar të cilëve u është shqiptuar masa

mjekim mjekësor-farmakologjik. Formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës i përcakton Ministri i drejtësisë (neni 257-e) ⁷¹

⁷¹ Shih Ligjin mbi ekzekutimin e sanksioneve penale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 2/2006, 57/10,170/13 dhe 43/14)

KAPITULLI IV

4. SHQIPTIMI I MASAVE TË SIGURISË NË GJYKATËN THEMELORE PENALE SHKUP PËR PERIUDH KOHORE 2015-2020 – STUDIM EMPIRIK

Duke shqiptuar këtë masë, bëhet përpjekje që ata persona të shërohen dhe rehabilitohen në mënyrë që në të ardhmen mos të përsërisin sjelljen kriminele. Lidhur me shqiptimin dhe ekzekutimin e kësaj mase në teorinë penologjike, ka mendime dhe pikëpamje të ndryshme. Në rendë të parë flitet për nevojën që këto masa të shërimit të ndërmerren para se personat e tillë të kryejnë sjellje devijante dhe kriminale. Pra, ka mendime të cilat thekësojnë se organet kompetente dhe shërbimet e ndryshme të specializuara duhet të kyçen në trajtimin dhe rehabilitimin e këtyre personave, para se ata të kryejnë vepra të rrezikshme penale. Sipas këtyre, nuk duhet pritur që personat e tillë të kryejnë vepra penale dhe të shkaktojnë pasoja të rënda për familjen dhe mjedisin ku jetojnë dhe punojnë. Në këtë mënyrë me siguri do të parandalohet fare aktiviteti i tyre eventual kriminal. Nga ana tjetër, mendimet të cilat i kundërvihen këtij propozimi theksojnë se kjo masë duhet shqiptuar vetëm ndaj kryerësve të veprave penale, me qëllim që të pengohet keqpërdorimi, arbitrarizimi dhe shkelja e lirive dhe të drejtave të njeriut. Në këtë drejtim, autorët të cilët i përkrahin këtë propozim, theksojnë se nga përrvoja në shumë vende vërehet se janë bërë keqpërdorime dhe njerëzit e caktuar janë shpallur si alkoolistë apo persona të sëmurë shpirtërisht dhe janë vendosur nëpër ente speciale psikiatrike, me qëllim të eliminimit të tyre nga trashëgimia, nga puna ose për arsye të rivalitetit politik apo në biznes etj.⁷²

Sido që të jetë, këto mendime dhe dilema të ndryshme rreth masave të sigurisë në Kodin Penal në Republikën e Maqedonisë së Veriut me vështrim të veçant në Gjykatën themelore penale Shkup për periudhën 2015-2020 nuk pengojnë që personat të cilët kanë nevojë për trajtime të tilla apo dhe ata të cilët kanë vullnetin e tyre për shërim të tillë gjykata nuk është penges mirëpo është një urë lidhëse mes të akuzuarit dhe institucionit shëndetësor që kjo masë të arrij qëllimin e caktuar.

⁷² R. Halili: Aspektet juridike dhe kriminologjike të alkoolizmit dhe narkomanisë. Përparimi nr.2. Prishtinë, 1984, fq.177-178 dhe 183-184

4.1 Të dhënat e Entit shtetëror të statistikave për shqiptimin e masave të sigurisë ndaj personave madhor në RMV-së për periudhën 2015-2020

Në këto të dhëna jemi informuar nga Enti Shtetëror për statistik të Republikës së Maqedonisë së Verut, nga ku kemi marrë të dhëna nga enti prej vitit 2015 deri në vitin 2020. Sipas tabelave të paraqitura më poshtë vërrejm se numri i veprave penale dhe gjegjësisht i masve të sigurisë shkon në rritje . Andaj, mendoj se marrja e këtyre masave në të ardhmen është më se e domosdoshme.

Sipas paraqitjes së të dhënave të marrura nga Enti Shtetëror i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën kohore pesë vjeçare nga viti 2015 deri më 2020 kemi pasqyrë të numrit për persona të akuzuar, për persona të cilëve ju është shqiptuar masa e burgimit dhe shqiptim i masës së sigurisë.

Shpresojë që në bazë të kësaj tabele të kemi një pasqyr më të qartë rreth kësaj dukurie se sa ajo është pjesmarrëse në vendin tonë dhe sa punohet rreth zgjidhjes së problemit.

4.1.1 Të dhënat për shqiptimin e masës Shërim i obligueshëm psikiatrik dhe ruajtje në ent shëndetësor

Tabela 1

Personat e gjykuar për veprë penale dhe në bazë të shqiptimit të Masave të sigurisë sipas entit për statistikë në vitet 2015 - 2020

Vitet	Gjithësej	Femra	Gjithësej Masa të Sigurisë	Mjekim i detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtja në institucion shëndetësor
2015	10.312	863	63	12
2016	8.172	723	71	27
2017	6.273	550	86	42
2018	9.320	868	27	/
2019	12.255	410	199	/
2020	/	/	/	/

Burimi: Enti shtetëror i statistikës

Në tabelën më lartë në vitin 2015 mund të shihet se janë paraqitur gjithësej 10.312 persona ndaj të cilëve janë shqiptuar dënime për vepra penale, të cilat janë kryer nga 863 femra, ndërsa masa të sigurisë gjithësej nga ky numër i kryer i veprave penale kemi 63 dhe për 12 persona janë shqiptuar masa e sigurisë- mjekim i detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtja në ent shëndetësor.

Në tabelën më lartë në vitin 2016 mund të shihet se janë paraqitur gjithësej 8.172 persona ndaj të cilëve janë shqiptuar dënime për vepra penale, të cilat janë kryer nga 723 femra, ndërsa masa të sigurisë gjithësej nga ky numër i kryer i veprave penale kemi 71 dhe për 27 persona janë shqiptuar masa e sigurisë- mjekim i detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtja në ent shëndetësor.

Në tabelën më lartë në vitin 2017 mund të shihet se janë paraqitur gjithësej 6.273 persona ndaj të cilëve janë shqiptuar dënime për vepra penale, të cilat janë kryer nga 550 femra, ndërsa

masa të sigurisë gjithësej nga ky numër i kryer i veprave penale kemi 86 dhe për 42 persona janë shqiptuar masa e sigurisë- mjekim i detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtja në ent shëndetësor.

Në tabelën më lartë në vitin 2018 mund të shihet se janë paraqitur gjithësej 9.320 persona ndaj të cilëve janë shqiptuar dënime për vepra penale, të cilat janë kryer nga 868 femra, ndërsa masa të sigurisë gjithësej nga ky numër i kryer i veprave penale kemi 27 dhe për 0 persona janë shqiptuar masa e sigurisë- mjekim i detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtja në ent shëndetësor.

Në tabelën më lartë në vitin 2019 mund të shihet se janë paraqitur gjithësej 12.255 persona ndaj të cilëve janë shqiptuar dënime për vepra penale, të cilat janë kryer nga 410 femra, ndërsa masa të sigurisë gjithësej nga ky numër i kryer i veprave penale kemi 199 dhe për 0 persona janë shqiptuar masa e sigurisë - mjekim i detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtja në ent shëndetësor.

Në kërkes për të dhënat nga viti 2018,2019,2020 nuk kemi të dhëna konkrete për masat e sigurisë mjekim i detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtja në ent shëndetësor nga Enti Shtetëror për Statistikë. Mirëpo, më e rëndësishmja për analizën tonë në këtë tabel është shqiptimi i masës – mjekim i detyrueshëm psikiatrik në ent shëndetësor ku sipas kësaj tabele vërejm se numri i shqiptimit të kësaj mase të sigurisë shkon në rritje.

4.1.2 Të dhënat për shqiptimin e masës Shërim i obligueshëm psikiatrik në liri

Tabela 2

Personat e gjykuar për veprë penale dhe në bazë të shqiptimit të Masave të sigurisë sipas entit për statistikë në vitet 2015 - 2020

Vitet	Gjithësej	Femra	Gjithësej Masa të Sigurisë	Mjekim i detyrueshëm psiikiatrik në liri
2015	10.312	863	63	26

2016	8.172	723	71	26
2017	6.273	550	86	35
2018	9.320	868	27	/
2019	12.255	410	199	/
2020	/	/	/	/

Burimi: Enti shtetëror i statistikës

Në tabelën numër 2 do të flasim më konkretisht për shqiptimin e masës së sigurisë – mjekim i detyrueshëm në liri, në te cilën dhe në këtë masë vërrejm ndryshim në vite mirëpo edhe këtu hasim në rritje të kësaj dukurie dhe shtimi i personave të cilët janë të dënuar në bazë të kësaj mase çdo vit është më i lartë.

4.1.3 Të dhënat për shqiptimin e masës shërim i obligueshëm i alkolistëve dhe narkomanëve

Tabela 3

Personat e gjykuar për vepër penale dhe në bazë të shqiptimit të Masave të sigurisë sipas entit për statistikë në vitet 2015 - 2020

Vitet	Gjithësej	Femra	Gjithësej Masa të Sigurisë	Mjekim i detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve
2015	10.312	863	63	25
2016	8.172	723	71	18
2017	6.273	550	86	9
2018	9.320	868	27	/
2019	12.255	410	199	/
2020	/	/	/	/

Burimi: Enti shtetëror i statistikës

Gjithashtu dhe në tabelën numër 3 ku janë paraqitur të dhënat e personave të dënuar për vepra penale në përgjithësi, mirëpo ne do të flasim me konkretisht për masat e sigurisë gjegjësisht masa - mjekim i detyrueshëm i aloolistëve dhe narkomanëve ku në krahasim me tabelat më lartë për shqiptimin e masave të sigurisë – mjekim i detyrueshëm psikiatrik në ent shëndetësor dhe mjekimi detyrueshëm psikiatrik në liri këtu vërejm se numri i kësaj mase është dukshëm në zbritje edhe pse nuk mund të japim një konkludim shumë të sakt pasi që nuk kemi të dhëna nga enti për vitet në vijim (2018,2019,2020).

4.1.4 Të dhënat për shqiptimin e masës tremtani mjekësor – farmakologjik për abuzuesit seksual të fëmijëve nën moshën 14 vjeçare

Tabela 4

Personat e gjykuar për vepra penale dhe në bazë të shqiptimit të Masave të sigurisë sipas entit për statistikë në vitet 2015 - 2020

Vitet	Gjithësej	Femra	Masa të siguris	Sulmi seksual ndaj fëmijës i cili nuk ka mbushur 14 vjet	Mjekimi medicinal-farmakologjik
2015	56	/	1	12	/
2016	39	1	/	10	/
2017	38	1	5	9	/
2018	45	1	4	/	/
2019	23	/	5	/	/
2020	/	/	/	/	/

Burimi: Enti shtetëror i statistikës

Pra, siç mund të shihet nga tabela numër 4 ku kemi të paraqitur persona e akuzar në përgjithësi për të cilët shqiptohet masë e sigurisë – mjekim medicinal farmakologjin sulm seksual ndaj fëmijëve i cili nuk ka mbushur 14 vjet shiç e parasheh Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut në bazë të nenit 188, mund të shihet se gjithësej persona që kanë kryer

kët vepër penale për katër vite kemi 201 të akuzuar të cilët janë kryer nga 3 femra ndërsa masa të sigurisë gjithësej nga ky numër i kryer i veprave penale kemi 15 dhe 31 persona të akuzuar janë regjistruar për kryerje të veprës “ sulm seksual ndaj fëmijëve i cili nuk ka mbushur 14 vjet” për të cilët është dhënë dënimi me burgim mirëpo masa e mjekimit medicinal farmakologjik nuk është shqiptuar për personat e veprës së kryer. Edhe në këtë tabel vërrejm ulje në numrin e kryerjes së kësaj mase mirëpo edhe sot e kësaj dite nuk hasim në përdorimin e trajtimit (mjekimi) farmakologjik të personave të cilët kryejn vepren e nenit 188 të Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

4.2 Të dhënat e Gjykatës themelore penale në Shkup për shqiptimin e masave siguruese për periudhën 2015-2020

Nga të dhënat e Gjykatës themelore penale Shkup na janë dërguar të dhëna mbi numrin e lëndëve për periudhë të caktuar kohore duke filluar 2015 deri më 2020 të cilat regjistrohen dhe evidentohen në programin AKMIS në të cilin mbahen të gjitha të dhënat lidhur me lëndët. Prandaj, në këtë tabel kamë shfrytëzuar të dhënat për të pasur një pasqyr gjatë punimit mbi analizën e lëndëve të cilat gjykohen në bazë të masave të sigurisë.

Tabela 1

Lëndët nga Masat e sigurisë në Gjykatën penale Shkup gjatë vitit 2015-2020

Vitet	Lëndë të pazgjedhura në fillim të vitit	Lëndë të reja të pranuar	Gjithsej lëndë në punë	Lëndë të zgjedhura	Lëndë të pazgje dhura
2015	11.961	22.241	34.382	22.830	11.961
2016	11.553	33.996	45.549	29.509	16.040
2017	16.040	23.120	39.160	31.636	7.500

2018	7.500	20.472	27.972	24.221	3.751
2019	3.751	20.061	23.812	20.265	3.548
2020	4.796	4.513	9.309	3.805	5.504

Burimi: Gjykata themelore penale Shkup

Nga tabela e paraqitur më lartë shohim se në sektorin penal - masat e sigurisë në periudhën raportuese të vitit 2015 gjithësej në punë ka pasur 34.382 lëndë nga të cilat 11.961 lëndë janë përcjellur si të pazgjedhura nga viti i mëparshëm, ndërsa 22.241 lëndë janë lëndë të reja të pranuar, me çka gjykata gjithësej ka zgjedhur 22.830 lëndë, ndërsa në fundin e vitit kanë ngelur të pazgjedhura 11.961 lëndë që transferohen në vitin e ardhshëm.

Nga tabela e paraqitur më lartë shohim se në sektorin penal - masat e sigurisë në periudhën raportuese të vitit 2016 gjithësej në punë ka pasur 45.549 lëndë nga të cilat 11.553 lëndë janë përcjellura si të pazgjedhura nga viti i mëparshëm, ndërsa 33.996 lëndë janë lëndë të reja të pranuar, me çka gjykata gjithësej ka zgjedhur 29.509 lëndë, ndërsa në fundin e vitit kanë ngelur të pazgjedhura 16.040 lëndë që transferohen në vitin e ardhshëm. Në raport me vitin e mëparshëm kur gjykata në punë ka pasur gjithësej 34.382 lëndë, në periudhën raportuese fushëveprimi i punës u zmadhua për 11.167 lëndë, për shkak të fluksit të zmadhuar që është për 11.167 lëndë më shumë në krahasim me vitin e kaluar kur janë pranuar 11.961 lëndë. Në këtë vit numri i lëndëve të zgjedhura në periudhën raportuese është zmadhuar për 11.167 në krahasim me vitin e kaluar ku janë zgjedhur 22.830 lëndë.

Nga tabela e paraqitur më lartë shohim se në sektorin penal - masat e sigurisë në periudhën raportuese të vitit 2017 gjithësej në punë ka pasur 39.160 lëndë nga të cilat 16.040 lëndë janë përcjellura si të pazgjedhura nga viti i mëparshëm, ndërsa 23.120 lëndë janë lëndë të reja të pranuar, me çka gjykata gjithësej ka zgjedhur 31.636 lëndë, ndërsa në fundin e vitit kanë ngelur të pazgjedhura 7.500 lëndë që transferohen në vitin e ardhshëm. Në raport me vitin e mëparshëm kur gjykata në punë ka pasur gjithësej 45.549 lëndë, në periudhën raportuese fushëveprimi i punës u zvogëlua për 6.389 lëndë, për shkak të fluksit të zvogëluar që është për

6.389 lëndë më pak në krahasim me vitin e kaluar kur janë pranuar 16.040 lëndë. Në këtë vit numri i lëndëve të zgjedhura në periudhën raportuese është zvogëluar për 31.636 në krahasim me vitin e kaluar ku janë zgjedhur 29.509 lëndë.

Nga tabela e paraqitur më lartë shohim se në sektorin penal - masat e sigurisë në periudhën raportuese të vitit 2018 gjithësej në punë ka pasur 27.972 lëndë nga të cilat 7.500 lëndë janë përcjellura si të pazgjedhura nga viti i mëparshëm, ndërsa 20.472 janë lëndë të reja të pranuar, me çka gjykata gjithësej ka zgjedhur 24.221 lëndë, ndërsa në fundin e vitit kanë ngelur të pazgjedhura 3.751 lëndë që transferohen në vitin e ardhshëm. Në raport me vitin e mëparshëm kur gjykata në punë ka pasur gjithësej 39.160 lëndë, në periudhën raportuese fushëveprimi i punës u zvogëlua për 11.178 lëndë, për shkak të fluksit të zvogëluar që është për 11.178 lëndë më pak në krahasim me vitin e kaluar kur janë pranuar 23.120 lëndë. Në këtë vit numri i lëndëve të zgjedhura në periudhën raportuese është zvogëluar për 24.221 në krahasim me vitin e kaluar ku janë zgjedhur 31.636 lëndë.

Nga tabela e paraqitur më lartë shohim se në sektorin penal - masat e sigurisë në periudhën raportuese të vitit 2019 gjithësej në punë ka pasur 23.812 lëndë nga të cilat 3.751 lëndë janë përcjellura si të pazgjedhura nga viti i mëparshëm, ndërsa 20.061 janë lëndë të reja të pranuar, me çka gjykata gjithësej ka zgjedhur 20.265 lëndë, ndërsa në fundin e vitit kanë ngelur të pazgjedhura 3.548 lëndë që transferohen në vitin e ardhshëm. Në raport me vitin e mëparshëm kur gjykata në punë ka pasur gjithësej 27.972 lëndë, në periudhën raportuese fushëveprimi i punës u zvogëlua për 4.160 lëndë, për shkak të fluksit të zvogëluar që është për 4.160 lëndë më pak në krahasim me vitin e kaluar kur janë pranuar 20.061 lëndë. Në këtë vit numri i lëndëve të zgjedhura në periudhën raportuese është zvogëluar për 20.265 në krahasim me vitin e kaluar ku janë zgjedhur 24.221 lëndë.

Ndërsa nga Gjykata themelore penale Shkup për vitin 2020 nuk kemi raport të plotë vjetor por për gjysmë viti.

4.2.1 Të dhënat për shqiptimin e masës Shërim i obligueshëm psikiatrik dhe ruajtje në ent shëndetësor

Tabela 1

Vitet	Gjithsej masa të sigurisë	Lënd të zgjedhura	Lënd të plotëfuqishm e	Mjekim i obligueshëm psikiatrik në institucion shëndetësor	Lënd të zgjedhura	Lënd të plotëfuqishm e
2015	22	11	10	9	5	4
2016	25	12	13	13	6	7
2017	29	12	7	10	7	3
2018	31	17	14	7	3	4
2019	48	23	25	19	9	10
2020	37	18	19	13	6	7

Burimi: Gjykata themelore penale Shkup

Nga të dhënat e Gjykatës themelore penale Shkup të cilat janë paraqitur në tabelën më lartë kemi bër një studim për periudhën kohore nga viti 2015 deri më vitin 2020 ku janë shqiptuar gjithësej 192 raste mbi masat e sigurisë nga të cilat 93 lëndë janë të zgjedhura dhe 88 lëndë kanë fituar plotëfuqishmërin. Mirëpo, gjatë këtij studimi më tepër jemi fokusuar nga të dhënat e gjykatës mjekim i detyrueshëm psikiatrik në institucion shëndetësor ku për vitin 2015 kjo masë është dhënë për 9 persona të cilët kanë kryer vepër penale nga 5 lëndë të zgjedhura 4 kanë plotfuqishmërin, në vitin 2016 është caktuar masë siguroese mjekim i detyrueshëm psikiatrik në institucion shëndetësor për 13 persona që kanë kryer vepër penale nga 6 lëndë të zgjedhura 7 kanë plotfuqishmërin, në vitin 2017 është caktuar masë siguroese mjekim i detyrueshëm psikiatrik në institucion shëndetësor për 10 persona që kanë kryer vepër penale

nga 7 lënd të zgjedhura 3 kanë plotfuqishmërin, në vitin 2018 është caktuar masë siguruese mjekim i detyrueshëm psikiatrik në institucion shëndetësor për 7 persona që kanë kryer vepër penale nga 3 lënd të zgjedhura 4 kanë plotfuqishmërin, në vitin 2019 është caktuar masë siguruese mjekim i detyrueshëm psikiatrik në institucion shëndetësor për 19 persona që kanë kryer vepër penale nga 9 lënd të zgjedhura 10 kanë plotfuqishmërin, në vitin 2020 është caktuar masë siguruese mjekim i detyrueshëm psikiatrik në institucion shëndetësor për 13 persona që kanë kryer vepër penale nga 6 lënd të zgjedhura 7 kanë plotfuqishmërin. Nga të dhënat e këtij hulumtimi të veprave penale tregojnë se masat e sigurisë të cilat shqiptohen së bashku me sanksionin e caktuar penal ku qëllimi i tyre është evitimi i rrethanave të cilat kanë kontribuar në kryerjen e veprës penale.

4.2.2. Të dhënat për shqiptimin e masës Shërim i obligueshëm psikiatrik në liri

Tabela 2

Vitet	Gjithësej masa të sigurisë	Lënd të zgjedhura	Lënd të plotëfuqishm e	Mjekim i obligueshëm psikiatrik në liri	Lënd të zgjedhura	Lënd të plotëfuqishm e
2015	22	11	10	11	6	5
2016	25	12	13	7	3	4
2017	29	12	7	8	4	4
2018	31	17	14	12	8	4
2019	48	23	25	19	9	10
2020	37	18	19	13	6	7

Burimi: Gjykata themelore penale Shkup

Nga të dhënat e Gjykatës themelore penale Shkup të cilat janë paraqitur në tabelën më lartë kemi bër një studim për periudhën kohore nga viti 2015 deri më vitin 2020 ku janë shqiptuar gjithësej 192 raste mbi masat e sigurisë nga të cilat 93 lëndë janë të zgjedhura dhe 88 lëndë kanë fituar plotëfuqishmërin. Mirëpo, gjatë këtij studimi më tepër jemi fokusuar nga të dhënat e gjykatës mjekim i detyrueshëm psikiatrik në liri ku për vitin 2015 kjo masë është dhënë për 11 persona të cilët kanë kryer vepër penale nga 6 lëndë të zgjedhura 5 kanë plotfuqishmërin, në vitin 2016 është caktuar masë siguruese mjekim i detyrueshëm psikiatrik në liri për 7 persona që kanë kryer vepër penale nga 3 lëndë të zgjedhura 4 kanë plotfuqishmërin, në vitin 2017 është caktuar masë siguruese mjekim i detyrueshëm psikiatrik në liri për 8 persona që kanë kryer vepër penale nga 4 lëndë të zgjedhura 4 kanë plotfuqishmërin, në vitin 2018 është caktuar masë siguruese mjekim i detyrueshëm psikiatrik në liri për 12 persona që kanë kryer vepër penale nga 8 lëndë të zgjedhura 4 kanë plotfuqishmërin, në vitin 2019 është caktuar masë siguruese mjekim i detyrueshëm psikiatrik në liri për 19 persona që kanë kryer vepër penale nga 9 lëndë të zgjedhura 10 kanë plotfuqishmërin, në vitin 2020 është caktuar masë siguruese mjekim i detyrueshëm psikiatrik në liri për 13 persona që kanë kryer vepër penale nga 6 lëndë të zgjedhura 7 kanë plotfuqishmërin. Dhe nga kjo vërrejm se nga masa paraprake numri i shqiptimit të këtyre masave relativisht është i njejtë.

4.2.3 Të dhënat për shqiptimin e masës shërim i obligueshëm i alkolistëve dhe narkomanëve

Tabela 3

Vitet	Gjithësej masa të sigurisë	Lënd të zgjedhura	Lënd të plotëfuqishme	Mjekim i obligueshëm i alkolistëve dhe narkomanëve	Lënd të zgjedhura	Lënd të plotëfuqishme
2015	22	11	10	1	0	1
2016	25	12	13	5	3	2
2017	29	12	7	1	1	0
2018	31	17	14	12	6	6

2019	48	23	25	10	5	5
2020	37	18	19	11	6	5

Burimi: Gjykata themelore penale Shkup

Nga të dhënat e Gjykatës themelore penale Shkup të cilat janë paraqitur në tabelën më lartë kemi bër një studim për periudhën kohore nga viti 2015 deri më vitin 2020 ku janë shqiptuar gjithësej 192 raste mbi masat e sigurisë nga të cilat 93 lëndë janë të zgjedhura dhe 88 lëndë kanë fituar plotfuqishmërin. Mirëpo, gjatë këtij studimi më tepër jemi fokusuar nga të dhënat e gjykatës mjekim i detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve ku për vitin 2015 kjo masë është dhënë për 1 persona të cilët kanë kryer vepër penale nga 0 lëndë të zgjedhura 1 ka plotfuqishmërin, në vitin 2016 është caktuar masë siguroese mjekim i detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve për 5 persona që kanë kryer vepër penale nga 3 lëndë të zgjedhura 2 kanë plotfuqishmërin, në vitin 2017 është caktuar masë siguroese mjekim i detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve për 1 persona që kanë kryer vepër penale nga 1 lëndë të zgjedhura 0 kanë plotfuqishmërin, në vitin 2018 është caktuar masë siguroese mjekim i detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve për 12 persona që kanë kryer vepër penale nga 6 lëndë të zgjedhura 6 kanë plotfuqishmërin, në vitin 2019 është caktuar masë siguroese mjekim i detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve për 10 persona që kanë kryer vepër penale nga 5 lëndë të zgjedhura 5 kanë plotfuqishmërin, në vitin 2020 është caktuar masë siguroese mjekim i detyrueshëm psikiatrik i alkoolistëve dhe narkomanëve për 11 persona që kanë kryer vepër penale nga 6 lëndë të zgjedhura 5 kanë plotfuqishmërin. Nga ky hulumtim vërrejm se nga dy masat paraprake numri i shqiptimit për këtë masë është dukshëm më i vogël, mirëpo numri i personave me këtë masë shkon në rritje në krahasim me dy masat më herët.

4.2.4 Të dhënat për shqiptimin e masës tremtani mjekësor – farmakologjik për abuzuesit seksual të fëmijëve nën moshën 14 vjeçare

Tabela 4

Vitet	Gjithësej masa të sigurisë	Lënd të zgjedhura	Lënd të plotëfuqishme	Mjekim ndaj abuzuesve seksual të fëmijëve nën moshën 14 vjet	Lënd të zgjedhura	Lënd të plotëfuqishme
2015-2020	192	93	88	/	/	/

Burimi: Gjykata themelore penale Shkup

Nga Gjykata themelore penale Shkup na janë dërguar të dhëna mbi masat e sigurisë në përgjithësi mirëpo ajo çfarë është shqetësuese është fakti se ende edhe me kalimin e shtatë viteve nga vendosja e masës së sigurisë mjekimi medicinal-farmakologjikë ende nuk hasim që kjo masë shqiptohet në praktik.

Që nga viti 2014, autorët Tupançeski dhe Kiprijanovska në veprë e cituar kishin shprehur skepticizmin e tyre lidhur me zbatimin e kësaj mase. Skepticizmin dhe rezervën që e kishin autorët në fjalë ka të bëjë pikërisht me efektet që pritet të ketë zbatimi i kësaj mase sado që haptazi kanë përkrahur këtë iniciativ ligjore për të luftuar pedofilin në vendin tonë. Skepticizmi i tyre buronë pikërisht nga zgjidhja ligjore e KPMV-së dhe LESP-së rreth kësaj çështjeje e që sipas tyre ka disa anomali madje edhe esenciale, ku veçanërisht potencojnë:

- Kjo është dispozita e vetme e pjesës së përgjithëshme të KPMV-së që ka të bëjë vetëm me një inkriminim nga pjesa e veçantë e që është neni 188, në parim dispozitat e pjesës së përgjithëshme të KPMV-së kanë të bëjnë me të gjitha dispozitat e pjesës së veçantë.
- Njëra ndër dobësit më të mëdha të masës është edhe ajo se do të ekzekutohet pas mbajtjes së dënimit me burg, që do të thotë se mund edhe pas 40 viteve të kryerjes së veprës penale (!) –atëher çfarë është kjo ratio legis e dispozitës?

- Gjithashtu, gjykata është e obliguar që të vërtetoj “gjendjen e rrezikshme të kryerësit që në të ardhmen do të kryej vepra të tilla penale”, gjë që nuk është aspak e lehtë!
- Në kuptimin e të drejtave themelore të njeriut veçanërisht problematike është neni 7 nga dispozita ku recidivistët kjo masë mund të u shqiptohet edhe pa pajtim etj.⁷³

Edhe pse kjo masë është e rregulluar sipas Kodit Penal dhe Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale dhe legjislacioni ynë parasheh trajtimin në mënyrë vullnetar mirëpo ende nuk po gjen zbatim në vendin tonë.

4.3 Shqyrtimi i aktgjykimeve penale të rasteve ku janë shqiptuar masa sigurorese në Gjykatën themelore penale Shkup

4.3.1 Rasti i parë - Aktgjykim i masave sigurorese në shërbimin psikiatrik dhe ruajtja në institucion shëndetsorë

NË EMËR TË QYTETARËVE TË REPUBLIKËS

SË MAQEDONISË SË VERIUT

GYKATA THEMELORE PENALE SHKUP, si gjykatë e shkallës së parë penale dhe atë gjykatësi M.G. si kryetar i këshillit dhe gjykatësja X.X dhe gjykatësit porot P.P dhe V.V si anëtar të këshillit me procesmbajtës L.L duke vepruar në bazë të propozimit për shqiptim të masës së sigurisë –shërim i obliguar psikiatrik dhe ruajtje në institucionin shëndetësor KO nr.... nga data 22.07.2017 të PTHP kundër të akuzuarit Z.T nga Sh, për vepër penale –Vrasje nga neni 123

⁷³ Ratkoceri V., 2018-Kastrimi kimik si sanksion penal faqe 10 - tezë doktrature UEJL-Fakulteti juridik https://library.seeu.edu.mk/index.php?lvl=search_result

parag.2 nl nen.12 parag.1 nga LP, pas mbajtjes së seancës kryesore gojore dhe publike në prani të PP në PTHP N.N mbrojtësi i të akuzuarit i caktuar në formë ligjore av. S.S në mungesë të të akuzuarit, në pajtim me nen. 523 parag. 2 nga LPP me datën 13.12 2017 solli këtë:

A K T G J Y K I M

NDAJ TË AKUZUARIT

Z.T me numër amë..... nga babai L..., nëna V.... i lindur në K... por jeton në Sh. në rr..... nr....maqedonas, shtetas i Maqedonisë së Veriut, i pamartuar, i gjykuar, është në proces tjetër vepër penale, gjendet në paraburgim nga data 13.11.2017 deri më 27.11.2017 ku me aktvendim të Këshillit Penal KSP nr 327 /17 nga data 27.11.2017 i është ndërprerë masa e paraburgimit të akuzuarit dhe pas plotfuqishmërisë të këtij aktvendimi i akuzuari Z.T. është përkohësisht i strehuar në SHPSH Spital Psikiatrik, deri në përfundim të procesit për zbatim të masës së sigurisë – Shërim të obliguar psikiatrik dhe mbajtje në institucion shëndetësor.

Gjykata, në pajtim me nen. 63 nga LP i shqiptohet:

MASA E SIGURISË

SHËRBIM I OBLIGUAR PSIKIATRIK DHE RRUAJTJE NË INSTITUCION SHËNDETËSOR IPSH SPITALI PSIKIATRIK „SHKUP,,

PËRSHKAK SE:

Më datën 11/12.11.2017 rreth mesnate në shtëpi familjare të familjes T.....në të cilën kanë jetuar së bashku i akuzuari Z.T, i dëmtuari S.T.dhe nëna e tyre V.T në rr...., nr...në fsh. D.S në Sh i akuzuari në gjendje ku nuk ka mundur ta tij vlerën e veprës së tij dhe nuk ka mundur ti kontrollon veprimet e tia përshkak të sëmundjes së përhershme – shizofreni (DG SHIZOFRENIA – formë jo e diferencuar, gjatë kryerjes dhunë në familje është orvatur ta privon nga jeta të dëmtuarin vëllaun e tij S.T, në mënyrë që së pari i dëmtuari S.T në grindje familjare e ka sulmuar

nënë e tyre V.T, grindja fizike ka vazhduar ndërmjet dy vlezërve me çka i dëmtuari S.T kundër të akuzuarit Z.T ka sjellur me shufër alumini kur i akuzuari Z.T i prirë me ide psikopatologjike në kuadër të sëmundjes së tij të përhershme shpirtërore e ka marrë sëpatën dhe me atë ka sjellur në drejtim të pjesës së parme të kokës së vëllaut të tij të cilit i ka shkaktuar lëndim të rëndë trupor me rezik konkret ndaj jetës të shprehur si gjendje e pavetëdishme kome, thyerje në ashtin ballor të kafkës, derdhje gjaku në regjinë e ballit endem truror difuziv të trurit.

Me këto veprime i akuzuari Z.T ka kryer vepër penale vrasje nga neni 123 parag.2, p.2 nl, me nen.19 nl nen.12 parag.1 nga LP.

Në pajtim me nen.100-a nga LP nga i akuzuari MERRET një sëpatë me dorëz druri, kurse nga i dëmtuari S.T merret një shufër alumini, në dobi të R.M.

I dëmtuari S.T për kërkesë eventuale të dëmit kundrejt të akuzuarit drejtohet në kontest.

Shpenzimet e procesit penal bien në ngarkesë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

PTHP, deri nëm këtë gjykatë parashtroi propozim për shqiptim të masës së sigurisë KO...nr...nga data 22.11.2017, në PTHP, kundër të akuzuarit Z.T nga Sh, për vepër penale – vrasje nga nen.123 parag.2, pika 2 nl me nen.19 nl nen.12parag.1nga LP, dhe propozoi kundër të akuzuarit të shqiptohet masa e sigurisë shërim i obliguar psikiatrik dhe ruajtje në institucionin shëndetësor dhe parashtroi propozim të veçantë në pajtim me nen.522 nga LPP, masën për sigurim të paraburgimit e përcaktuar me aktvendim nga gjykatës në procedurë paraprake, të ndërpritet dhe se të akuzuarin Z.T deri në përfundim të procesit për zbatim të masës së sigurisë përkohësisht të vendoset në institucion përkatës shëndetësor apo hapsirë të përshtatshme. Me propozim të shqiptimit të masës së sigurisë prokurori publik dorzoi listë të dëshmime KO1 të datës 22.11.2017.

Para fillimit të shqyrtimit kryesor me datën 13.12.2017 prokurori publik morri në pyetje ekspertin D-r GJ.H.A në proporcion me aftësinë e të akuzuarit që ta përcjellë shqyrtimin kryesor,

me çka personi ekspert deklaroi se i akuzuari nuk është i aftë ta përcjell gjykimin e shqyrtimit kryesor.

Në shqyrtimin e mbajtur kryesor në formë gojore dhe publike me datën 13.12.2017 në mungesë të të akzuarit për shkak të gjendjes së tij shëndetsore që nuk ishte e tillë për të marrë pjesë në senacën kryesore, në pajtim me nen.523 parag.2 nga LPP dhe sipas mendimit të ekspertit në senacën kryesore pas fjalëve hyrëse të palëve gjykata solli aktvendim që të prezentohet procesi dëshmues me propozim të palëve dhe sipas radhitjes së vërtetuar në nen.382 nga LPP me çka prokurori publik e pyeti ekspertin e më pastaj u prezentuan dëshmitë materiale dhe me shkrim të propozuara nga ana e PTHP-së me listë të dëshmive dhe ate: vërtetim nga evidenca penalo-ndëshkimore në emër të Z.T të lëshuar nga Gjykata themelore Shkupi 1, njësi për evidencë penalo-ndëshkimore, mendim të ekspertit nga D-r specialist psikiatër GJ.

Nga data 17.11.2017, urdhër për ekspertizë psikiatrike nga eksperti gjyqësor, D-r specialist psikiatër Gj.H nga data 17.11.2017, raport mjeksor nga Ass. D-r, G.A, nga data 15.11.2017 me list të shpenzimit – kërkesë për pagesë të shpenzimeve nga data 15.11.2017, urdhër për ekspertizë të llojit dhe karakterit të lëndimeve të i dëmtuari S.T, dokumentacion mjeksor të siguruar nëpërmjet IPSH KU për Neurokirurgji nga data 13.11.2017, njoftim nga MPB e RM-së, sektori për dhunë në familje nga data 13.11.2017, njoftim nga MPB e R.M-së nga data 13.11.2017 nga IPQNKPS të Qytetit Sh, njoftim për kryerje të përpunimit tekniko-kriminalistik dhe sigurimi i gjurmëve me prejardhje biologjike, procesverbal i gjurmëve të gjetura dhe mjete në vendndodhje nga data 12.11.2017, shënim zyrtar për dalje në vendngjarje, procesverbal për kryerje të analizës së përbërjes së alkoolit të Z.T.

Prokurori publik në fjalën e tij përfundimtare të shqyrtimit kryesor kreu precizim të dispozitivit të propozimit për shqiptim të masës së sigurisë në aspekt të datë së sakt të kryerjes së veprës penale si në dispozitivin e aktgjykimit, kurse më tej ngeli në tërësi ndaj propozimit për shqiptim të masës së sigurisë, shërim obligativ psikiatrik dhe ruajtje në institucion shëndetësor në pajtim me nen nga LPP. Mbrojtësi i të akzuarit i emruar zyrtarisht avokat D.P në fjalën e tij përfundimtare theksoi se masën e sigurisë që e kërkon PTHP është e arsyeshme për shkak se

nga dëshmitë materiale si dhe ato verbale të sencës kryesore e ajo është sqarimi i personit ekspert u vërtetua se i akuzuari në momentin e seancës kryesore si dhe në momentin e kryerjes së veprës ka qen i pakontrolluar dhe i njëjti paraqet rrezik për rrethin dhe vetveten.

Duke i çmuar dëshmitë e dhëna të gjitha së bashku dhe secilën veç e veç gjykata e vërtetoi gjendjen faktike me sa vijon:

I akuzuari Z.T i lindur....., i pa martuar, i gjykuar, udhëhiqet pocedurë për vepër tjetër penale.

Më datën 11/12.11.2017 rreth mesnate në shtëpi familjare të familjes T.....në të cilën kanë jetuar së bashku i akuzuari Z.T, i dëmtuari S.T.dhe nëna e tyre V.T në rr...., nr...në fsh. D.S në Sh i akuzuari në gjendje ku nuk ka mundur ta tij vlerën e veprës së tij dhe nuk ka mundur ti kontrollon veprimet e tia përshkak të sëmundjes së përhershme – shizofreni (DG SHIZOFRENIA – formë jo e diferencuar, gjatë kryerjes dhunë në familje është orvatur ta privon nga jeta të dëmtuarin vëllaun e tij S.T, në mënyrë që së pari i dëmtuari S.T në grindje familjare e ka sulmuar nënën e tyre V.T, grindja fizike ka vazhduar ndërmjet dy vllazërve me çka i dëmtuari S.T kundër të akuzuarit Z.T ka sjellur me shufër alumini kur i akuzuari Z.T i prirë me ide psikopatologjike në kuadër të sëmundjes së tij të përhershme shpirtërore e ka marrë sëpatën dhe me atë ka sjellur në drejtim të pjesës së parme të kokës së vëllaut të tij të cilit i ka shkaktuar lëndim të rëndë trupor me rezik konkret ndaj jetës të shprehur si gjendje e pavetëdishme kome, thyerje në ashtin ballor të kafkës, derdhje gjaku në regjinë e ballit endem truror difuziv të trurit.

Për sjellje të vendimit si në dispozitivin gjykata udhëhiqej nga:

Nga shikimi në fotodokumentacion e MPB-Njësi të shikim në vendngjarje dhe analiza të datës 12.11.2017, u vërtetua koha, vendi dhe mënyra e kryerjes së veprës penale të ndodhisë kritike nga i akuzuari Z.T.

Nga shikimi i raportit mjeksor të datës 15.11.2017, gjykata vërtetoi se në ndodhinë kritike i dëmtuari S.T ka marrë lëndim të rëndë trupor me rrezik konkret ndaj jetës.

Nga shikimi të raportit dhe mendimit psikiatrik për të akuzuarin nga data 17.11.2017, si dhe dëshmia e ekspertit në senacën kryesore, gjykata vërtetoi se i akuzuari Z.T është i sëmurë me sëmundje të përhershme shpirtërore DG SHIZOFRENIA-formë jo e diferencuar F20.3. Sëmundja deri tani nuk është e trajtuar prandaj janë paraqitur më shumë funksione psiqike dhe dëmtimi i rëndë i tij fizik, i akuzuari është pa kontroll dhe ska vlersim të sëmundjes së tij dhe botës reale, në kohën e kryerjes së veprës nuk ka qen në gjendje domethënien e veprës së tij dhe ti kontrollon ndjenjat dhe veprimet e tij, ka qen në gjendje të çregulluar dhe eksperti D-r GJ., psikijatër dhe ekspert gjyqësor, propozoi që të akuzuarin ti shqiptohet masa e sigurisë, shërim të obliguar psikiatrik dhe rruajtje në institucionin shëndetësor.

Nga kqyrja në të dorzuarën të korporadelikti të PTHP-së nga data 22.11.2017 gjykata vërtetoi se në këtë gjykatë nga PTHP janë dorëzuar një sëpatë me dorëz druri, me të cilën i akuzuari e ka kryer veprën penale, një shufër alumini të cilën e ka përdorur i dëmtuari S.T në ndodhinë kriminale, një jelek, tri epruveta dhe një ziper qese me dy paketime të letrës, kurse kjo gjykatë urdhëroi me datën 13.12.2017 që të rruhen mjetet e apostrofuara deri në mbarim juridik të procedurës.

Nga dëshmitë e lartëpërmendura në seancën kryesore gjykata vërtetoi se në veprimet e të akuzuarit përmbahen të gjitha elementet qenësore të veprës penale – Vrasje nga nen.123 parag.2, p.2 nl nen.19 nl nen.12 parag.1 nga LP. Duke pasur parasysh raportin dhe mendimin psikiatrik nga eksperti psikiatër dhe ekspert gjyqësor D-r Gj.H se i akuzuari është i sëmurë nga sëmundje e përhershme shpirtërore DG. SHIZOFRENIA- formë jo e diferencuar dhe se në kohën e kryerjes së veprës i akuzuari nuk ka qenë në gjendje që ta kupton domethënien e veprës së tij dhe ti kontrollon veprimet e tija gjegjësisht ka qenë në gjendje të pa kontrolluar, gjykata në rastin konkret gjeti se janë të plotësua të gjitha kushtet nga nen.63 parag 1 nga LP PËR SHQIPTIM TË MASËS SË SIGURISË, SHËRIM TË OBLIGUAR PSIKIATRIK DHE RRUAJTJE NË IPSH SPITALI PSIKATRIK SHKUP, kundër të akuzuarit Z.T, nga e cila vijoi që gjykata vendosi si në thënien e aktvendimit.

Në pajtim me nen.100a nga LP nga i akuzuari merren një sëpatë me dorëz druri, kurse nga i dëmtuari S.T, merret një shufër alumini në dobi të R.M.

I dëmtuari S.T për kërkesë eventuale të dëshmshpërblimit kundër të akuzuarit drejtohet në kontest.

Shpenzimet e procedurës penale bien mbi mjetet buxhetore të gjykatës.

Kryetar i këshillit – gjykatës

.....

4.3.1 .1 Analizë e rastit të parë nga praktika gjyqësore

Në rastin konkret kemi të bëjmë me vepër penale Vrasje ku më datën 12.11.2017 rreth mesnate në shtëpi familjare të familjes T.....në të cilën kanë jetuar së bashku i akuzuari Z.T, i dëmtuari S.T. dhe nëna e tyre V.T në rr...., nr...në fsh. D.S në Sh i akuzuari në gjendje ku nuk ka mundur ta dij vlerën e veprës së tij dhe nuk ka mundur ti kontrollon veprimet e tia përshkak të sëmundjes së përhershme – shizofreni (DG SHIZOFRENIA – formë jo e diferencuar, gjatë kryerjes dhunë në familje është orvatur ta privon nga jeta të dëmtuarin vëllaun e tij S.T, në mënyrë që së pari i dëmtuari S.T në grindje familjare e ka sulmuar nënën e tyre V.T, grindja fizike ka vazhduar ndërmjet dy vllazërve me çka i dëmtuari S.T kundër të akuzuarit Z.T ka sjellur me shufër alumini kur i akuzuari Z.T i prirë me ide psikopatologjike në kuadër të sëmundjes së tij të përhershme shpirtërore e ka marrë sëpatën dhe me atë ka sjellur në drejtim të pjesës së parme të kokës së vëllaut të tij të cilit i ka shkaktuar lëndim të rëndë trupor me rezik konkret ndaj jetës të shprehur si gjendje e pavetëdishme kome, thyerje në ashtin ballor të kafkës, derdhje gjaku në regjinë e ballit endem truror difuziv të trurit.

Pra gjykata ka vlerësuar se në veprimet e lartëpërmendura i akuzuari Z.T ka kryer vepër penale vrasje nga neni 123 parag.2, p.2 nl, me nen.19 nl nen.12 parag.1 nga LP. Dhe sipas gjendjes faktike që gjykata vërtetoi nga provat e nxjerra verbale dhe materiale, nga të cilat u vërtetuan rrethanat relevante nën të cilat është kryer, koha, vendi, mënyra dhe duke patur parasysh rrethanata lehtësuese gjendjen e tij shëndetësore është i sëmurë me sëmundje të përhershme shpirtërore DG SHIZOFRENIA-formë jo e diferencuar F20.3. Sëmundja deri tani nuk është e trajtuar prandaj janë paraqitur më shumë funksione psikike dhe dëmtimi i rëndë i tij

fizik, i akuzuari është pa kontroll dhe ska vlersim të sëmundjes së tij dhe botës reale, në kohën e kryerjes së veprës nuk ka qenë në gjendje për të kuptuar domethënien e veprës së tij dhe ti kontrollon ndjenjat dhe veprimet e tij, ka qenë në gjendje të çregulluar dhe eksperti D-r GJ., psikijatër dhe eksperti gjyqësor, propozoi që të akuzuarit ti shqiptohet masa e sigurisë, shërim të obliguar psikiatrik dhe rruajtje në institucionin shëndetësor.

Gjykata në rastin konkret gjeti se janë të plotësua të gjitha kushtet nga nen. 63 paragrafi 1 nga Ligji për procedurë Penale SHQIPTIM TË MASËS SË SIGURISË, SHËRIM TË OBLIGUAR PSIKIATRIK DHE RRUAJTJE NË IPSH SPITALI PSIKATRIK SHKUP, kundër të akuzuarit Z.T.

4.3.2 Rasti i dytë - Aktgjykim mbi masën e siguruese shërim i obliguar psikiatrik në liri

NË EMËR TË QYTETARËVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

GJYKATA THEMELORE PENALE SHKUP si gjykatë themelore penale të shkallës së parë nëpërmjet gjykatës L.L, si gjykatë individuale, me procesmbajtës V V–nëpunës gjyqësor, duke vepruar në bazë të propozimit të precizuar të PTHP KO-2nr. nga data ... për shqiptim të masës së sigurisë –Shërim të obliguar psikiatrik në liri, kundrejt të akuzuarit T.P nga SH., për veprë penale –Vjedhje e rëndë nga neni 236 paragrafi 5 në paragraf 1 në LP, pas mbajtjes së seances kryesore publike dhe shqyrtim gojor me datën 20.06. 2019, në prani të Prokurorit publik nga PTHP ,S.D.S., i akuzuari T.P dhe mbrojtësi i tij i caktuar zyrtarisht –avokat I..I nga SH në pajtim me nenin 523 nga LPK solli dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

TË AKUZUARIT

T.P. me nr.amë, nga babai A, nëna J, i lindur me .. në Sh ku edhe jeton në rr.... me shkollim të mesëm, i pa punë, i pa martuar, maqedonas, shtetas i RMV.

Në pajtim me nenet 60,61,62 dhe 64 nga LP, gjykata i shqipton

MASË TË SIGURISË

SHËRIM TË OBLIGUAR PSIKIATRIK NË LIRI

PËRSHKAK SE

Me datën 01.06.2017 në kohë jo të verifikuar , nga automjeti i udhëtarëve ,model „Suzuki maruti 800, ngjyrë e gjelbërt me nr regjistrimi SK ... e parkuar në vendparsing të mbyllur përball QT „Beverli Hills ,, në rr, „Naroden Front,,Në pronësi e të dëmtuares TD. Në gjendje të çrregulluar me çka nuk ka mund ti kontrollojë veprimet e veta përshkak shizofrenisë paranoide –sëmundje e përhershme shpirtërore duke thyer pengesat dhe duke hyrë në hapsirat e mbyllura ka përvetësuar mjetet e huaja dhe atë një kasetofon modeli Perion në vlerë prej 1000 denarë dhe një autobateri 35 amper /h 12 v në vlerë prej 2450 denarë ,suma e përgjithshme 3.450,00 denarë me qëllim që jashtëligjshëm ti përvetëson , në mënyrë që pasi ka ardhur në vendin e theksuar , me mjet përkatës ka vepruar në derën e vozitesit të automjetit të cilën e ka hapur dhe nga mbrendia e automjetit e ka marr radiokasetofonin , pas së cilës e ka hapur derën e bagazhit prej ku e ka marr edhe autobaterinë dhe me këto mjete e ka lëshuar vendin e ngjarjes.

Me veprimet e lartcekura i akuzuari TP. Nga SH ka kryer vepër penale Vjedhje të rëndë nga nen 236 par .5 vv me par. 1 pika 1 nl me nen 12 par 1 nga LP.

Masa shërim të obliguar psihiatrik në liri të kryhet në QPSH Klinika Univerzitare për psihiatri SH.

Në pajtim me nen 64par 6 nga LP nëse i akuzunëstrohet shërimit në liri apo me vetiniciativ e i largohet shërimit gjykata masen e zëvendëson me masë të sigurisë –Shërim të obliguar psikiatrik dhe ruajtje në institucion shëndetësor.

Në pajtim me nen 102 dhe nen 105 nga LPP i akuzuar OBLIGOHEM të paguaj paushall gjyqësor në vlerë 2000 denarë, në xhirolllogari me nr.100000000063095, llogaria e shfrytëzuesit buxhetor, 2901000973, njësia 631, shfrytëzues 10, shifra e të hyrave 724132, programi 20 mënyra 2, pranues Gjykata themelore penale shkup, deponent BPM si dhe ti kompenzon shpenzimet e procedurës penale në vlerë të përgjithshme 11.500,00 denarë nga e cila vlera 8,000,00 denarë ,për ekspertizë dhe mendim nga nëntori i vitit 2018, përgaditur nga eksperti dr A M –psikiatër, vlera 1,500 denarë për prezencë të personit ekspert në seancën kryesore dhe vlera 2,000.00 denarë për përfaqësim të të akuzuarit nga mbrojtësi i tij, i caktuar në mënyrë ligjore –avokat I J. Nga Sh në seancën e mbajtur kryesore me datën 20. 06. 2019 në të njëjtën xhirolllogari 100000000063095 llogari pagese 84 gjykata SH **0852 (në vendet e shenuar me ***plotësohet numri i komunal ku jeton) shifra e të hyrave 724153 programi 00 pranues Gjykata themelore penale shkup, deponent BPM e gjitha në afat prej 15 ditëve –pas plotfuqishmerisë së vendimit, ndryshe pagesa kryhet me dhunë.

A r s y e t i m

PTHP deri në këtë gjykatë paraashtroi propozim KO.nr... nga data 24.04.2019 për shqiptim të masës për siguri – shërim i obliguar psikiatrik në liri, kundër të akuzuarit T.P nga sh, për vepër penale – vjedhje e rëndë nga nen. 236 parag.1 P. n.l me nen. 12 parag.1 nga LP.

Gjykata duke vepruar në bazë të propozimit të sjellur për shqiptim të masës siguri, me datën 20.06.2019 caktoi dhe mbajti seancë publike dhe gojore dhe shqyrtim gojor në prezencë të prokurorit publik nga PTHP S.B, i akuzuari T.P, mbrojtësi i tij i caktuar zyrtarisht, avokat I..J nga Sh dhe personi ekspert D-R A.M- psikijatër.

Në shqyrtimin kryesor, prokurori publik gjatë prezantimit të përmbajtjes së propozimit të sjellur për shqiptim të masës së sigurisë dhe precizoi në kualifikimin juridik të veprës penale me të cilën ngarkohet i akuzuari – vjedhje e rëndë nga nen.236 parag.5 n.l me parag.1 P1n.l me nen

12 parag.1 nga LP. Pas dëgjimit të të dëmtuarës T.D në fjalën përfundimtare, kreu precizim të dispozitivit të propozimit për shqiptim të masës së sigurisë – shërim të obliguar psikiatrik në liri në pjesën ku ka të bëjë me vlerën e mjeteve të marra, dhe theksoi se ngel në tërësi në propozimin e precizuar, për shak se nga dëshmitë e dhëna në seancën kryesore u vërtetua baza e akuzës së sjellur se i akuzuari ka kryer veprë penale vjedhje e rëndë nga nen.236 parag.5 n.l me parag.1 P1n.l me nen 12 parag.1 nga LP, kështu duke pasur parasysh dëshminë e ekspertit, gjykata propozoi që të akuzuarit ti shqipton masë sigurie shërim të obliguar psikiatrik në liri.

Mbrojtësi i të akuzuarit i caktuar zyrtarisht avokat I.J në fjalën përfundimtare theksoi se nga peridha kohore e kryerjes së veprës deri në momentin e mbajtjes së seancës kryesore, i akuzuari rregullisht pranon terapi gjegjësisht i përmbahet asaj që i është caktuar për llojin dhe karakterin e smundjes së tij dhe i njëjti ka përmirësim të gjendjes shëndetësore prandaj pajtohet me propozimin për shqiptim të masës së propozuar nga ana e prokurorit publik dhe personit ekspert.

I akuzuari T.P në fjalët përfundimtare theksoi se në tërësi e paranon fjalën përfundimtare të dhënë nga ana e mbrojtësit të tij.

Në seancën kryesore të mbajtur publike dhe gojore, gjykata në korniza të procedurës dëshmuese qaset në dhënien e dëshmive të propozuara dhe kështu kreu kqyrje në procesverbal për pranim të fletparaqitjes nga MPB- SPB, S.P- O.N qendër nr. 28.7.1.8-1892 nga data 01.06.2017, vërtetim nga mjetet e marrura nga MPB OID- M.D qendër dhe bit pazar nga data 01.06.2017, vërtetim nga mjetet e kthyer nga MPB-OID-MD qendër dhe bit Pazar nga data 01.06.2017 ekspertizë dhe mendim dhe D-R A.M, psikijatër nga nëtori i vitit 2018, fletlëshim nga IPSH,, Spitali Psikiatrik,, SH., historiat i sëmundjes nga IPSH,, Spitali Psikiatrik, dokumentacion mjeksor nga i akuzuari nga IPSH Spitali Psikiatrik dhe vërtetim me të dhënat me evidencë penalo-ndëshkimore për të akuzuarin T., të lëshuar nga njësitë për evidencë penalo-ndëshkimore në këtë gjyq, KP nga data 16.04.2019, nga e cila e ndëgjoi të dëmtuarën T.D dhe personin ekspert D-R A.M psikijatër, kështu duke vlerësuar në këto dëshmi secilën veç e veç dhe të gjitha së bashku në një tërësi dëshmuese por në bazë të bindjes së lirë gjyqësore vërtetoi gjendjen faktike me sa vijon.

I akuzuari T.P me gjenerale si në thënie të aktvendimit,

Me datën 01.06.2017 në kohë jo të verifikuar, nga automjeti i udhëtarëve, model „Suzuki maruti 800, ngjyrë e gjelbërt me nr regjistrimi SK ... e parkuar në vendparsing të mbyllur përball QT „Beverli Hills „, në rr, „Naroden Front,, në Sh pronesi e të dëmtuares TD. Në gjendje të çregulluar me çka nuk ka mund ti kontrollojë veprimet e veta përshkak shizofrenisë paranoide – sëmundje e përhershme shpirtërore duke thyer pengesat dhe duke hyrë në hapsirat e mbyllura ka përvetësuar mjete të huaja dhe atë një kasetofon modeli Perion në vlerë prej 1000 denarë dhe një autobateri 35 amper /h 12 v në vlerë prej 2450 denarë, suma e përgjithshme 3.450,00 denarë me qellim që jashtëligjshëm ti përvetëson, në mënyrë që pasi ka ardhur në vendin e theksuar, me mjet përkatës ka vepruar në derën e vozitesit të automjetit të cilën e ka hapur dhe nga mbrendia e automjetit e ka marr radiokasetofonin , pas së ciles e ka hapur derën e bagazhit prej ku e ka marr edhe autobaterinë dhe me këto mjete e ka lëshuar vendin e ngjarjes.

Gjendjen e këtillë faktike gjykata e vërtetoi nga dëshmitë e parashtruara në shqyrtimin kryesor me të cilën u vërtetuan rrethanat relevante në të cilën është kryer vepra, vendi, koha, mënyra, pasojat nga e njëjta, si dhe gjendja psikike me të cilën ka qenë i akuzuari gjatë kryerjes së veprës penale.

Gjegjësisht faktet kyqe në lidhje me kohën, vendin dhe mënyrën e kryerjes së Veprës gjykata i vërtetoi nga procesverbali e paranimi të paraqitjes në MPB SPB SP Qendër nr. 28.7.1.8-1892 nga data 01.06.2017 nga e cila shihet se me datën 1.06.2017 në rr. „ Narden Front,, më konkretisht në parkingun e mbyllur përballë QT Beverli Hills nga person i panjohur ka qenë kryer vjedhje e rëndë nga automjeti model Suzuki Maruti model 800 ngjyrë e gjelbërt nr. regj. SK...pronësi e të dëmtuarës T.D. Kryerësi i vjedhjes ka kryer në atë mënyrë pasi ka ardhur deri te automjeti dhe pasi është bindë se nuk do të vërehet nga askush me mjet përkatës e ka hapur derën e mbyllur të automjetit nga i njëjti i ka marrur një radio kasetofon i cili ka qenë i montuar në automjet pastaj e ka hapur haubën e automjetit dhe e ka marrë një autobateri dhe është nisur në drejtim të panjohur.

Në pajtim me procesverbalin e paraqitjes së pranuar është dëshmia e të dëmtuarës T.D dhënnun në shqyrtimin kryesor, nga i cili gjykata vërtetoi se në muajin qershor të vitit 2017 të dëmtuarës i është paraqitur inspektor nga SP Qendër dhe e ka ftuar të zbret në parkingun përballë QT Beverli Hills ku ka qenë e parkuar automjeti i saj Suzuki Maruti 800 ngjyrë e gjelbërt me nr. regj.SK...për shkak se nga automjeti kanë qenë të vjedhura autobateria dhe radio kasetofoni. Pastaj e dëmtuara së bashki me policët që krenin kqyrje kanë shkuar në SP Qendër ku ka kryer njohje të radio kasetofonit dhe autobaterisë së marrur, të njëjtat i janë kthyer për të cilën i janë shkruar vërtetim për mjetët e kthyer. Sqaroi se autobateria ka qenë me vlerë 2.450,00 denarë kurse radiokasetofoni i blerë në vitin 1996 ka qenë në vlerë prej 1.000,00 denarë. E dëmtuara nuk paralajmëroi kërkesë pronëso-ro-juridike dhe nuk u kyq në përndjekje penale kundët të akuzuarit.

Nga vërtetimi i mjeteve të marrura përkohësisht nga MPB SP Qendër dhe Bit Pazar, u vërtetua se nga i akuzuari janë marrë një autobateri dhe një autokasetofon.

Gjatë vërtetimit të gjendjes faktike Gjykata, sidomos i vlerësoi ekspertizën dhe mendimin e D-R A.M, psikiatër nga nëntori i vitit 2018, e përgaditur në bazë të dokumnetacionit gjyqësorë dhe mjeksor për të akuzuarin, fletëlëshim në emër T.P nga Spitali Psikiatrik si dhe kontrolli i kryer mjeksoro-psikiatrik ndaj të akuzuarit. Kjo gjendje e çregulluar psikiatrike e të akuzuarit daton që nga para 10 vitesh. Fillon në dekadën e katër të jetës manifestohet me sjellje joadekuate, lëvizje, ide palidhje.

Ditën kur i akuzuari e ka kryer veprën ka qenë i trajtuar në trajtim spitalor në spitalin psikiatrik. Prasnimi është kryer për shkak të sjelljeve të tij, biseda jo logjike dhe sjellje jo të mirë në mjedis. Gjatë kontrollit ka qenë konstatuar një pamje e çregulluar fizionomike, dobët i ushqyer, tensionim psikomotorik, disponim i dobët dhe impuls i ngritur i të biseduarit, mendime të çregulluara me ide të çmendura (paranoide) dhe interpretime iracionale. Nga kjo eksperti konstaton se gjatë kryerjes së veprës me të cilën ngarkohet, i akuzuari ka qenë në gjendje të vështirë psikike i udhëhequr me përjetime iracionale dhe të çmendura të cilin e ka sjellur në gjendje që mos të jet kritik për veprimet e veta. Nga kjo në aspekt juridik i akuzuari në kohën e kryerjes së veprës ka qenë i pavetëdishëm. Problemet me tretman mund të ndodhin nëse

ndërprehet terapia dhe për shkak se jeton i vetmuar i mungon ndihmesë familjare. Me qëllim që ti shmangen përkeqësimet e reja në gjendjen psiqike eksperti i propozon që të akuzuarit ti shqiptohet masa-shërim obligativ në liri. Në ekspertizë konstatohet se i akuzuari mund të merr pejsë në mënyrë aktive në procedurë dhe ta përcjellë rrjedhjen e saj.

Në shqyrtimin kryesor eksperti psikiatër ngeli në mendimin ekspert të përgaditur me shkrim duke e plotësuar se në momentin e kryerjes së veprës për të cilën ngarkohet i akuzuari ka qen në gjendje të rëndë psiqike, duke përjetuar një epizod të sëmundjes psiqike nga e cila vuan. Theksoi se fletëlëshimi është dëshmi se i akuzuari gjatë kryerjes së veprës penale – ndodhisë juridike ka pasur probleme serioze psiqike. Kjo gjendje e të akuzuarit është rezultat i sëmundjes së përhershme shpirtërore, gjegjësisht sëmundje psiqike kronike progrediente e quajtur shizofreni paranoide e karakterit të përhershëm dhe evolutiv. Bazuar në veprën që ka kryer eksperti propozoi që të akuzuarit ti shqiptohet masa e sigurisë – shërim i obliguar psikiatrik në liri e cila mund të ndikon pozitivisht mbi të akuzuarin dhe propozoi që masa të zhvillohet në SHPSH-KU për Psikiatri.

Gjykata e pranoi ekspertizën e elaboruar më lartë si dhe dëshminë e personit ekspert të dhënë në seancën kryesore ku i dha besim të plotë duke vlerësuar se janë objektive, të vërteta, precize, dhe të dhëna nga eksperti profesional. Gjatë gjendjes së këtillë faktike të vërtetuar gjykata gjeti se i akuzuari T.P në gjendje të çregulluar ka kryer vepër penale – vjedhje të rëndë nga nen. 236 parag. 5 nl parag.1 pika 1 nl me nen.12 parag.1 nga LP në kohë, vend dhe mënyrë detalisht të përshkruara në thënien e këtij aktgjykimi.

Gjatë përcaktimit të llojit të masës së sigurisë ndaj të akuzuarit si kryerës i papërgjegjshëm penal, duke e pas parasysh mendimin e ekspertit, gjykata të akuzuarin i shqiptoi masë të sigurisë – shërim obligativ në liri në pajtim me nen.64 parag.1 nga LP duke e llogaritur se për menjanimin e rizikut i akuzuari për shkak të gjendjes në të cilën gjendet mund të përsërit veprën penale dhe se është e mjaftueshme që të shërohet në liri. Gjykata zbatimin e masës së shqiptuar ia besoi SHPSH Klinika Univerzitare e Psikiatrisë dhe e përcaktoi se në rast që i akuzuari nuk i nënshtrohet shërimit në liri apo me vetë dëshirë e lëshon shërimin masën e

shqiptuar do ta zëvendëson me masë të sigurisë – shërim obligativ psikiatrik dhe ruajtje në institucionin shëndetësor.

Në pajtim me nen. 102 dhe nen.105 nga LPP gjykata e obligoi të akuzuarin që të paguajë në emër të paushalit gjyqësor vlerën 2.000,00 denarë si dhe ti konpenzon shpenzimet e procedurës penale në vlerë të përgjithshme 11.500,00 denarë nga kjo vlera 8.000,00 denarë për ekspertizë dhe mendim nga nëntori 2018, përgaditur nga eksperti D-r A.M psikiatër, vlera 1.500,00 denar për pjesëmarrje të ekspertit në senacën kryesore dhe vlera 2.000,00 denarë për përfaqësim të të akuzuarit nga ana e mbrojtësit të tij i emruar në mënyrë zyrtare - avokat I.J nga SH në senacën e mbajmtur kryesore të datës 20.06.2019 e gjithë kjo në afat prej 15 ditë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në frikë të kryerjes me dhunë.

GJYKATA THEMELORE PENALE SHKUP

XIX K.nr...../.. më datë

4.3.2 .1 Analiza e rastit të dytë nga praktika gjyqësore

Në rastin konkret kemi të bëjmë me vepër penale vjedhje të rënd më datën 01.06.2017 në kohë jo të verifikuar , nga automjeti i udhëtarëve ,model „Suzuki maruti 800, ngjyrë e gjelbërt me nr regjistrimi SK ... e parkuar në vendparsing të mbyllur përball QT „Beverli Hills ,, në rr „Naroden Front,,Në sh pronesi e të dëmtuares TD. Në gjendje të çrregulluar me çka nuk ka mund ti kontrollojë veprimet e veta për shkak shizofrenisë paranoide –sëmundje e përhershme shpirtërore duke thyer pengesat dhe duke hyrë në hapsirat e mbyllura ka përvetësuar mjete të huaja dhe atë një kasetofon modeli Perion në vlerë prej 1000 denarë dhe një autobateri 35 amper /h 12 v në vlerë prej 2450 denarë suma e përgjithshme 3.450,00 denarë me qëllim që jashtëligjshëm ti përvetëson , në mënyrë që pasi ka ardhur në vendin e theksuar , me mjet përkatës ka vepruar në derën e vozitësit të automjetit të cilën e ka hapur dhe nga mbrendia e

automjetit e ka marrë radiokasetofonin, pas së cilës e ka hapur derën e bagazhit prej ku e ka marr edhe autobaterinë dhe me këto mjete e ka lëshuar vendin e ngjarjes.

Pra gjykata ka vlerësuar se në veprimet e lartpërmendura i akuzuari M.P. nga SH., ka kryerë veprën penale –Vjedhje të rend Gjatë përcaktimit të llojit të masës së sigurisë ndaj të akuzuarit si kryerës i papërgjegjshëm penal, duke e pas parasysh mendimin e ekspertit, gjykata të akuzuarit i shqiptoi masë të sigurisë – shërim obligativ në liri në pajtim me nenin 64 parag.1 nga KP duke e llogaritur se për menjanimin e rezikut i akuzuari për shkak të gjendjes në të cilën gjendet mund të përsërit veprën penale dhe se është e mjaftueshme që të shërohet në liri. Gjkata zbatimin e masës së shqiptuar ia besoi SHPSH Klinika Univerzitare e Psikiatrisë dhe e përcaktoi se në rast që i akuzuari nuk i nënshtrohet shërimit në liri apo me vetë dëshirë e lëshon shërimin masën e shqiptuar do ta zëvendëson me masë të sigurisë – shërim obligativ psikiatrik dhe ruajtje në institucionin shëndetësor.

4.3.3 Rasti i tretë – Akgjykim mbi masën e sigurorese trajtim i detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve

NË EMËR TË QYTETARËVE TË REPUBLIKËS

SË MAQEDONISË SË VERIUT

GJYKATA THEMELORE PENALE SHKUP – si gjykatë e shkallës së parë, përmes gjykatësit L.Z si kryetar i këshillit dhe gjykatësit V.B dhe E.K si gjykatës porot, me procesverbalist M.B, duke vepruar sipas propozim akuzës së PTHP Shkup XXXI KO nr..... me dt....., kunder të akuzuarit K K nga Sh për vepër penale – Prodhim dhe dorëzim i pa autorizuar i barnave narkotike, substanca psikotrope.... neni 215. paragrafi 1 dhe neni 12 paragrafi 2 nga Kodi penal, pas mbajtjes së seancës kryesore, publike dhe verbale në prani të Prokurorit publik nga Prokuroria themelore Shkup N. G , të akuzuari K.K dhe J.B mbrojtësi i të akuzuarit V.D, avokat G.B nga Sh., avokat S nga

Sh., në bazë të nenit 380 paragrafi 2 dhe 381 të LPP (Gazeta zyrtare nr.150/2010), në dt.05.12.2019, e solli dhe publikisht e shpalli këtë

A K G J Y K I M

në bazë të pranimi të fajësisë

NDAJ TË AKUZUARIT

K.K me numër amë..... nga babai I., nëna B.... i lindur në P... por jeton në Sh. në rr..... nr....maqedonas, me arsim të lartë - Fakultet për..., i punësuar si.... në A SHA Sh., i martuar, baba i ..., pasuror, maqedonas, qytetar i RMV, i dënuar ,nuk procedohet për vëpër tjetër penale.

ËSHTË FAJTOR

PËR SHKAK SE:

I akuzuari më 06.05.2016 në SH Në një gjendje kur aftësia e tij për të kuptuar kuptimin e krimit dhe për të menaxhuar veprimet e tij u zvogëlua ndjeshëm për shkak të një çrregullimi mendor të shkaktuar nga përdorimi afatgjatë dhe i vazhdueshëm i drogave dhe substancave psikotrope që çuan në varësinë e tij mendore nga amfetamina dhe marihuana, ku ka përdorur marihuanën - një ilaç dehës i cili merrej i tharë në thërmija dhe copëza të vogla nga gjethet e bimës Kanabis, prej 1.75 gramësh të paketuara në tre pako polietileni, 7.80 gramë substancë psikotrope amfetaminë C stimulues të ilaçeve të paligjshme dhe psikotrope substanca - të paketuara në një

paketë polietileni, në një peshore me ngjyrë gri u zbuluan gjurmë të kokainës dhe kanabinoideve të gjetura dhe konfiskuara nga i dyshuari gjatë ekzaminimit të tij personal në

rr., si dhe 0.60 gramë material bimor i përbërë nga pjesët e sipërme të thara dhe pjesërisht të copëtuara-kanabis me origjinë nga bima e Kanabisit, të paketuara në një paketë polietileni dhe peshore të zezë dixhitale e cila përmbane gjurmë të kanabinoideve, u gjetën dhe u konfiskuan në shtëpinë e tij në rr nr....nga i dyshuari.

Me të cilat veprime i pandehuri K.K ka kryer vepër penale - Prodhimi dhe shpërndarja e paautorizuar e barnave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorë nga neni 215 pr. 1 dhe neni 12 pr.2 nga Kodi penal, në pajtim me nenin, si dhe nenet 3, 4, 7, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 39, 40, 41, 48, 48-a, 49 dhe 50 nga Kodi penal, njëkohësisht i shqipton mas alternative:

DËNIM ME KUSHT

Kështu, përcaktohet një dënim me burgim prej 2 - DY VITE, në të njëjtën kohë konstatohet se dënimi me burgim i caktuar në këtë mënyrë nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri Brenda 5 – VITEVE nuk do të kryej vepër të re, duke llogaritur nga dita e plotfuqishmëris së vendimit.

Në pajtim me nen. 65 paragrafi 1 nga Kodi penal, gjykata të akuzuarit i shqipton:

MASA E SIGURISË

TRAJTIMI I DETYRUESHËM I ALKOOLISTËVE DHE NARKOMANËVE NË LIRI

Nëse i pandehuri pa arsye nuk i nënshtrohet trajtimit në liri, gjykata do të revokojë dënimin me kusht dhe do të përcaktojë masa trajtim i detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve me forcë të kryhet në një institucion shëndetësor ose në një institucion tjetër të specializuar.

I akuzuari **OBLIGOHET** në përputhje me nenin 102 dhe nenin 105 të LPP, të kompenzoj shpenzimet e procedurës penale - shuma paushallë e gjykatës në vlerë prej 3,000.00 denarë në xhirollogari numër, llogari e përdoruesit të buxhetit, njësia ..., përdoruesi .., kodi i të ardhurave..., Programi .., Metoda 2, Përfituesi Gjykata themelore penale Shkup, depozituesi NBRMV , si dhe për të kompenzuar shpenzimet e procedurës penale në shumën totale prej 8,889,00 denarë, të cilat hynë në harxhimet për kostot për ekspertizën e përgatitur psikiatrike nga gushti 2019 për të akuzuarin nga eksperti S G - psikiatër, pas një kërkesë të bashkangjitur për pagesa e harxhimeve nga eksperti S G, në afat prej 15 ditësh pasi aktgjykimi të marrë formë të prerë, ndërsa nën frigën e përmbarimit të dhunëshëm.

Në bazë të nenit 215, paragrafi 7 i Kodit Penal, lëndët narkotike konfiskohen nga i pandehuri ilaçe: 1.75 gram marihuanë të paketuara në tre qese polietileni , 7.80 gramë substancë psikotrope stimulues i amfetaminës CNS e pakeluar në dy pako dhe 0.34 gram drogë narkotike kokainë e pakeluar në një paketë polietileni, një peshore me ngjyr gri me shenja të kokainës dhe kanabinoide dhe 0.60 gramë material bimor të thata dhe pjesët të copëtuara - që vijnë nga bima Kanabis, i pakeluar në një paketë polietileni dhe një peshore me ngjyrë të zezë të cilat vërrehen gjurmë të kanabinoideve, si lëndë të veprës penale.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Publike Sh. deri në këtë gjykatë paraashtrori propozim KO nr..... nga 26.09.2019, kundër të akuzuarit K K nga Sh. për krimin e prodhimit të paautorizuar dhe hedhjes në treg droga narkotike, substanca psikotrope dhe pararendës sipas nenit 215 paragrafi 1 më lart Neni 12 paragrafi 2 i Kodit Penal.

Duke vepruar në bazë të aktakuzës së ngritur, gjykata në 05.12.2019 caktoi dhe mbajti një seancë publike dhe gojore, në prani të Prokurori Publik në Prokurorinë Publike Sh. N. G, i pandehuri K.K. dhe këshilltari i tij B D- avokat nga S., të cilit pas fjalës hyrëse të Prokurorit publik i akuzuari në përputhje me nenin 381 paragrafi 1 i LPP-së, dha deklaratën e pranimi të fajit, me të cilin ai ishte kategorikisht dhe i vendosur dhe pranoi se ka kryer veprën penale një gjendje të

aftësisë së zvogëluar mendore, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitiv të aktgjykimi.

Pasi gjykata konstatoi se pranimi i fajit i të akuzuarit është dhënë vullnetarisht, dhe të njëjtën e japin pa ndikimin e askujt, gjithashtu është i vetdijshëm për pasojat juridike të pranimit të fajit, për pasojat për të kompensuar harxhimet e procedurës penale, dhe në kuptim të nenit 381 paragrafi 2 i LPP, duke marrë parasysh vetëm provat e nxjerrura që kanë të bëjnë me vendimin e sanksionit penal, duke lexuar dhe inspektuar: Konfirmimin KR - datë 22.11.2016 lëshuar nga Gjykata themelore Shkup 1. Shkup. - ... dhe ... në emër të të akuzuarit të paraqitur nga Prokuroria Publike Sh., të dhënat personale të përfshira në aktakuzë, të plotsuara nga vet i akuzuari të mbajtur në seancën kryesore.

Në fjalën e tij përfundimtare, përfaqësuesi i prokurorisë deklaroi:

Gjatë kësaj procedure penale duke pasur parasysh pranimin e të akuzuarit por edhe mjaftueshmërinë e provave materiale të paraqitura në vetë akuzën PTHP Sh. përtej çdo dyshimi të arsyeshëm të provuar se i akuzuari K K ka kryer veprën penale të Prodhimit të paautorizuar dhe vendosja në treg e ilaçeve narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorë nga neni 215 paragrafi 1 në lidhje me nenin 12 paragrafi 2 të KP. Domethënë, konstatimi im bazohet edhe në pranimin e fajit me vetëdije, liri dhe vullnetarë, nën ndikimin e askujt, i dhënë nga i akuzuari në seancën publike dhe gojore të mbajtur sotë, mirëpo ashtu siç citova, kjo nuk është një pranim i zbrazur sepse e njëjta gjë kur plotësohet me prova materiale, e qartë është situata faktike e ngjarjes. Prandaj propozimi i prokurorisë është që gjykata të sjell një dënim dhe të përcaktoj dhe masë shakllën e dënimit në bazë të ligjit. Kur përcaktohet lloji dhe caktuar matjen e dënimit, gjykata të ketë të gjitha lehtësimet dhe rrethanat rënduese nga neni 39 i Kodit Penal, dhe unë vetëm do t'i theksoj ato që janë më të rëndësishme. Rrethanë rënduese që qëndron në anën e të akuzuarit që mvarret nga sjellja e tij e mëparshme duke pasur parasysh se bëhet fjalë për përsëritës të veprës së njëjtë. Njësoj rrethana e tillë rënduese është shkallë mbrojtëse dhe duke rrezikuar të njëjtën gjë, shëndetin e njeriut. Rrethanat lehtësuese të cilat qëndrojnë për të pandehurin janë si më poshtë: Gjendja e tij mendore e cila është e zvogëluar deri në shkallë të përgjegjësisë, deklarimi i tij i fajit, dhe statusi i tij punonjës, njeri i familjes,

baba i një fëmije Gjykata në sjelljen e dënimit, t'i vlerësoj rrethanat e deklaruara, por edhe në mënyrë të plotë, të gjithë rrethanat tjera të kësaj ngjarjeje, në mënyrë që ajo të sjellë një dënim të drejtë e cila do të arrijë qëllimet e dënimit.

Avokati mbrojtës për të pandehurin V D - avokat nga S në fjalën përfundimtare tha:

Duke pasur parasysh pranimin e fajësisë nga i akuzuari , nuk do të komentojë mbi provat nga të cilat është vërtetuar gjendja faktike për këtë ngjarje kriminale, por vetëm do ti referohen matjes dhe llojit të sanksionit penal. Prokurori publik në Prokurorinë Publike Sh. në fjalët e tij përmbysëse ka përmendur rrethanat lehtësuese që janë në favor të akuzuarit, përveç rëndimit, kështu që Unë, si avokat, vetëm do të theksoj se ai është relativisht i ri një njeri i cili fatkeqësisht, për shkak të një loje fati në jetë ra në situata të jetë i varur nga narkotikët. Për shkak të varësisë, ai u vendos në një situatë të rënë në një çrregullim mendor si rezultat i përdorimit për një kohë të gjatë dhe të vazhdueshme të ilaçeve dhe substancave të ndryshme psikotrope dhe akoma mbanë në vete substanca të tilla për shkak të varësisë. Lusim gjykatën që këtij të riu t'i jep shans për të vazhduar trajtimin për të cilin ai e kuptoi se kishte nevojë, ai aplikoi në institucionet kompetente të cilët janë ekspertë të varësive të tilla që mund të ndihmojnë njerëzit të cilët e sollën vetën në një gjendje të tillë që të mund të shëroheshin. Trajtimi i tij shkon në një drejtim pozitiv, ai është i vetëdijshëm se duhet të bëjë të njëjtën gjë, në mënyrë që ai të mund të vazhdonte me një jetë normale, të risocializohet në mënyrë që ai të mund të kujdeset jo vetëm për veten, por edhe për familjen që ka formuar, përkatësisht është martuar në ndërkohë, dhe në atë martesë ai ka një fëmijë i cili është i mitur. Ai është i vetëdijshëm se për hir të ekzistencës dhe edukimit të mirë të fëmijës që ai krijoi në atë martesë duhet të shkojë një të ardhme më ndryshe, prandaj ai dëshiron të trajtohet në mënyrë vullnetare, ndërkohë është punësuar me një punë të përhershme, merr të ardhura konstante mujore nga e cila mbështetet familja e tij tre anëtarëshe. Për të gjitha këto arsye kërkojmë nga gjykata që të shqiptojë një sanksion më të butë përmes të cilit do të jetë arritjen e qëllimeve të dënimit. I pandehuri do ta kuptojë peshën e veprës, por në të njëjtën kohë ne kërkojmë që gjykata të kujdeset për të dhe për këtë arsye ai sanksion nuk duhet të çojë në përçarje të trajtimit nga i cili

mvaret ekzistenca e familjes. I akuzuari sot para gjykatës, dhe për hir të së vërtetës dhe gjatë e gjithë procedurave paraprake, dha përshtypjen dhe bindjen se është gati që në të ardhmen të mos kryej vepra të tilla, të shmanget nga veprat e tilla, me shpres se do të bëhet një qytetar shembullor i kësaj shoqërie dhe një anëtar shembullor i familjes së tij.

I akuzuari në fjalën e tij përfundimtare deklaroi: Unë e pranoj plotësisht fjalën e fundit të avokatit tim dhe unë vetëm do të shtoj se sinqerisht pendohem për veprën e kryer dhe betohem se asnjëher më nuk do e përsëris. Këtë herë jam shumë serioz si për veten time ashtu edhe për sjelljen time të mëparshme, por sidomos dhe kryesisht për shkak të fëmijës tim i cili ndërkohë ai lindi në martesë. Dhe pikërisht për atë fëmijë Unë ndiej shkallën më të lartë të përgjegjësisë për atë që kam bërë dhe e di që Unë jam duke u përballur me një dënim me burg efektiv, ju lutem, që si gjykatë të më jepni një shans të fundit për të përfunduar trajtimin që të mundem të jem një anëtar i dobishëm si i familjes ashtu edhe i shoqërisë dhe tu përgjigjem detyrave të një burri dhe më e rëndësishmja të jem në nivelin e një prindi i cili do të mund t'i tregojë fëmijës së tij se si nuk duhet vepruar në jetë vepra të tilla, duke u nisur nga shembulli im. Për shkak të të gjitha rrethanave lehtësuese që deklaroi avokati im, dhe madje përmendi Prokurorin publik, për shkak të situatës në të cilën isha në kohën kur kam kryer këtë vepër, ju lutem të dënohem më butë. Pajtohem që gjykata të urdhërojë trajtimin tim në liri, siç e përmenda, tashmë po trajtohem dhe unë jam nën mbikëqyrje të vazhdueshme mjekësore nga ekipi profesional në Qendra për ... në K. V.

Kur përcaktohet lloji dhe matet lartësia e sanksionin penal gjykata kishte në mendje të gjitha rrethanat e parashikuara në nenin 39 të Kodit Penal që kanë ndikim për individualizimin e dënimit.

Në atë kuptim, duke pasur parasysh dënimin e kërcënuar për veprën penale, dhe me një vlerësim të rrethanave që lidhen me të dhe me personin si autor i veprës, gjykata, i vlerësoi ato si rrethana rënduese sjelljen antisociale të të pandehurit të cilën ai e demonstroi duke e kryer veprën dhe rrethanat e tjera rënduese të parashikuara në nenin 39 paragrafi 2 i KP, mbi të gjitha, rreziku shoqëror i kryerjes së kësaj lloji vepre, i natyrës, karakteri të njëjtë, mënyra duke ndërmarrë veprime ai e dinte se ishin të paligjshme dhe të dënueshëm, rëndësia e veprës së

kryer, shkalla e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, shëndeti i njeriut si objekt kryesor i mbrojtjes së kësaj veprë penale nga varësia nga droga si një fenomen devijant që hyn si problem i rendësishëm në jetën moderne, pasojat e saja negative sidomos të të rinjtë, si dhe në përgjithësi efekti shkatërrues i varësisë së mundshme nga ilaçet dhe substancat tjera psikotrope, fakti që ai ka qenë i dënuar më parë për të njëjtën veprë, por i ndërlidhur me rrethanat personale të akuzuarit, si rrethana lehtësuese, dhe me moshën e tij, duke pasur parasysh se ai është një person relativisht i ri, i punësuar, i martuar, prind i një fëmije, nuk ka procedurë tjetër penale, qëndrimin i tij korret që u tregua në seancën kryesore dhe pranimi i fajit, plotësisht i pendur për atë që ka bërë, si dhe premtimi që në të ardhmen nuk do të përsëris një veprë të tillë.

Brenda rrethanave të tilla, gjykata e dënoi të akuzuarin me burgim në kohëzgjatja prej 2 - dy vjet, e shqiptuar në bazë të dispozitave të nenit 40 dhe 41 të Kodit Penal për zbutjen e dënimit të parashikuar për çështjen penale për të cilën gjykata vlerëson se ekziston bazë ligjore, gjithashtu përcaktoi se nëse në periudhën kohore që caktoi për 5 vite nuk kryej veprë penale të re duke marrë parasysh se në rastin aktual paralajmërimi me kërcënim me burgim me një periudhë më e gjatë është e përshtatshme për shkallën e kriminalitetit përgjegjësi të të akuzuarit për veprën penale dhe në përputhje me rrethanat e personalitetit të tij, i cili me të drejtë pret që qëllimet e dënimit me kusht sipas nenit 48 të KP dhe në përgjithësi, qëllimet e dënimit, në kuptim të nenit 32 të KP, i akuzuari në të ardhmen të mos kryejë një veprë të tillë ose vepra të tjera, dhe në të njëjtën kohë të shërbejë si shembull për të tjerët, dhe të përmbahen nga kryerja e krimeve. Për deri sa legjislacioni i maqedonis nuk parasheh nuk ka për qëllim hakmarrje ndaj kryerësit të veprës, por risocializimi i tij, veçanërisht për vepra të llojit të tillë, që në të ardhmen të mos shfaqen si kryerës të veprave të tilla, a shqiptimi i masës me burgim do të ishte efektive për kryerësit e veprave të tilla – varësi i till do të ishte kundër produktiv , sepse në kushtet e burgut me siguri do të prishej fillimi i procesit i shërimit nga varësia i drogave narkotike dhe substancave tjera psihotrope.

Duke pasur parasysh se veprën në fjalë i akuzuari e ka kryer në një gjendje të pa aftë për të kuptuar rëndësinë e veprës dhe për të menaxhuar veprimet e tij, për shkak të çrregullimeve mendore të shkaktuar si pasojë e përdorimit afatgjatë dhe të vazhdueshëm të përdorimit të

drogës dhe substancave psikotrope, dhe siç deklaroi ai vetë, pajtohet që gjykata të urdhërojë trajtimin e tij në liri, aq më tepër që i njëjti tashmë është duke u trajtuar dhe është nën mbikëqyrje të vazhdueshme dhe ekzaminimi mjekësor nga ekipi i ekspertëve në Qendrën për ... në KV, duke vlerësuar se ekziston rreziku për shkak të kësaj varësie i pandehuri të vazhdon të kryejë vepra penale, në fakt edhe dënimet e tija të mëparshme janë për veprat e tija të njehta, gjykata më të njëjtën kohë vendosi në perputhje me nenin 65 paragrafi 3 të KP të akuzuarit ti shqiptoi një masë sigurie - Trajtimi i detyrueshëm i alkoolistët dhe narkomanët, dhe nëse i akuzuari pa arsye nuk i nënshtrohet trajtimit në liri gjykata do të revokoj dënimin me kusht dhe do të përcaktojë masën e trajtimit të detyrueshëm të alkoolistëve dhe narkomanëve për t'u ekzekutuar me forcë në një ent shendetësor, nga i cili pritet që të arrij qëllimin e masave të sigurisë në kuptim të nenit 60 të KP, që të largohen rreziqet që ndikojn që kryerësi i veprës penale në të ardhmen të kryej vepra penale.

Në pajtim me nen. 102 dhe nen.105 nga LPP gjykata e obligoi të akuzuarin që të paguajë në emër të paushalit gjyqësor vlerën 3.000,00 denarë si dhe ti konpenzon shpenzimet e procedurës penale në vlerë të përgjithshme 8.889,00 denarë, për ekspertizë dhe mendim psikiatrik nga gushti 2019, përgaditur nga eksperti S.G psikiatër, me kërkesë të bashkangjitur për pagimin e shpenzimeve nga eksperti S G, e gjithë kjo në afat prej 15 ditë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në frikë të kryerjes me dhunë.

Në bazë të nenit 215, paragrafi 7 i Kodit Penal, gjykata vendosi që nga i akuzuari duhet sekuestroni drogën narkotike si më poshtë: 1.75 gram marihuanë të pakeluar në tre pako polietileni, 7.80 gramë substancë psikotrope amfetaminë Stimuluesi i SNQ i pakeluar në dy pako dhe 0.34 gram lëndë narkotike kokainë droge e pakeluar në një paketë polietileni, peshore me ngjyrë gri me gjurmë të kokainës dhe kanabinoideve dhe 0.60 gramë material bimor të përbërë nga gjethet që kanë origjinën nga bima e Kanabisit e pakeluar në një paketë polietileni dhe një peshore dixhitale me ngjyrë të zezë në të cilën ka gjurmë të kanabinoideve, dhe kjo llogaritet si objektë i veprës penale.

GJYKATA THEMELORE PENALE SHKUP

XIX K.nr...../.. më datë

4.3.3.1 Analizë e rastit të tretë nga praktika gjyqësore

Në rastin konkret kemi të bëjmë me vepër penale me të cilat veprime i pandehuri K.K ka kryer vepër penale - Prodhimi dhe shpërndarja e paautorizuar e barnave narkotike, substancave psikotrope dhe prekurosrë nga neni 215 pr. 1 dhe neni 12 pr.2 nga Kodi penal i akuzuari më 06.05.2016 në SH. Në një gjendje kur aftësia e tij për të kuptuar kuptimin e krimit dhe për të menaxhuar veprimet e tij u zvogëluar ndjeshëm për shkak të një çrregullimi mendor të shkaktuar nga përdorimi afatgjatë dhe i vazhdueshëm i drogave dhe substancave psikotrope që çuan në varësinë e tij mendore nga amfetamina dhe marihuana, ku ka përdorur marihuanën - një ilaç dehës i cili merrej i tharë në thërmija dhe copëza të vogla nga gjethet e bimës Kanabis, prej 1.75 gramësh të paketuara në tre pako polietileni, 7.80 gramë substancë psikotrope amfetaminë C stimulues të ilaçeve të paligjshme dhe psikotrope substanca - të paketuara në një paketë polietileni, në një peshore dixhitale me ngjyrë gri u zbuluan gjurmë të kokainës dhe kanabinoideve, të konfiskuara nga i dyshuari gjatë ekzaminimit të tij personal në rr., si dhe 0.60 gramë material bimor i përbërë nga pjesë të copëtuara-kanabis me origjinë nga bima e Kanabisit, të paketuara në një paketë polietileni dhe si dëshmi peshorja dixhitale me ngjyrë të zezë ku u gjenden gjurmë të kanabinoideve, u gjetën dhe u konfiskuan në shtëpinë e tij në rr nr....nga i dyshuari.

Brenda rrethanave të tilla, gjykata e dënoi të akuzuarin me burgim në kohëzgjatja prej 2 - dy vjet, e shqiptuar në bazë të dispozitave të nenit 40 dhe 41 të Kodit Penal për zbutjen e dënimit të parashikuar për çështjen penale për të cilën gjykata vlerëson se ekziston bazë ligjore, gjithashtu përcaktoi se nëse në periudhën kohore që caktoi për 5 vite nuk kryen vepër penale të re.

Pra gjykata ka vlerësuar se në veprimet e lartpërmendura i akuzuari e ka kryer në një gjendje të pa aftë për të kuptuar rëndësinë e veprës dhe për të menaxhuar veprimet e tij, për shkak të çrregullimeve mendore të shkaktuar si pasojë e përdorimit afatgjatë dhe të vazhdueshëm të përdorimit të drogës dhe substancave psikotrope, dhe siç deklaroi ai vetë, pajtohet që gjykata të urdhërojë trajtimin e tij në liri, aq më tepër që i njëjti tashmë është duke u trajtuar dhe është nën mbikëqyrje të vazhdueshme dhe ekzaminimi mjekësor nga ekipi i

ekspertëve në Qendrën për ... në KV, duke vlerësuar se ekziston rreziku për shkak të kësaj varësie i pandehuri të vazhdon të kryejë vepra penale, në fakt edhe dënimet e tija të mëparshme janë për veprat e tija të njejta, gjykata më të njejtën kohë vendosi në perputhje me nenin 65 paragrafi 3 të KP të akuzuarit ti shqiptoi një masë sigurie - Trajtimi i detyrueshëm i alkoolistët dhe narkomanët, dhe nëse i akuzuari pa arsye nuk i nënshtrohet trajtimit në liri gjykata do të revokoj dënimin me kusht dhe do të përcaktojë masën e trajtimit të detyrueshëm të alkoolistëve dhe narkomanëve për t'u ekzekutuar me forcë në një ent shendetësor, nga i cili pritet që të arrij qëllimin e masave të sigurisë në kuptim të nenit 60 të KP, që të largohen rreziqet që ndikojn që kryerësi i veprës penale në të ardhmen të kryej vepra penale.

4.3.4 Rasti i katërt – tretmani farmakologjik për abuzuesit seksual të fëmijëve nën moshën 14 vjeçare

NË EMËR TË QYTETARËVE TË REPUBLIKËS

SË MAQEDONISË SË VERIUT

GYKATA THEMELORE PENALE SHKUP, si gjykate themrllore penale e shkallës së parë, nëpërmjet gjykatëses B.K, si kryetare e këshillit, gjykatesja A. R si anëtare e këshillit dhe gjykatësit porot M.S., E. I dhe M. M., procesverbalist G. M., punëtor gjyqësor, duke vepruar sipas propozim akuzës të PTHP S.KO 1 nr..... prej 22.11.2017, kundër të akuzuarit B.M prej S. për vepër penale – Abuzim seksual ndaj femijës i cili nuk ka të mbushur 14 vjet, sipas nenit 188 paragrafi 1 nga KP, pas mbajtjes së seancës kryesore, publike dhe verbale, në prani të Prokurorit Publik nga PTHP S. Z. P., i akuzuari B.M i sjellur nga IDP Burgu „S“ - Sh., mbrojtësi i të akuzuarit i caktuar sipas detyrës zyrtare, I. J., avokat nga S dhe i autorizuari i fëmijës të dëmtuar, i caktuar sipas detyrës zyrtare Z. T., avokat nga S., sipas nenit 381 nga Ligji për procedur penale (Gazeta zyrtare e RM nr.150/10) , me date 26.01.2018,, e solli dhe publikisht shpalli

A K T G J Y K I M

NË BAZË TË PRANIMIT TË FAJËSISË

I akuzuari B.M me NP nga babai N. , nena S., i lindur më dt..... , në P., me vendbanim në bazë të dokumentit personal në rr.“. „ nr... f...., me vendbanim në S.P., në vendin e quajtur K.-S, me arsim të mesëm, i papunë, i martuar në Gjermani, tani i ndarë, baba i një femije të mitur, pa pasuri, shtetas i RM – së, i dënuar, ndaj tij nuk procedohet për vepër tjetër penale.

Ë S H T Ë F A J T O R

PËR SHKAK SE:

Me datë 27.07.2017, rreth orës 14.00 në fshatin S...., pa numër, në vendin e quajtur K...., i akuzuari B.M i cili jeton në të njëjtin oborr me familjen e fëmijës të dëmtuar E.K, ka kryer abuzim seksual ndaj fëmijës i cili nuk ka të mbushur 14 vjet – femiu i demtuar E.K., e lindur në vitin, në atë mënyrë që pasi që ka vërejtur që fëmijet kanë qenë duke lozur në oborr, ndër të tjerët edhe femiu i dëmtuar E.K., i akuzuari i ka thënë të dëmtuares E., të mbush një shishe me ujë nga hidrofori i cili gjindej në oborr, pas së cilës e demtuara ka shkuar në shtëpinë e të akuzuarit, i akuzuari duke e shfrytëzuar rastin dhe kushtet e mundësuar, në kohën kur në shtëpinë e tij nuk ka qenë askush, e ka zhveshur të dëmtuaren E., dhe pastaj është zhveshur edhe vetë ai, pastaj me dorën e djathtë të lyer me vaj e ka lyer të dëmtuaren në vendin e organit gjenital femëror – vaginën, dhe pastaj me organin gjenital të tijën është fërkuar në vaginën e të dëmtuares, pa ejakuluar, dhe pastaj e ka leshuar të dëmtuarën E., të shkojë.

Me veprimet e lartpermendura i akuzuari B.M, ka kryer vepër penale – Abuzim seksual ndaj fëmijës i cili nuk ka mbushur ende 14 vjet, sipas nenit 188 paragrafi 1 nga KP, dhe në pajtim me nenin e cituar dhe nenet 3, 4, 7, 29, 30, 31, 32, 33, 35, 39, 40, dhe 41 nga KP, dhe nenet 102, 105, dhe 114 nga LPP, gjykata të akuzuarin e

D Ë N O N

ME DËNIM ME BURGIM PREJ 8 – VITEVE

Sipas nenit 47 nga KP, në dënimin me burgim ndaj të akuzuarit, I llogaritet edhe koha të cilën e ka kaluar në paraburgim prej datës 29.07.2017, me Vendim të gjykatësit në procedurën paraprake para kësaj gjykate P. nr. , me datë 30.07.2017, e vërtetuar me Vendimin e këshillit penal të kësaj gjykate KS të dt.04.08.2017, e vazhduar me Vendimin e këshillit penal të kësaj gjykate KS....të datës 25.08.2017, dhe KS.... të datës 26.09.2017, Vendimin e Gjykatës së Apelit Shkup KSZH..... të datës 25.10.2017, vendimet e Keshillit penal të kësaj gjykate KSP..... të datës 23.11.2017, KSP nr..... të datës 20.12.2017, dhe KSP nr.... të datës 22.01.2018 dhe me vendimin P nr..... të datës 26.01.2018, masa e paraburgimit është vazhduar deri në ditën e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, P nr... të datës 26.01.2018, përkatesisht deri në fillimin e mbajtjes së dënimit me burgim, por më së shumti derisa të kaloj koha e paraparë për mbajtjen e dënimit me burgim.

Ne pajtim me nenin.102 dhe nenin.105 të LPP, I akuzuari OBLIGOHET të paguaj në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 3.000,00 denarëve në gjirollogari në nr.....,, krejt në afat prej 15 ditësh pasi aktgjykimi të marrë formë të prerë, ndërsa ndër frigën e përmbarimin të dhunshëm.

Në pajtim me nenin.114 t LPP, gjykata të autorizuarit ligjor të dëmtuarit të mitur E.K., nënës së tij Z.Q, për kërkesën e parashtruar pasuroro juridike udhëzohet që ta realizoj në kontest.

A r s y e t i m

PTHP SH., deri te kjo gjykatë ka paraqitur aktakuzë A.p nr.... me datë 22.11.2017, me propozim për vazhdimin e masës së paraburgimit, kundër të akuzuarit B.M., nga S., për veprën penale – Abuzim seksual ndaj fëmijës i cili ende nuk ka mbushur 14 vjet të nenit 188 paragrafi 1 te KP.

Gjykata, duke proceduar në bazë të propozim akuzës me datën 26.01.2018, mbajti shqyrtim kryesor, publik dhe verbal, në prani të PP të PTHP SH. Z.P, të akuzuarit B.M., i sjellur nga KPU SH., mbrojtësi i të akuzuarit i caktuar sipas detyrës zyrtare avokat I.J., dhe i autorizuari i fëmijës së dëmtuar i caktuar sipas detyrës zyrtare avokat Z.T., në fjalët hyrëse të palëve dhe paraqitjen e propozim akuzës nga ana e PP, i akuzuari ka dhënë deklaratë për pranimin e fajësisë për veprën për të cilën është i akuzuar, i cili ka thënë së ndjehet fajtor. I akuzuari ka sqaruar se është e vërtetë se e demtuara E. e ka dërguar për ujë, dhe kur është kthyer, me duart e tij paraprakisht të lyera me vaj, i cili ka qenë duke gatuar, dhe ia ka zhveshur veshjet e brendshme – bregët, me duart e tij e ka prekur në vaginë, dhe pasi që e ka bërë këtë menjëher është larguar sepse ju kanë ërresuar sytë, është penduar për atë që ka bërë dhe ndjeu keqardhje, dhe më pas vajza është larguar i akuzuari deklaroi se më mirë të isha vrasës sesa të bëja këtë vepër, gjithashtu deklaroi se është penduar për veprën e kryer dhe ka premtuar se asnjëherë nuk do ta përsërit të njejtën vepër.

Pasi që gjykata në pajtim me nenin 381 paragrafi 2 të KP, ka vërtetuar së pranimi i fajit të akuzuarit është dhënë vullnetarisht dhe se i njejtë është i vetëdijshëm për pasojat juridike të pranimi të fajësisë, dhe të pasojave lidhur me shpenzimet e procedurës penale, duke marrë parasysh deklaratën e të akuzuarit, në pajtim me nenin 381 paragrafi 3 të LPP, i ka marrë parasysh vetëm provat e nxjerrura që kanë të bëjnë me vendimin e sanksionit penal, me leximin dhe shiqimin e në vërtetimin e evidencës penale P nr.....të datës 30.07.2017 të gjykatës themelore penale Shkup, në emër të të akuzuarit.

Autorizuesi i aktakuzës në fjalën përfundimtare, theksoi se duke e marrë parasysh pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, i propozoi gjykatës që ti marrë parasysh të gjitha rrethanat e rënda dhe të lehta, në pajtim me nenin 39 nga KP, dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim adekuat, me të cilën do të arrihet qëllimi i denimit, dhe mbi të gjitha të marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, e shiquar në aspektin e mënyres së kryerjes të veprës penale, faktin që me të dëmtuarin janë kushëri të largët, dhe që jetojnë në të njejtin oborr, faktin që më parë i akuzuari e ka sulmuar edhe motrën e të dëmtuares, përkatësisht e ka kafshuar, rethana se më parë ka qenë i gjykuar, në korelacion me atë se është i moshës 25

vjecare, i ndarë, baba i një fëmijë të mitur, të cilat rethana duhet të mirren parasysh si rethana lehtësuese.

Autorizuesi i fëmijës së dëmtuar, i caktuar sipas detyrës zyrtare , avokat Z. T., në fjalën përfundimtare theksoi se i bashkangjitet procedurës penale dhe e përkrah plotësisht fjalën përfundimtare të PTH dhe kërkoi prej gjyqit ti caktohet dënim adekuat, ndërsa për dëmshperblimin ti udhëzoj në kontest civil. Kërkoi ti kompenzohen harxhimet e procedurës penale sipas AT.

Mbrojtësi i të akuzuarit, i caktuar sipas detyrës zyrtare, avokat I. J në fjalën përfundimtare theksoi se, duke marë parasysh që i akuzuari e ka pranuar fajin, do të deklarohet vetëm reth rethanave të cilat ndikojnë në peshën dhe në nivelin e dënimit penal.

Perkatësisht, autorizuesi theksoi se edhe pse është autorizues i të akuzuarit i caktuar me detyrë zyrtare nënt herë e ka vizituar të akuzuarin në IDP Burgu S., në repartin e paraburgimit dhe në bisedë me të njejtin mezi ka arritur të afrohet deri te i akuzuari që ai ti tregon se pendohet për veprën e bërë në gjendje të pavetëdijshme, a të cilën e ka pranuar edhe në seancën kryesore, i njejtë ka deklaruar para mbrojtësit se nuk ka qenë në vetidije se çfarë ka bërë, dhe kur është vetëdijësuar për gabimin e vet për të cilën edhe pendohet, menjëher është larguar nga fëmiu i dëmtuar. Këtë e potencon nga arsyeja se sipas të thënëvë të të akuzuarit, i njëjti është rritur pa nënë, së bashku me babain e tij jetim, vëllaun dhe gjyshin, që don të thotë së në sjelljen e tij, e cila është e pavetëdijshme dhe pa menudar, kanë ndikuar edhe familja dhe rethi ku ka jetuar. Megjithatë pendimi i tij i singert dhe premtimi se në ardhmëri nuk do ta përsëris të njejtën vepër, i jep të drejtë që të kërkoj prej gjyqit të akuzuarit ti shqiptohet dënim me i lehtë me anë të së cilës do të arrihen qëllimet e dënimit në plan specijal dhe gjeneral, dhe gjithashtu do të arrihet edhe individualizimi i të akuzuarit që mund ti ndihmoj në sjelljen e mëtutjeshme në jetën e tij. Kërkoi ti kompenzohen harxhimet e procedurës penale sipas AT.

I akuzuari B.M., në fjalën përfundimtare theksoi se plotësisht i bashkangjitet fjalimit të mbrojtësit të tij, duke sqaruar se me të vërtetë pendohet për kryerjen e veprës penale, se ndjen keqardhje për veprën që ka kryer, dhe premtoi se asnjëherë nuk do të përsëris veprimet e njëjta, se është i vetëdijshëm për gabimin dhe kërkoi nga gjyqi të dënohet më lehtë.

Gjykata gjatë caktimit të llojit dhe matjen e lartesisë së sanksionit penal, i kishte parasysh të gjitha rethanat sipas nenit 39 nga KP, dhe si rethana rënduese ka konsideruar, shpeshmerinë e kryerjes së veprave të tilla, dhe faktin se i akuzuari edhe më herët ka kryer vepra të tjera penale, ndërsa si rethana lehtësuese gjykata ka marrë parasysh pranimin e fajit nga ana e të akuzuarit, e cila ndikoi në kryerjen efikase të procedurës penale, sjellja korrekte e të akuzuarit gjatë procedurës penale, keqardhja dhe pendimi për kryerjen e veprës penale, ka marrë parasysh faktin se i akuzuari është i ri, rethana se nuk ka procedurë për veprë tjetër penale, dhe se bëhet fjalë për kryerës me arsim të kryer, i cili nuk është i punësuar, baba i një femiu të mitur. Duke i vlerësuar të gjitha këto rethana, a sipas nenit 40 dhe 41 nga KP, gjyqi e dënoi me burgim me 8- tetë vjet, e kishte parasysh se edhe me këtë dënim të shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 32 nga KP, si në aspekt të prevencionit specijal që në të ardhmen të mos kryej veprë të njejt penale apo vepra të tjera penale, dhe riedukimin e tij, gjithashtu edhe në aspekt të prevencionit gjeneral , të ndikoj ndaj të tjerëve që mos të paraqiten si kryerës të veprave penale.

Në pajtim me nenin 47 të KP, gjykata vendosi në shqiptimin e dënimit me burg të akuzuarit të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim, duke filluar nga data 29.07.2017, e caktuar me vendim të gjykatës tëpara kësaj gjykate KPP....., nga 30.07.2017, i vërtetuar me vendim të Këshillit penal të kësaj gjykate KS..... , nga 04.08.2017, i vazhduar me vendim të Këshillit penal të kësaj gjykate, KS....., nga 25.08.2017, edhe KS....., nga 26.09.2017, Vendim nga Gjykata e Apelit Shkup, KSZH....., nga 25.10.2017, vendim i Këshillit penal të kësaj gjykate, KSP....., nga 23.11.2017, KSP....., nga 20.12.2017, dhe KSP....., nga 22.01.2018, dhe me vendim K....., nga 26.01.2018, masa e paraburgimit është vazhduar deri në ditën e plotfuqishmërisë të aktgjykimit, përkatësisht deri në fillimin e mbajtjes të sanksionit me burgim, por jo me gjatë se skadimi i afatit të mbajtjes së sanksionit penal.

Në pajtim me nenin 102 nga KPP, gjykata e obligoi të akuzuarin ta paguaj paushallin gjyqësor prej 3.000,00 denar, si dhe të kompenzoj harxhimet e procedurës penale gjithësej shumë prej 19.080,00 denar, prej të cilave shumë prej 7.778,00 denar harxhime për ekspertizën mjeksore psihijatrike nga dr. A.M., shumë prej 6.000,00 denar për mbrojtësin e caktuar me

detyrë zyrtare, I J., avokat nga S., për përfaqsimin e të akuzuarit.....dhe në seancen kryesore, shumë prej 3.000,00 denar për të autorizuarin e të dëmtuarës i caktuar më detyrë zyrtare, Z.T, avokat nga S., për përfaqsimin e të miturës në seancën kryesore, si dhe shumë prej 2.240,00 denar, a të cilat janë për transportin e të akuzuarit nga IDP Burgu S.,, në afat prej 15 ditësh pasi aktgjykimi ka marrë formën e prerë, ndërsa nën kanosjen e ekzekutimit të detyrueshëm.

Ne pajtim me nenin 114 nga KPP, gjykata përfaqsesin ligjor të të miturës së dëmtuar E.K., nënës e saj Z.K., për dëmshpërblimin e udhëzoi në contest.

GJYKATA THEMELORE PENALE SHKUP

XIX K.nr...../.. më datë

Procesmbajtësi

Gjykatës

4.3.4.1 Analizë e rastit të tretë nga praktika gjyqësore

Në rastin konkret kemi të bëjmë me vepër penale – Abuzim seksual ndaj fëmijës i cili nuk ka mbushur ende 14 vjet, sipas nenit 188 paragrafi 1 nga KP, më datë 27.07.2017, rreth orës 14.00 në fshatin S..., pa numër, në vendin e quajtur K...,i akuzuari B.M i cili jeton në të njëjtin oborr me familjen e fëmijës të dëmtuar E.K, ka kryer abuzim seksual ndaj fëmijes i cili nuk ka të mbushur 14 vjet – femiu i dëmtuar E.K., e lindur në vitin, në atë mënyrë që pasi që ka vërejtur që fëmijët kanë qenë duke lozur në oborr, ndër të tjerët edhe femiu i dëmtuar E.K., i akuzuari i ka thënë të dëmtuares E., të mbush një shishe me ujë nga hidrofori i cili gjindej në oborr, pas së cilës e dëmtuara ka shkuar në shtëpinë e të akuzuarit, i akuzuari duke e shfrytëzuar rastin dhe kushtet e mundësuar, në kohën kur në shtëpinë e tij nuk ka qenë askush, e ka

zhveshur të dëmtuaren E., dhe pastaj është zhveshur edhe vetë ai, pastaj me dorën e djathtë të lyer me vaj e ka lyer të dëmtuaren në vendin e organit gjenital femëror – vaginën, dhe pastaj me organin gjenital të tijën është fërkuar në vaginën e të dëmtuares, pa ejakuluar, dhe pastaj e ka lëshuar të dëmtuarën E., të shkojë.

Pra, gjykata gjatë caktimit të llojit dhe matjen e lartesisë së sanksionit penal, i kishte parasysh të gjitha rethanat sipas nenit 39 nga KP, dhe si rethana rënduese ka konsideruar, shpeshmërinë e kryerjes së veprave të tilla, dhe faktin se i aukuzuari edhe më herët ka kryer vepra të tjera penale, ndërsa si rethana lehtësuese gjykata ka marrë parasysh pranimin e fajit nga ana e të akuzuarit, e cila ndikoi në kryerjen efikase të procedurës penale, sjellja korrekte e të akuzuarit gjatë procedurës penale, keqardhja dhe pendimi për kryerjen e veprës penale, ka marrë parasysh faktin se i akuzuari është i ri, rethana se nuk ka procedur për vepër tjetër penale, dhe se bëhet fjalë për kryerës me arsim të kryer, i cili nuk është i punësuar, baba i një femiu të mitur. Duke i vlersuar të gjitha këto rethana, a sipas nenit 40 dhe 41 nga KP, gjyqi e denoi me burgim me 8- tetë vjet, e kishte parasysh se edhe me këtë dënim të shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 32 nga KP, si në aspekt të prevencionit specijal që në të ardhmen të mos kryej vepër të njejt penale apo vepra të tjera penale, dhe riedukimin e tij, gjithashtu edhe në aspekt të prevencionit gjeneral, të ndikoj ndaj të tjerëve që mos të paraqiten si kryerës të veprave penale.

Mirëpo, sa i përket zbatimit të masës së sigurisë, tretman mjekësor-farmakologjik, shohim se edhe pse janë plotësuar kushtet e parapara në Kodin penal për shqiptimin e masës së sigurisë – Tretman mjekësor farmakologjik, pra është vëretuar se është kryer vepra penale nga neni 188 – Abuzim seksual i fëmijës nën moshën 14 vjeçare – Gjukata nuk i ka propozuar kryerësit që ti nënshtrohet tretmanit dhe me këtë ti përgjysmohet dënimi. Kurse në rastet e recidivizmit kjo masë do të duhet të shqiptohet automatikisht, pa vullnetin e kryerësit. Pra, kjo masë edhe pse është në legjislacion, nuk gjen zbatim në praktikën e gjykatave të RMV-së përfshirë Gjykatën themelore Penale Shkup.

PËRFUNDIMI

Kjo temë për të cilën vendosa të shkruaj e cila do më jep dhe titullim magjistër andaj me shumë dashuri dhe përkushtim vendosa të bëj hulumtimin tim në këtë drejtim. Fakti i cili jetojmë në kohë ku bota në shumë drejtime ka ecur përpara ku në disa aspekte kemi shumë dobi ndërsa në disa jo si p.sh çdo ditë e më shumë hasim në informacione të ndryshme mbi numrin e rritjes së sëmundjeve mendore si (shizofrenia, depresioni etj) dhe hasim në një numër të madhë të personave konsumues të alkoolit dhe drogave të ndryshme të cilat tek shumë kryerës të veprave penale janë dhe shkas për kryerjen e veprës. Prandaj, pikërisht për këtë arsye studimi im u prëqëndrua te Masat e sigurisë në Gjykatën themelore penale Shkup, ku më konkretisht flitet mbi:

- Mjekimi i detyrueshëm psikiatrik në institucion shëndetësor;
- Mjekimi i detyrueshëm psikiatrik në liri;
- Mjekimi i detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve;
- Mjekimi medicinalo-farmakologjik

Kriminaliteti i personave me përgjegjësi esenciale të zvogluar, paraqet një sfidë të madhe për shoqërinë, kur është në pyetje parandalimi dhe luftimi i kësaj dukurie. Ndaj kryerësve të veprave penale të personave me çrregullime mendore, gjegjësisht kryerësve të papërgjegjshëm, organet gjyqësore dhe organet tjera shtetërore, në vazhdimësi marrin masat e duhura për parandalimin dhe luftimin e tij. Andaj, duke u nisur nga ajo se Legjislacioni penal vihet në mbrojtje të të gjitha interesave të shoqëris parashikohen vepra penale dhe sanksione penale.

Masat e sigurisë janë sanksione specialo-preventive të cilat i shqipton gjykata në procedurën e përcaktuar me ligj ndaj kryerësit të veprës penale, mbrojtjes së shoqërisë dhe individit nga kriminalitetit.

Gjithashtu në këtë studim jemi fokusur në atë se si i parasheh Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut – Masat siguruese dhe nga ajo që kemi kuptuar shohim se Kodi Penal parasheh dy regjime ligjore të zbatimit të këtyre sanksioneve: kur të njëjtat u shqiptohen autorëve të përgjegjshëm dhe kur u shqiptohet personave me përgjegjësi esenciale të zvogëluar, alkoolistëve dhe narkomanëve.

Duke u bazuar në neni 60 të Kodit Penal shohim se qëllimi i masave të sigurisë është që të menjaherë gjendet apo kushtet që mund të ndikojnë që kryerësi në të ardhmen të kryej vepra penale andaj si karakteristika themelore të masave të sigurisë llogariten:

- me anë të masave siguruese shoqëria mbrohet nga kriminaliteti mbrohen vlerat më të rëndësishme të individit dhe të bashkësisë shoqërore;
- masat e sigurisë mund të shqiptohen vetëm kryesve të veprave penale;
- ndaj kryesve të veprave penale mund të shqiptohet vetëm ato masa të sigurisë të cilat janë paraparë me ligj
- masat e sigurisë mund të shqiptojë vetëm gjykata në bazë të procedurës së përcaktuar me ligj;
- me anë të masave siguruese, kryesve të veprave penale u mundësohet largimi i situatave që mund të ndikojnë që kryerësi në të ardhmen të kryej vepra penale.

Duke shikuar praktikën gjyqësore dhe zbatimin e ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale vërejmë se gjykata shqipton masën e sigurisë mjekim i detyrueshëm psikiatrikë në institucione shëndetësore, mjekim i detyrueshëm psikiatrik në liri, mjekim i detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve, ku në vendin tonë kemi tre nga vendet ku kryerësi i veprës penale mund ta mbajë ekzekutimin e kësaj mase të cilën e shqipton gjykata kompetente:

- Në spitalin psikiatrik – „Shkup” – Shkup dërgohen personat e dënuar nga zona e Gjykatave themelore: Veles, Gostivar, Dibër, Kërçov, Kratov, Kriva Palanka, Kumanov, Shkup dhe Tetovë;
- Në spitalin psikiatrik – Demir Hisar dërgohen personat e dënuar nga zona e Gjykatave themelore: Manastir, Krushevo, Ohër, Prilep, Prespë dhe Strugë;

- Në spitalin psikiatrik – Negorci dërgohen personat e dënuar nga zona e gjykatave themelore: Berov, Vinic, Gjevgjeli, Delçev, Kavadarci, Koçani, Negotin, Radovich, Strumicë dhe Shtip.

Mirëpo shqetësuese është fakti se procedura mbi ekzekutimin e masës së sigurisë trajtim medicinalo –farmakologjikë në legjislacionin tonë është e rregulluar me Ligjin mbi ekzekutimin e sanksioneve penale në Republikën e Maqedonisë së Veriut i cili pëson ndryshimi në vitin 2014 paraprkisht nga Kodi Penal dhe inkorporimit të masës së re të sigurisë “Mjekim medicinalo-farmakologjik” gjegjësisht - sulm seksual ndaj fëmijës që nuk i ka mbushur 14 vjet, ku edhe sot pas shtatë viteve ende nuk hasim në shqiptimin e kësaj mase në praktikën gjyqësore në Gjykatën themelore penale Shkup.

Edhe pse kjo masë është e rregulluar sipas Kodit Penal dhe Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale dhe legjislacioni ynë parasheh trajtimin në mënyrë vullnetare bazuar në disa mendime shkencore mendohet se kjo mënyrë e trajtimit është më adekuate.

Megjithatë të dhënat që siguroam nga Gjykata themelore penale Shkup mbi masat e sigurisë mjekimi detyrueshëm psikiatrik në institucion shëndetësor, mjekim i detyrueshëm psikiatrik në liri dhe mjekim i detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve është mjaftë simbolikë ku gjatë periudhës kohore për pesë vitet nga 2015 deri më 2020 gjithësej numër të përgjithëshëm të masave të siguris kemi 181. Këto masa llogariten si mjaftë të rëndësishme në luftimin e kriminalitetit të përditshëm andaj me shpresë që ky numër në të ardhmen të zvogëlohet.

Bibliografia

Kodet, Ligje dhe konventa ndërkombëtare:

- Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, Afrim osmani, Shkup 2017
- Komentari i ligjit për ekzekutimin e sanksioneve, Afrim Osmani, Shkup 2013
- Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale, Gazeta Zyrtare e RMV-së nr. 2/2006
- Në Ligjin për zbatimin e sanksioneve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 2/2006, 57/10,170/13 dhe 43/14) pas nenit 257 shtohet kapitulli ri XXI-a, titulli i ri dhe 8 nene të reja 257-a, 257-b, 257-v, 257-g, 257-d, 257-gj, 257-e dhe 257-zh, si vijojnë: "KAPITULLI XXI-a MJEKIMI MJEKËSOR-FARMAKOLOGJIK I KRYERËSVE TË SULMIT GJINOR MBI FËMIJË DERI NË MOSHËN 14 VJEÇARE
- Ligji për procedurën penale, Gazeta Zyrtare e RM-së nr.150/2010
- Ligji për Regjistrin e veçantë të personave të dënuar me aktgjykim për krime të abuzimit seksual të fëmijëve dhe pedofili,"Gazeta"Zyrtare"e"RMKsë"Nr.11/2012
- Ligji mbi amandamentimin dhe ndryshimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale,Gazeta zyrtare e RM –së Nr. 166/2014
- Komentari i Kodit Penal – Vllado Kambovski, Matica, Shkup, 2015
- Коментар на законот за кривичната постапка, Г. Калајџиев Г. Лажетиќ Л. Неделкова М. Денковска М. Тромбева Т. Витларов П. Јанкуловска Д. Кадиев
- Ligji për përcaktimin e llojit dhe matjen e lartësisë së dënimit, Gazeta Zyrtare e RM-së nr.199, 30.12.2014
- Ligji për Prokurorinë Publike, Gazeta Zyrtare e RM-së” nr.150/07
- Recommendation No. R (87) 18 concerning the simplification of criminal justice

Libra dhe artikuj shkenëcor:

- Zejneli Ismail,Kambovski Vlado, E drejta penale, pjesa e përgjithshme, Tetovë, 2018
- Камбовски В. Казнено право – општ дел , 2007, Скопје

- Камбовски В. Казнено право – втор дел , август 2006, Штип
- Sahiti, E. & Zejneli, I. (2017) E drejta e Procedures Penale e Republikës se Maqedonisë / Shkup 2017
- Halili, Dr.Ragip Penologjia, Prishtinë, 2005
- Halili Dr. Ragip Penologjia , Prishtinë 2014
- R. Halili: Aspektet juridike dhe kriminologjike të alkoolizmit dhe narkomanisë . Përparimi nr.2.Prishtinë,1984
- Sahiti Ejup,Zejneli Ismail, E drejta e procedurës penale, Shkup, 2017
- Ratkoceri, V (2017). Chemical castration as a security measure in the criminal legislation of the Republic of Macedonia. International Journal of Social Sciences and Education Research, Vol (3) 2, pp.356-360
- Ratkoceri, V (2017). Chemical castration of child molesters – Right or Wrong?!.European Journal of Social Sciences Education and Research – EJSER, Vol. 11(1), pp.70-76.
- Hajdari, A. (2014) E drejta e Procedures Penale, Pjesa e pergjithshme/ Prishtinë 2014
Sahiti, E. (2006) Argumentimi ne Proceduren Penale/Prishtine 2006
- Shefqet Muçi, E drejta penale-pjesa e përgjithëshme, Tiran,2007
- Ukaj, B Dënimet në të drejtën penale të Shqipërisë, Prishtinë 2006
- Арнаудовски, Љупчо, Пенологија: наука за извршување на кривичните санкции” Правен Факултет „Јустинијан“ Скопје 2013
- Буџакоски,С - Вовед во правото, ФОН Универзитет Скопје, 2008 година,
- Буџакоски, С., Казнено право (општ дел), Охрид, 2008 година
- Stojanović, Zoran. Krivično pravo, Opšti deo, Beograd, 2003
- Ratkoceri V., 2018-Kastrimi kimik si sanksion penal faqe 10 - tezë doktorature UEJL-Fakulteti juridik https://library.seeu.edu.mk/index.php?lvl=search_result

Të dhëna statistikore:

- Të dhënat statistikore nga Gjykata themelore penale Shkup për periudhën 2015 -2020
- Државен завод за статистика на Република Северна Македонија , СТОРИТЕЛИ НА КРИВИЧНИ ДЕЛА ВО 2015
- Државен завод за статистика на Република Северна Македонија, СТОРИТЕЛИ НА КРИВИЧНИ ДЕЛА ВО 2016
- Државен завод за статистика на Република Северна Македонија , СТОРИТЕЛИ НА КРИВИЧНИ ДЕЛА ВО 2017
- Државен завод за статистика на Република Северна Македонија , СТОРИТЕЛИ НА КРИВИЧНИ ДЕЛА ВО 2018
- Државен завод за статистика на Република Северна Македонија , СТОРИТЕЛИ НА КРИВИЧНИ ДЕЛА ВО 2019

Linqe nga interneti:

- <http://www.osskopje1.mk/>
- <http://www.pravo.org.mk/>
- <https://akademik.mk/>
- <http://www.assembly.coe.int/>
- <http://www1.umn.edu/>
- <https://jorm.gov.mk>
- <https://www.pravdiko.mk/spogoduvan-e-za-vina-spored-noviot-zkp/>

